



KLSH

ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4 - MUJORE

Nr.8

2014

ALSAI



EUROSAI

INTOSAI

Tiranë, 2014



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Experientia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE

kërkimore-shkencore-informative
shqip -anglisht

Nr. 8/2014, Tiranë

ISSN 2308-6106

Viti i III-të i botimit 2014

Maj-Gusht 2014

Seria : botime KLSH - 08/2014/29

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR.8

Redaktore : Irena Islami

Art Design: Kozma Kondakçiu

Seria : botime KLSH - 08/2014/29

Shtypur në Shtypshkronjën” Mirgeeralb”

Tiranë 2014



ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION - ALSAI

Experientia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

EVERY FOUR MONTHS MAGAZINE

of reseach, science and information
in Albanian and in English

No. 8/2014, Tirana

ISSN 2308-6106

May-August 2014

Series:Publications ALSAI - 08/2014/29

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj , Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT) (Kryeredaktor)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano , Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof.Dr. Skënder Osmani , Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni , Anëtar i Gjykatës së Lartë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo , Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi , Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha , Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati , Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel , Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Sholtes , ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Prof. Dr. Iraj Hashi , Universiteti Staffordshire në Britaninë e Madhe	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola , Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri , Instituti “ G& G Group”	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço , Drejtore Departamenti, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela , Kryetar i IEKA, Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola , Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

1. Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi
2. Fatos Çoçoli	Redaktor

I NDERUAR LEXUES !

Revista Shkencore periodike 4-mujore”Auditimi Publik” po vijon me sukses rrugën e nisur dy vite më parë, duke paraqitur tek profesionistet e fushës, lexuesit në përgjithësi dhe tek dashamirësit e librit, nurin 8-të të saj.

Në këtë numër kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë por edhe nga fusha të tjera si Prof.Dr.Jorgji Bollano, Prof.Dr.Omer Stringa, Prof.Dr.Skënder Osmani, Prof.Dr. Ilia Kristo, Prof.Ass.Dr. Sazan Guri, si dhe auditues me eksperiencë dhe profesionistë të KLSH-së.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financiarë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, eksperte të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes ne auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI “*Experientia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)*”.

Bordi Editorial i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Me respekt,
Bordi Editorial

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit

Bulevardi “ Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,

Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267

Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

Titulli	AUTORI	FAQE
Zhvillimet evropiane në fushën e raportimit financiar dhe reflektimi i tyre në legjislacionin vendas	Prof.Dr. Jorgji Bollano Elira HOXHA, PhD KKK	1
Kriza financiare dhe roli i auditimit të jashtëm publik	Prof.Dr. Omer Stringa Fakulteti i Ekonomisë Universiteti i Tiranës	9
Auditimet e Gjykatës Turke të Llogarive për Zbatimin e Rregullave Fiskale	Erdem Eller Gjykata Turke e Llogarive	15
Auditimi dhe Menaxhimi i Projektit	Prof. Dr.Skënder Osmani Fakulteti Gjeologji Miniera Gjovalin Preçi KLSH	25
Si te për zgjedhim treguesit për matjen e zhvillimit rajonal ?	Prof.Dr. Ilia Kristo Fakulteti i Ekonomisë Universiteti i Tiranës	39
Zonat e mbrojtura në Shqipëri, zona “të pambrojtura”	Prof.Ass.Dr.Sazan Guri Instituti “G&G Group”	47
Auditimi i frymës së drejtimit të lartë	Teuta Baleta AMF	57
Auditimi i integritetit: risi dhe drejtim qendror i auditimit ne KLSH	Bajram Lamaj KLSH	69

Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Buxheti i Shtetit	Albana Agolli Dr.Edvin Stefani KLSH	79
Auditimi i IT në projektin e informatizimit të shëndetësisë në Republikën e Sllovenisë	Përkthimi nga INTOSAI Journal Korrik 2014)	85
Bashkëpunimi me qytetarët- Përvoja koreane në përfshirjen e qytetarëve në proceset audituese	Përkthimi nga INTOSAI Journal (Korrik 2014)	91
Info nga vendi	Aktivitetet të KLSH-së (maj-gusht 2014)	97
Gjykata e Auditimit të Belgjikës	Profil	113
Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Çeke	Profil	119
Zyra e Lartë e Auditimit e Republikës Sllovake	Profil	123

CONTENT

Title	AUTHOR	Page
European developments in the financial reporting field and their reflection in the local legislation	Prof.Dr.Jorgji Bollano Elira HOXHA, PhD National Accounting Council (Albania)	129
Financial crisis and the role of public external audit	Prof.Dr.Omer Stringa Faculty of Economy University of Tirana	137
Turkish Court of Accounts' audit on fiscal rules implementations	Erdem Eller Turkish Court of Accounts	145
Audit and Project Management	Prof. Dr.Skënder Osmani Faculty of Geology – Mines Gjovalin Preçi ALSAI	153
How to select the indicators to measure the regional development?	Prof.Dr.Ilia Kristo PhD.Adela Llatja Faculty of Economy University of Tirana	169
Protected areas in Albania, “vulnerable” areas	Prof.Asc.Dr. Sazan Guri “G&G Group”	177
Audit of high management tone	Teuta Baleta Financial Supervision Authority	187
Audit of integrity, innovation and principal direction in auditing in SAI	Bajram Lamaj Fatos Çoçoli ALSAI	199
High State Control and the state budget	Albana Agolli Dr.Edvin Stefani ALSAI	209

The IT Audit of the Republic of Slovenia's eHealth Project	INTOSAI Journal July 2014	215
"Side by Side with People:" Korea's Experience with Participatory Auditing	INTOSAI Journal July 2014	221
Events and activities of ALSAI during May-August 2014	INFO	227
Belgium Court of Audit	Profile	243
Supreme Audit Office of the Czech Republic	Profile	247
Supreme Audit Office of the Republic of Slovakia	Profile	251

ZHVILLIMET EVROPIANE NË FUSHËN E RAPORTIMIT FINANCIAR DHE REFLEKTIMI I TYRE NË LEGJISLACIONIN VENDAS

Sistemi i kontabilitetit në një vend, përcaktohet nga mjedisi ku ai zhvillohet.

**Nga: Prof. Dr. Jorgji BOLLANO,
PhD Elira HOXHA**

I. Hyrje

Sistemi i kontabilitetit në një vend, përcaktohet nga mjedisi ku ai zhvillohet. Një nga pikëpamjet më të hasura në literaturë është ajo që pohon se kontabiliteti dhe raportimi financiar i një vendi janë funksion i karakteristikave qenësore të mjedisit të brendshëm kombëtar (p.sh. faza e zhvillimit ekonomik, rregullimet ligjore, sistemi politik, sistemi ekonomik, niveli i edukimit, variablat kulturorë) dhe meqenëse mjediset ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, kontabiliteti, raportimi financiar dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese do të ndryshojnë nëpër botë. Për shembull, Belkaoui (1983 / p. 207) theksoi se "objektivat e kontabilitetit, standardet, politikat dhe teknikat e tij, janë rezultat i faktorëve të mjedisit të

brendshëm të çdo vendi dhe nëse këta faktorë të mjedisit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në mes të shteteve, atëherë pritet që konceptet e kontabilitetit dhe praktikat në përdorim në këto vende të ndryshojnë". Pavarësisht nga fakti se ndikimi i faktorëve të mjedisit të brendshëm mbi kontabilitetin ka kohë që njihet në literaturë, nuk ka konsensus të përgjithshëm se cilët janë këta faktorë të brendshëm.

Nga ana tjetër, mjedisi kontabël shtrihet përtej kufijve të vendit pasi njësitë ekonomike ndërveprojnë në fushën e tregtisë dhe të financave ndërkombëtare. "Të industrializuar ose në zhvillim, të vegjël apo të mëdhenj, ... të gjitha vendet janë duke përjetuar lidhje më të afërta ndërkombëtare dhe një shkallë më të madhe të ndërvarësisë ekonomike. Në një botë komplekse dhe të ndërvarur, mbështetur në një teknologji të nivelit të lartë, bëhet evidente një lëvizje më e shpejtë e njohurive, ideologjisë, ideve

dhe qenieve njerëzore përtej kufijve kombëtarë, kulturore dhe territoriale. Këto lëvizje përfshijnë gjithashtu edhe idetë, praktikën, rregulloret, praktikuesit dhe edukatorët e kontabilitetit" (Choi/Muller, 1992: 1).

Prandaj, nuk është e mundur që të pretendohet se faktorët e mjedisit kombëtar janë të vetmit që ndikojnë kontabilitetin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në një vend të caktuar. Në të vërtetë, literatura sugjeron se ka një numër të faktorëve të mjedisit të jashtëm apo ndikime të tjera ndërkombëtare (p.sh. politika; lidhjet ekonomike me vendet e tjera; korporatat transnacionale; lëvizjet ndërkombëtare të shoqërive të kontabilitetit dhe profesionistëve; gjithashtu përpjekjet rajonale dhe ndërkombëtare të harmonizimit/standardizimit, etj) që kanë ndikuar kontabilitetin dhe shënimet shpjeguese në vende të caktuara në zhvillim. Për shembull, Cooke dhe Wallace (1990: 102) theksuan se "... dallimet që janë të dukshme në praktikën dhe parimet e kontabilitetit ndërmjet vendeve në zhvillim mund të mos lidhen drejtpërdrejt vetëm me ndryshimet në mjediset e tyre të brendshme".

Zbulimet hulumtuese sugjerojnë se niveli i rregullimit të raportimit financiar të korporatave në shumë vende të zhvilluara ka të ngjarë që të përcaktohet më së shumti nga faktorët e brendshëm, ndërsa në vendet në zhvillim ka të ngjarë që të përcaktohet më shumë nga faktorët e jashtëm. Cooke dhe Wallace (1990: 102) vunë në dukje se: "...është e vërtetë që profili i kontabilitetit të një vendi është një funksion i të dy faktorëve, të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm,.... ka më

shumë gjasa që një vend që është i pajisur me më shumë burime në kontekstin e kapitalit, teknologjisë dhe përvojës profesionale në kontabilitet dhe raportimin financiar ... mund të jetë më mirë i përshtatur për të krijuar rregulloret e veta të kontabilitetit në mënyrë të pavarur nga ato të vendeve të tjera. E kundërta, për një vend jo të pajisur në mënyrën e duhur dhe në nevojë për ndihmën e eksperiencës së vendeve të tjera, mund të jetë rrugë më e përshtatshme ajo e adoptimit të sistemeve kontabël të vendeve të tjera dhe të standardeve të hartuara nga organizma ndërkombëtare".

Siç është diskutuar më lart, sistemi i kontabilitetit në një vend mund të ndikohet nga disa faktorë. Faktorë të tillë si zhvillimi i biznesit ndërkombëtar në një shkallë globale dhe ndërkombëtarizimi i tregjeve të kapitalit janë duke ushtruar presion mbi shtetet për miratimin e një perspektive më ndërkombëtare të kontabilitetit. Veçanërisht gjatë tre dekadave të fundit, ka qenë shumë i dallueshëm trendi që të harmonizohet raportimi financiar i korporatave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Gjeneratori kryesor i harmonizimit të kontabilitetit në Evropë ka qenë vetë BE e cila e ka nxitur harmonizimin përmes hartimit të një seti direktivash ku saktësohen shumë parime kryesore të kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit.

Direktiva e katërt dhe e shtatë janë konsideruar si direktivat më të rëndësishme të BE dhe këto Direktiva besohet që kanë pasur ndikim shumë të rëndësishëm në kontabilitetin jo vetëm të vendeve anëtare të BE, por edhe të vendeve jo-anëtare të BE por që aspirojnë për t'iu bashkuar BE-së (Tay /

1989; VAN HULLE, 1992; Alexander / ARCHER, 1992).

II. Zhvillimet më të fundit në BE në fushën e raportimit financiar

Direktiva 2013/34 / BE mbi pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe llojet e shënimeve shpjeguese të njësive ekonomike të caktuara – e ashtuquajtur Direktiva e Kontabilitetit - u botua më 26 qershor 2013 dhe hyri në fuqi më 20 korrik 2013. Ajo zëvendëson Direktivat ekzistuese katër dhe shtatë që adresojnë raportimin e njësive ekonomike të veçanta dhe grupeve. Kjo Direktivë përfaqëson kulmin e një debati të konsiderueshëm mbi acquis që mbulojnë çështjet e kontabilitetit në Evropë dhe përfshin brenda saj rreth 100 Opsione të Shteteve Anëtare. Periudha e implementimit tani po i afrohet afatit të saj dhe shteteve anëtare u kërkohet përkthimi (transpozimi) i Direktivës në legjislacionin e tyre kombëtar duke filluar nga 20 korrik 2015.

Faza e implementimit mund të konsiderohet edhe si një sfidë, por edhe si një mundësi për të bërë gjërat e duhura, në kushtet kur është në proces vetë rivlerësimi i regjimit aktual të kontabilitetit në Shtetet e ndryshme Anëtare. Megjithatë përcaktimi i cilave Opsione të Shteteve Anëtare duhet përdorur, ngre disa pyetje interesante dhe nganjëherë të komplikuara. Richard Martin, Shef i Raportimit të Korporatave në ACCA, i cili moderoi debatin në një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar në nivel të lartë evropian, tha: "Opsionet e Shteteve Anëtare do të

kenë një ndikim të madh në njësitë e vogla. Ky është një moment i rëndësishëm për kontabilitetin në Evropë, çdo shtet anëtar ka për të vlerësuar se çfarë rruge duhet të marrë... Ka vërtet disa ndryshime që shtetet anëtare do të duhet të marrin në konsideratë për shkak të zëvendësimit të ligjit."

Debati zbuloi se disa aktorë nuk janë të bindur se Opsionet e Shteteve Anëtare të lëna brenda Direktivës së Kontabilitetit do të rrisin 'nivelin e fushës së lojës' apo do të përmirësojnë krahasueshmërinë në të gjithë Evropën. Këta aktorë prirën madje të besojnë të kundërtën, se këto opsione do të jenë një sfidë për Shtetet Anëtare që tani duhet të zbatojnë Direktivën. Diskutimet gjithashtu janë sjellë rreth nevojës për Shtetet Anëtare që të marrin në konsideratë se çfarë qëllimi ata dëshirojnë të ndjekin. Qëllimi i tyre është është një kontabilitet më i mirë? - dhe atëherë çfarë do të thotë kontabilitet më i mirë - apo mbi të gjitha kërkojnë uljen e shpenzimeve dhe të të ashtuquajturës barrë administrative? Do të ishte me vlerë dhe në mënyrë të veçantë për t'u marrë parasysh fakti se çfarë roli luajnë transparenca dhe efikasiteti i tregut, krahasueshmëria, relevanca, kostot kundrejt përfitimit dhe harmonizimi ndërkombëtar në këtë proces, dhe cili duhet të jetë kriteri i përshtatshëm për vlerësimin e tyre.

Në fakt, Direktiva e re e Kontabilitetit i ka përfshirë të dyja objektivat e përmendura më sipër, si pjesë e tryezave të diskutimeve. Pa diskutim është objektiv shumë i rëndësishëm harmonizimi i kontabilitetit në BE në mënyrë që të kemi një gjuhë të

përbashkët të kontabilitetit. Për të përmbushur kriteret e një kontabiliteti më të mirë, informacioni duhet të jetë i vlefshëm për përdoruesit. Mbrojtja e të drejtave të investitorëve dhe kreditorëve është një aspekt i rëndësishëm dhe cilësia e kontabilitetit stimulon rritjen ekonomike në BE dhe e bën aksesin në financa më të thjeshtë.

Po aq i rëndësishëm është edhe objektivi tjetër i Direktivës, ai për të zvogëluar ngarkesën administrative për njësitë e vogla dhe, në një masë të caktuar, për të përmirësuar cilësinë dhe krahasueshmërinë e informacionit të paraqitur në pasqyrat e tyre financiare.

III. Reflektimi ynë për Direktivën e re të Kontabilitetit

Edhe në Shqipëri çështja e përkthimit (transpozimit) të Direktivave të BE prej vitesh është një kërkesë e kohës për vetë objektivin e integritetit të Shqipërisë në Evropë. Integrimi european mbetet një nga faktorët e jashtëm me presion më të fortë mbi transpozimin në përgjithësi të direktivave të BE ndërsa zhvillimet e tregut dhe nevoja për akses në fonde dhe financa ndërkombëtare është faktori që ka më së shumti ndikim në harmonizimin e raportimit financiar të vendit tonë me atë të BE. Në kushtet kur synojmë të nxisim investimet vendase dhe të huaja, është domosdoshmëri rritja e transparencës, krahasueshmërisë dhe vërtetësisë së informacionit financiar. Një hap i parë, i hedhur në vendin tonë drejt harmonizimit me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit, ka qenë hartimi i standardeve kombëtare të kontabilitetit, në vitin 2008. Në hartimin e tyre, për hir të së vërtetës, u mbajtën në konsideratë vetëm standardet

ndërkombëtare të kontabilitetit pasi synimi i ligjvënësve dhe standard-hartuesve në atë moment ishte kalimi nga modeli kontinental i kontabilitetit drejt modelit anglosakson. Në vitet që pasuan, me prezencën e asistencës së huaj por dhe me intensifikimin e marrëdhënieve me përfaqësues të delegacionit të BE, qasja e raportimit financiar u rishikua në një këndvështrim të ri. Kjo nuk konsiderohet një qasje origjinale pasi dhe vetë Evropa që prej vitit 2005 u orientua drejt modelit anglosakson kur bëri të detyrueshme SNK / SNRF për njësitë ekonomike të listuara. Por në dallim nga ne, Vendet Anëtare, për të gjitha njësitë e tjera ekonomike në vendet e tyre, zbatuan dhe zbatojnë standardet lokale, të cilat në më të shumtën e tyre priren të jenë të modelit kontinental.

Në vitet e fundit, si në rrafshin ndërkombëtar dhe në atë të BE, prioritet ka marrë koncepti “të mendojmë fillimisht për më të vegjëlit”. Së dyti, raporti kosto përfitim referuar detyrimit për hartimin e shënimeve shpjeguese, paraqitjes së detajuar të pasqyrave financiare apo dhe vetë përmirësimit të teknikave kontabël për regjistrimin e transaksioneve, mbetet sërish një kriter udhëzues në kontekstin e reformave në fushën e raportimit. Së treti, transparenca ndaj publikut dhe cilësia e vendimarrjeve ekonomike të përdoruesve të informacionit financiar është komponent i tretë i rëndësishëm i ndryshimeve të kohëve të fundit.

Duke pasur parasysh sa më lart, të tre argumentet u thelluan në diskutime dhe debate me profesionistë dhe akademikë të fushës për të arritur së fundmi në konkluzionin e rëndësishëm të rishikimit të standardeve të

kontabilitetit dhe synimit të përmirësimit të vetë ligjit për kontabilitetin në Shqipëri.

Standardet kombëtare të kontabilitetit, duke qenë të hartuara për njësi të vogla dhe të mesme si dhe pa përgjegjësi publike u rishikuan dhe përmirësuan pikërisht duke reflektuar parimin “të mendojmë fillimisht për më të vegjëlit”. Kursi i tyre ndryshoi, SKK-të jo më në koherencë me standardet e plota ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar por me standardin ndërkombëtar të raportimit financiar për njësitë e vogla dhe të mesme (IFRS for SMEs). Në kuadër të përmirësimit të SKK-ve, ato u thjeshtuan duke eliminuar kryesisht alternativat e shumëfishta dhe teknikat komplekse të regjistrimit të transaksioneve kontabël. Ndër këto lehtësime mund të përmendim:

SKK 3 “Instrumentet Financiare”

- Mbulon vetëm instrumentet e thjeshta financiare;
- Nuk përdoret më modeli i vlerës së drejtë për vlerësimin e mëpasshëm të instrumenteve financiarë;

SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jo-materiale”

- Shpenzimet e zhvillimit trajtohen si shpenzime periodhe, nuk krijohet më një aktiv jo-material;
- Kostot e huamarrjes trajtohen vetëm si shpenzime periodhe, nuk kapitalizohen më në vlerën e aktivitetit material;
- Emri i mirë - amortizohet për 10 vite duke eliminuar alternativën e testimit për zhvlerësim;

SKK 9 “Kombinimi i Bizneseve dhe Konsolidimi”

- Nëse nuk mund të vlerësohet me besueshmëri jeta e dobishme e Emrit të Mirë lindur në një kombinim biznesi, atëherë ai amortizohet për 10 vite;
- Nuk i kërkohet më blerësit të bëjë një analizë të çmimit të blerjes;

SKK 10 “Grantet dhe Format e tjera të Ndihmës”

- Njohjen e menjëhershme të grantit si të ardhur, nëse granti nuk ka kushte, ose me plotësimin e kushteve, kur granti shoqërohet me kushte të caktuara;

SKK 13 “Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet Koncesionare”

- Shtohen paragrafë për modelin e vlerësimit me vlerë të drejtë të aktiveve biologjike;

SKK 14 “Trajtimi kontabël i Investimeve në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta”

- Nuk është më i vlefshëm modeli i vlerës së drejtë në vlerësimin e investimeve në pjesëmarrje apo investime në sipërmarrje të përbashkëta;
 - Jep opsionin, por jo detyrimisht të zbatueshëm, të përgatitjes së pasqyrave financiare individuale për shoqëritë mëma dhe njësitë e kontrolluara;
 - Përcakton kriteret të cilat, nëse plotësohen, e lejojnë njësinë ekonomike të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara;
- Ndërsa përsa i përket shënimeve shpjeguese që këto njësi duhet të hartojnë lidhur me pasqyrat financiare, ato janë në masën më të madhe identike me ato të standardit ndërkombëtar të raportimit financiar për njësitë e vogla dhe të mesme.

Qasja e përmirësimit të SKK-ve ishte ajo e harmonizimit të kërkesave të SKK-ve me ato të SNRF për NVM ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare plotësisht në përputhje me kërkesat e Direktivës së re të kontabilitetit të BE. Plotësisht të njëjta janë pasqyrat e pozicionit financiar dhe asaj të performancës financiare pasi SKK-të tona, ndryshe nga Direktiva, kërkojnë të detyrueshme edhe 2 pasqyrat e tjera, atë të lëvizjes së mjeteve monetare dhe atë të lëvizjes së kapitalit. Pasqyrat e reja financiare, në përmbajtje nuk sjellin shumë ndryshime nga ato të miratuara në SKK 2 prej vitit 2008 por emërtimi dhe formati i tyre ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

Në këtë moment Direktiva e re e kontabilitetit është përfshirë në kuadrin tonë të raportimit financiar vetëm për sa i përket paraqitjes së pasqyrave financiare pasi kërkesat e saj, sidomos të rejat që ajo prezanton krahasuar me dy Direktivat e mëparshme të kontabilitetit, do të jenë pjesë e ndryshimeve të pritshme të ligjit për kontabilitetin. Çështjet që janë pjesë e rëndësishme të Direktivës, por që mungojnë në ligjin tonë janë:

- Direktiva përjashton nga objektivi i vet Organizatat Jo Fitimprurëse pasi ato rregullohen me një rregullore të veçantë;
- Direktiva vendos tre kritere për klasifikimin e njësive ekonomike: shifrën e bilancit, shifrën e afarizmit dhe numrin e të punësuarve;
- Kufijtë për klasifikimin e mikro-njësive janë të përcaktuar në Direktivë. Ndërsa në vendin tonë kufijtë e raportimit përcaktohen nga KKK ndërsa klasifikimi i njësive ekonomike përcaktohet me ligj tjetër;

- Direktiva kërkon hartimin e raportit të menaxhimit për të gjitha njësitë ekonomike, megjithatë u lejohet vendeve anëtare të mos e bëjnë atë të detyrueshëm për NVM nëse e shohin të arsyeshme. Raporti i menaxhimit nuk duhet të kufizohet vetëm në informacionin financiar por të japë info për zhvillimin, pozicionin dhe performancën e njësisë në drejtim të çështjeve mjedisore dhe aspekteve të tjera shoqërore;

- Direktiva kërkon që Vendet Anëtare të bëjnë disa lehtësime lidhur me publikimin e pasqyrave financiare për NVM;

- Direktiva kërkon auditimin e pasqyrave duke u sugjeruar dhe jo detyruar Vendet Anëtare të përjashtojnë njësitë e vogla nga ky detyrim;

- Në Direktivë është dhënë përkufizimi i njësive ekonomike me interes publik. Në ligjin tonë përkufizimi mungon por SNRF-të u kërkojnë atyre njësive që bien brenda këtij përkufizimi;

- Në ligjin tonë nuk ka asnjë trajtim specifik për industrinë nxjerrëse;

- Në ligjin tonë nuk ka asnjë detyrim për shënime shpjeguese mbi transferata dhe grante mbi një vlerë të caktuar monetare;

- Mes 2 kuadrove ligjorë ka ndryshime të konsiderueshme të terminologjisë;

- Janë krejtësisht të ndryshme, dhe kjo është e natyrshme, vlerat limit për klasifikimin e njësive ekonomike. Nuk bëhet fjalë për të pasur të njëjtët kufi por duhet nxitur fryma për ndryshime të këtyre kufijve ekzistues me synimin e lehtësimit, sa të jetë e arsyeshme, të barrës së raportimit për më shumë njësi sesa janë aktualisht të klasifikuara si mikro;

Ndryshimet përkatëse për të reflektuar ndryshimet e sipërpërmendura por dhe disa të tjera që nuk paraqiten në këtë material do të bëjnë një harmonizim shumë të mirë të kuadrit tonë të raportimit financiar me atë të BE.

IV. KONKLUZIONE

Sistemi i kontabilitetit në një vend, përcaktohet nga mjedisi ku ai zhvillohet. Një nga pikëpamjet më të ndeshura në literaturë është ajo që pohon se kontabiliteti dhe raportimi financiar i një vendi janë funksion i karakteristikave qenësore të mjedisit të brendshëm kombëtar. Në të vërtetë, literatura sugjeron se ka një numër të faktorëve të mjedisit të jashtëm apo ndikime të tjera ndërkombëtare që kanë ndikuar kontabilitetin dhe shënimet shpjeguese në vende të caktuara në zhvillim.

Në kushtet kur vendi ynë synon të nxisë investimet vendase dhe të huaja, pra hapjen e tregjeve për investime dhe financa të huaja, është domosdoshmëri rritja e transparencës, krahasueshmërisë dhe vërtetësisë së informacionit. Të ndikuar më së shumti nga faktorë të jashtëm por dhe në kushtet e një eksperience modeste në rregullimet e ekonomisë së tregut, Shqipëria e ka të domosdoshme ndjekjen e modeleve më të mira ndërkombëtare të raportimit financiar. Një hap i parë është orientimi drejt standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të njësive ekonomike të vogla dhe të mesme. Ndërsa hapi i dytë i reformës në fushën e kontabilitetit është transpozimi i Direktivës së kontabilitetit të BE. Paraqitja e njëjtë e pasqyrave financiare

është vetëm fillimi i procesit të transpozimit. Ndërhyrjet dhe amendimet e ligjit për kontabilitetin do të jenë hapi vendimtar drejt harmonizimit të politikave kontabël dhe shënimeve shpjeguese të njësive ekonomike vendase me ato të vendeve të tjera të Evropës.

V. Referencat dhe Literatura

ADHIKARI, A. / TONDKAR, R. H. (1992), 'Environmental Factors Influencing Accounting Disclosure Requirements of Global Stock Exchange,' Journal of International Management and Accounting, Vol. 4/2: 75.105.

BELKAOUI. A. R. (1983), 'Economic, Political and Civil Indicators and Reporting and Disclosure Adequacy: Empirical Investigation.' Journal of Accounting and Public Policy. Vol. 2/3: 207.219.

BOROSS. A. H. / CLARKSON, A. H. / FRASER, M. (1995), 'Pressure and Conflicts in Moving Towards Harmonisation of Accounting Practice: The Hungarian Experience,' The European Accounting Review, Vol. 4/4: 713.737.

CHOI, F. D. S. / MUELLER, G. G. (1992), International Accounting (New Jersey: Prentice Hall Inc., 2nd Ed.).

COOKE. T. E. / WALLACE, R. S. O. (1990), 'Financial Disclosure and Its Environment: A Review and Further Analysis,' Journal of Accounting and Public Policy. Vol. 9: 79.170.

FEDERATION DES EXPERTS COMPTABLES EUROPEENS (1989). European Survey of Published Financial Statements in the Context of

Ifie Fourth EC Directive (Federation des Experts Comptables Europeens).

FEDERATION DES EXPERTS COMPTABLES EUROPEENS (1991), Fff European Survey of Published Accounts (Routledge, London).

HERRMANN, D. / THOMAS, W. (1995), "Harmonisation of Accounting Measurement Practices in the European Community," Accounting and Business Research, Autumn: 253.265.

JARUGA, A. A. / SZYCHTA, A. (1997), 'The origin and Evolution of Charts of Accounts in Poland,' The European Accounting Review, Vol. 6/3: 509.526.

LUKAS, W. (1992), 'Austria,' ALEXANDER, D. / ARCHER, S. (eds.), The European Accounting Guide (London: Academic Press, 2nd Ed.): 703.731.

NOBES, C. / PARKER, R. (1995). Comparative International Accounting (UK: Prentice Hall, 4th Ed.).

PREVITS, G. J. (1975). 'On the Subject of Methodology and Models for International Accounting,' The

International Journal of Accounting, Education and Research, Vol. 10/2: 1-12.

RAFFOURNIER, B. (1995b), 'The Determinants of Voluntary Financial Disclosure by Swiss Listed Companies.' 71st European Accounting Review, Vol. 4/2: 261.80.

ZUND, A. (1992), 'Switzerland,' ALEXANDER, D. / ARCHER, S. (eds.), The European Accounting Guide (London: Academic Press, 2nd Ed.): 825.884.

<http://www.ifrs.org/IFRS-for-SMEs>

<http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=136&gj=sh>

<http://www.kpmg.com/global/en/pages/default.aspx>

Jorgji BOLLANO, Prof. Dr

Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

e-mail: jorgji.bollano@kkk.gov.al

Elira HOXHA, PhD (student)

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

Rr "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Nr 6, Tirana, Albania

e-mail: elira_hoxha@hotmail.com

KRIZA FINANCIARE DHE ROLI I AUDITIMIT TË JASHTËM PUBLIK

Periudha e re e transformimit të financave publike kërkon të zgjerohet qëllimi i auditimit publik.

Nga: Prof. Dr. Omer Stringa

Abstrakt

Në përballjen me deficitet financiare dhe krizat e borxheve publike, auditimi i jashtëm publik duhet të fokusohet në faktorët e përgjithshëm apo ata sistematikë, që ndikojnë me forcë në zbatimin e politikave dhe në qëndrueshmërinë financiare afat-gjatë, si dhe kontribuojnë në krijimin e politikave të shëndosha financiare publike dhe monetare.

Fjalë kyçe: Kriza financiare, sektori financiar, politika të shëndosha financiare, faktorët sistematikë, sistemet rregullatore, qëndrueshmëri fiskale, standardet e kontabilitetit, standardet e auditimit, auditimi i jashtëm publik dhe SAI-t.

Hyrje

Si një forcë jetësore në ruajtjen e demokracisë dhe shtetit ligjor, auditimi i jashtëm publik luan një rol thelbësor në rritjen e eficiencës qeverisëse, në zhvillimin e një administrate me integritet, dhe në përmirësimin e jetës së njerëzve.

Periudha e re e transformimit të financave publike kërkon të zgjerohet qëllimi i auditimit publik. Në kontekstin e një bote nën krizën financiare, te mesimeve se çfare ndodhi ndryshe me krizen aktuale financiare, vendet janë duke kërkuar dhe synuar mënyra të reja zhvillimi. Situatat që ndryshojnë, masat dhe kërkesat e reja, lypin një pozicion të ri, krijues dhe kurajoz, të auditimit të jashtëm publik.

Pse kriza e sotme financiare ishte ndryshe? Mësimet nga trajektorja e saj Krizat financiare nuk janë një fenomen i ri. Ekonomia botërore, kohë pas kohe, është goditur nga kriza, dhe kriza e tanishme nuk është me siguri e fundit. Disa mësimet mund të nxirren nga krahasimi me krizat e mëparshme, në mes të zhvillimit në vende të ndryshme, gjatë krizës aktuale.

a) Sektori financiar është rritur dhe është shumë kompleks, aktorët e tij janë bërë shumë të mëdhenj, ndonjëherë shumë të mëdhenj për t'u kontrolluar. Këto institucione dhe produktet e tyre, për këtë arsye, janë bërë shumë të vështira për t'u rregulluar dhe mbikëqyrur. Edhe vetë kontrolli i brendshëm i institucioneve financiare ka dështuar në shumë raste.

Politikat e remunerimit financiar kanë krijuar dhe shtuar risqet e sistemit. Rreziku sistematik ka qenë shumë më i madh se kurrë më parë. Sipas studjuesve T. Adrian dhe H.S. Shin, ky rrezik ishte 3.1 herë më i madh në vitin 2007, në krahasim me vitin 2000. Sa më tepër kompanitë financiare, në radhë të parë bankat dhe shoqëritë e sigurimit, bëheshin shumë më të mëdha në raport me ekonominë e përgjithshme, aq më intensivisht financat publike janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të mëdha.

b. Sistemet politike dhe rregullatore nuk arriten të adresojnë disa çështje të rëndësishme. Më e dukshme ishte çështja e kontrollit për risqet e sistemit të gjerë.

c. Një tjetër mësim nga kriza e tanishme është rëndësia e ndjekjes së politikave të shëndosha makroekonomike, sidomos gjatë periudhës së rritjes ekonomike. Vendet që i kishin lejuar vetes zhbalancimeve të mëdha makroekonomike (p.sh. rritje e borxhit public, e deficitit buxhetor, etj.) rezultuan me të prekurat gjatë krizës.

Kriza aktuale financiare ishte një rezultat i një kombinimi të dështimeve në tregjet financiare, të problemeve makroekonomike dhe mangësive në zbatimin e politikave strikte qeveritare. Është e rëndësishme për të parë perspektivën e auditimit të jashtëm publik (AJP) dhe rolin e tij, që të analizojmë shkaqet dhe mësimet e nxjerra nga kriza financiare. Shtrirja për një AJP që të kontrollojë zhvillimet makroekonomike është natyrisht e kufizuar. Megjithatë, ka zona që kanë të bëjnë me zhvillimet makroekonomike që mund të jetë një pjesë e mandatit të auditimit të AJP. Kjo përfshin një

perspektivë të auditimit dhe të llogaridhënies në financat e qeverisë. Ka nevojë për politika të shëndosha fiskale, një herë që rimëkëmbja ekonomike është e siguruar, në mënyrë që të mbështetet qëndrueshmëria afatgjatë e financave publike. Politikat fiskale qeveritare, në lidhje me realizimin e tyre, në krahasim me objektivat fiskalë të parashikuar, duhet të jenë një fushë, në të cilën institucionet e auditimit të jashtëm publik (SAI-t) mund të luajnë një rol më të rëndësishëm në të ardhmen.

Një rishikim i gjerë i strukturës rregullatore të tregjeve financiare është në process në Bashkimin Evropian, duke u përpjekur për të trajtuar dështimet e rregullimit dhe të mbikqyrjes së një sistemi të përshtatshëm financiar.

Sigurimi që realizohet një llogaridhënie e përshtatshme dhe në kohë, është i rëndësishëm për suksesin afatgjatë të ndreqjes së këtij sistemi rregullator.

Kriza financiare ka theksuar disa sfida të vjetra dhe të reja me të cilat AJP po përballë në detyrën e tij të auditimit të veprimeve të kryera nga degët ekzekutive të qeverisë. Le të shohim në vijim disa nga këto sfida.

1. Financat publike janë prekur rëndë në shumë vende. Para se gjithash, një pozitë e dobët fiskale e ka vënë në pikepyetje qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike në shumë vende, sidomos në Greqi, por edhe në vende të tilla të mëdha si Britania e Madhe dhe SHBA, të cilat kanë njohur një debat të gjallë mbi pozicionin e tyre fiskal. Vendet me teprica të mëdha gjatë periudhës së bumit dhe zhvillimit ekonomik, për shkak të mosmenaxhimit të shëndetshëm financiar, kanë parë edhe deficite të mëdha. Teprica

strukture e buxhetit u mbi-vlerësua në shumë vende, ku rritja reale doli të jetë dukshëm më e ulët nga sa ishte parashikuar. Kriza e ka theksuar rëndësinë e financave të shëndosha publike gjatë viteve të bumit ekonomik, në mënyrë që të jenë në gjendje për të menaxhuar një krizë me vone. Ajo ka theksuar gjithashtu se kornizat e politikave fiskale, të tilla si Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes në BE, kanë qenë të pamjaftueshme për të siguruar që fitimet e periudhës së mirë ekonomike të përdoren për të financuar shkurtimet e taksave apo rritjen e shpenzimeve të përhershme.

Vite rregjimi të rrepte e gati spartan fiskal do të jenë të nevojshme në shumë vende, për të shmangur krizat e borxhit sovran. Vendi yne, Shqipëria, nuk mund të dale nga kjo trajektore. Strategjitë e daljes do të duhet të marrin parasysh qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike dhe në të njëjtën kohë, të marrin parasysh situatën aktuale ekonomike në mënyrë që të mos pengojë rimëkëmbjen e tanishme. Për të arritur këtë, duke rritur besimi i tregut për financat publike. Vendet do të duhet të përgatisin buxhete të besueshme dhe të kenë kontabilitetin transparent dhe të drejtë të financave të sektorit publik.

2. Studimet empirike të rregullave fiskale dhe transparencës fiskale kanë tendencë për të gjetur se si të kontribuojnë në rezultatet më të forta buxhetore. Përdorimi i parashikimeve transparente afatgjata, rregullave fiskale dhe treguesve numerike në procesin e buxhetit, është i rëndësishëm, për shkak se ai përcakton kufijtë për negociatat në mes të Ministrit të Financave dhe ministrave të linjës. Rregullat mund të thyhen, por

është më e vështirë për të thyer një rregull, në qoftë se ai është specifik dhe konkret. Në mungesë të një arbitri të pavarur në lojën e buxhetit, rregullat mund të shihen si një teknologji që vendos barrën e provës për lojtarët që duan të bëjnë fitime afatshkurtra, pa marrë parasysh stabilitetin fiskal afatgjatë.

Në përcaktimin dhe ruajtjen e rregullave të drejta në përgatitjen e buxhetit të Shtetit, në transparencën fiskale, korrektësinë e kontabilitetit fiskal dhe raportimit e respektimit të rregullave fiskale, AJP dhe SAI-, si autoritete të pavarura, mund të luajnë një rol jetik në sigurimin që mësimet fiskale nga kriza nuk janë harruar dhe ti konsiderojnë gjatë zhvillimeve të ardhshme.

Auditimi i garancive qeveritare

Globalizimi dhe zgjerimi i tregjeve financiare ka krijuar grupe të mëdha financiare që paraqesin rrezik të konsiderueshëm sistematik për qeveritë dhe taksapaguesit. Kombinuar me procedurat joadekuade për bankat, qeveritë shpesh kanë pak zgjedhje, por për të mbështetur bankat, shpesh ato kanë dhënë garanci implicite dhe eksplicite, të cilat krijojnë një barrë për taksapaguesit dhe shtrembërojnë stimujt e tregut të lirë.

Fakti që sektori financiar është rritur shumë here më tepër, në krahasim me ekonominë e përgjithshme, të thotë se rreziku i nënkuptuar i financave publike është real, për sa kohë Shteti-jep garanci për këtë sektor, garanci që në kohë krize mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë afatgjatë të pozicionit financiar të sektorit publik. Nëse një krizë e rëndë bankare godet një ekonomi, rreziqet në sektorin bankar

mund që shumë shpejt të emigrojnë në bilancin e shtetit.

Garancitë de facto për një rritje të sektorit financiar janë një problem në rritje. Nëse mbështetja e shtetit rritet për të shpetuar bankat e t vendit, duhet të rritet edhe roli i institucioneve të auditimit të jashtëm publik (SAI-ve) në promovimin e përgjegjshmërisë së Qeverisë për stabilitetin financiar. Strukturat rregullatore dhe mbikëqyrëse u fragmentuan në shumë vende dhe rajone, gjatë krizës. Bankat qendrore kanë një status të veçantë të pavarësisë në operacionet e tyre të politikës monetare. Ata gjithashtu kanë një përgjegjësi në shumicën e vendeve, për të promovuar stabilitetin financiar. Megjithatë, koncepti i stabilitetit financiar, çfarë është ai dhe si është arritur, shpesh nuk është i specifikuar. Stabiliteti sistematik financiar është shpesh në fushën e operacioneve të bankave qendrore, ndërkohë që shumë vende kanë autoritete të ndara financiare mbikëqyrëse, për mbikëqyrjen e pjesëmarrësve individualë të tregut financiar.

Shqyrtim parlamentar i pavarur i operacioneve të bankave qendrore për të nxitur stabilitetin financiar është i kufizuar. Kjo krijon një boshllëk në strukturën e llogaridhënies dhe AJP dhe institucionet e tij Supreme të Auditimit (SAI-t) mund të luajë një rol në kontrollin e këtyre operacioneve me qëllim të përmirësimit të kontrollit parlamentar. Për më tepër, SAI-t kanë një rol për të luajtur në vlerësimin e përshtatshmërisë së strukturës mbikëqyrëse për tregjet financiare. Perderisa bankat qendrore kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit financiar, puna e tyre kërkon përfshirjen

në auditimet e SAI-ve të kësaj aktiviteti të bankës qendrore, në mënyrë që të rrisë kontrollin parlamentar dhe në këtë mënyrë, përgjegjshmërinë. Kriza financiare e ka theksuar rëndësinë e sigurimit të llogaridhënies në këtë fushë. SAI-t mund të auditojnë efektivitetin e realizimit të këtyre politikave të bankave qendrore dhe e kanë bërë këtë në disa vende. Duke pasur parasysh njohuritë që ne tani kemi, është e rëndësishme për të përfshirë efektet e mundshme të politikave për stabilitetin financiar, në sferën e veprimtarisë së AJP.

Promovimi i raportimit transparent dhe të besueshëm financiar

Përgjigja ndaj krizës financiare globale theksoi nevojën që qeveritë të kenë raportim transparent dhe të besueshëm financiar, për të komunikuar në mënyrë efektive ndikimin financiar të qeverisë nga veprimet që kanë marrë dhe politikat që kanë ndjekur. Themeli për një raportim transparent e të besueshëm financiar përfshin përgatitjen e pasqyrave financiare nga qeveritë, në bazë akruale të kontabilitetit, duke përdorur standardet e kontabilitetit, të zhvilluara nga një proces ndërkombëtar i pavarur standard-formues, totalisht në interes të publikut.

Qeveritë duhet të mbahen përgjegjëse për nivelin, cilësisë dhe koston e shërbimeve që ato ofrojnë. Për ta bërë këtë, qeveritë duhet të përgatisin pasqyrat financiare që të jenë transparente dhe në mënyrë të qartë të tregojnë se si ata kanë përdorur dhe po planifikojnë të përdorin fondet që u janë besuar nga tatimpaguesit dhe Kuvendi. Një raportim i tillë duhet të përfshijë

veprimet e qeverisë në përgjigje të krizës financiare.

Standardet e kontabilitetit të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare të qeverisë, luajnë një rol të rëndësishëm për transparencën dhe llogaridhënien. Madhësia e qeverisë-si në operacionet e tyre të borxhit publik dhe në operacionet e tyre në tregjet e brendshme-për ekonominë e vendit, e bën jetike kërkesën që Qeveria të ketë standardet e kontabilitetit që promovojnë transparencën dhe sigurojnë kushtet për raportim të besueshëm. Më konkretisht, një grup i standardeve të kontabilitetit me bazë akruale, është i nevojshëm për të reflektuar si duhet pasojat e plota të vendimeve politike.

Më tej, për të siguruar kredibilitet për pasqyrat financiare, ato duhet të auditohen nga një auditues i pavarur, duke përdorur standardet përgjithësisht të pranura të auditimit. Parlamentet duhet të marrin siguri që pasqyrat financiare që kanë të bëjnë me vendime të rëndësishme ekonomike, të jenë të besueshme, transparente, dhe të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të të gjitha aktiviteteve financiare të qeverisë.

Në nivel ndërkombëtar, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), ka krijuar trupa të pavarura për përcaktimin e standardeve të kontabilitetit, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSASB), i cili përcakton standardet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar për njësitë e qeverisjes publike, dhe Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB), i cili merret me standardet përgjithësisht të pranura të auditimit dhe sigurimit financiar. Gjithashtu, Organizata

Ndërkombetare e institucioneve të auditimit të jashtëm publik, INTOSAI, ka prodhuar standardet ISSAI, të cilat, dhe në bazë të standardeve të auditimit IAASB, ndihmojnë audituesit për të aplikuar standardet më moderne të auditimit dhe kontroleve të qeverisë.

Konkluzione

1. Gjatë krizës financiare boterore, kontrolli i brendshëm i institucioneve financiare ka dështuar në shumë raste dhe në shumë vende.

2. Parlamentet duhet të marrin siguri që pasqyrat financiare që kanë të bëjnë me vendime të rëndësishme ekonomike, të jenë të besueshme, transparente, dhe të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të të gjitha aktiviteteve financiare të qeverisë.

3. Ka një njohje në rritje, si rezultat i raportimit financiar në lidhje me krizën fiskale, që transparenca dhe besueshmëria e disa pasqyrave financiare të qeverisë mund të përmirësohet. Auditimi i jashtëm publik (AJP) duhet të vazhdojë të punojë për të promovuar transparencën dhe besueshmerinë e raportimit financiar të Qeverisë.

4. Shtrirja e auditimit të jashtëm publik (AJP) dhe SAI-ve për të audituar zhvillimet makroekonomike është natyrisht e kufizuar. Megjithatë, ka zona që kanë të bëjnë me zhvillimet makroekonomike, që mund të jetë një pjesë e mandatit të auditimit të JP. Kjo jep një perspektivë të qartë të auditimit dhe të llogaridhënies në financat e Qeverisë.

5. Politikat fiskale qeveritare, në lidhje me realizimin e tyre, në krahasim me objektivat fiskale të parashikuar, duhet të jenë një fushë në të cilën institucionet e auditimit të jashtëm

publik (SAI-t) mund të luajnë një rol më të rëndësishëm në të ardhmen.

6. Shqyrtimi parlamentar i pavarur i operacioneve të bankave qendrore për të nxitur stabilitetin financiar, është i kufizuar. Kjo krijon një boshllëk në strukturën e llogaridhënies dhe AJP dhe institucionet e tij Supreme të Auditimit (SAI-t) mund të luajnë një rol në kontrollin e këtyre operacioneve, me qëllim të përmirësimit të kontrollit parlamentar.

Rekomandime:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) duhet të kembengulë pranë Kuvendit të Shqipërisë që t'i jepet mundësia të marre pjesë në fazën e planifikimit dhe projektimit të Buxhetit të Shtetit për vitin pasardhës, pasi kështu po veprojnë shumë SAI në Evropë e më gjerë dhe kjo do t'i japë Kuvendit siguri të mjaftueshme për alokimin dhe përdorimin efektiv, me efikasitet dhe me ekonomicitet të fondeve publike.

KLSH mund dhe duhet të ketë fjalën e tij për parashikueshmerinë e zhvillimeve makro-ekonomike të vendit, nga e cila varet një pjesë e mirë e suksesit të realizimit të Buxhetit të Shtetit për vitin pasardhës.

Literatura:

1. Adrian, T. and H.S. Shin (2007), "Likuiditeti, Politika Monetare dhe Ciklet Financiare". Revista "Current Issues in Economics and Finance", Federal Reserve Bank of New York, Vol. 14, No 1.
2. Blundell-Wignall, A, Atkinson, P, and S. H. Lee (2008): "Krizat aktuale Financiare: Shkaqet dhe Çështjet e Politikave", korrik 2008.

3. Bean, C (2009), —"Moderimi i Madh, Paniku i Madh dhe Kontraktimi i Madh", Revista "BIS" Nr. 101/2009.

4. Berkmen, P, Gelos, G, Rennhack, R and J.P. Walsh (2009), "Krizat Globale Financiare: Te shpjegosh diferencat ndermjet vendeve ne Impaktin e Autputit". Leter Punuese (Working Paper) e FMN, Nr. 09/280.

5. Eriksson, C (2010), —"Pergjigjja Rregullatore e BE-se ndaj krizes financiare". Raport Konsulenti, Zyra Kombetare e Auditimit e Suedise.

6. International Monetary Fund (IMF) (2009a), —"Gjendja e Financave Publike":

7. A Cross-Country Fiscal Monitor, IMF Staff Position Note 09/25. International Monetary Fund (IMF) (2009b), —World Economic Outlook October 2009: "Mbeshitetja e Rimekembjes Ekonomike", Vrojtime ekonomike dhe finajnciare te botes.

8. Norberg, J. (2009), "Fiasko Financiare: Si fiksimi i SHBA-ve per pronesine mbi shtepite dhe parane e lehte krijoi krizen ekonomike", Cato Institute. Reinhart, C. and K. Rogoff.

10. Turner, A. (2009), —Revista "The Turner Review" —Nje pergjigje rregullatore ndaj krizes bankare globale",

http://www.fsa.gov.uk/pubs/other/turner_review.pdf, (2010-05-03).

11. White, William and Borio, Claudio (2006), "Stabiliteti monetar dhe financiar—Implikimet e rregjimeve te politikave", Revista "BIS", Working Paper No 147.

Prof. Dr. Omer Stringa

Fakulteti i Ekonomisë UT

AUDITIMET E GJYKATËS TURKE TË LLOGARIVE PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE FISKALE

Roli i SAI-ve në ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të politikave financiare kontribuon për të përmirësuar performancën e politikës fiskale dhe për të siguruar transparencën qeveritare dhe llogaridhënien në dobi të qytetarëve.

Nga: ERDEM ELLER,
Auditues i Lartë, Gjykata Turke e
Llogarive¹

Abstrakt

Rritja e deficiteve buxhetore rreth viteve 1980 çoi në rritjen e borxhit publik dhe përkeqësimin e bilancit të financave të shtetit; dëmtime të stabilitetit makroekonomik dhe në kriza ekonomike në një numër vendesh. Pas këtyre incidenteve, rregullat fiskale janë zbatuar gjerësisht në të gjitha vendet.

Ky artikull përqendrohet tek Rregullat fiskale/procesi i zhvillimit të disiplinës fiskale, llojet e zbatimit, legjislacionet primare dhe sekondare në lidhje me rregullat fiskale, rëndësia e auditimeve të Zbatimit të Rregullave Fiskale nga

SAI-t dhe në fund praktika e Gjykatës Turke të Llogarive (TCA) me auditimin e Rregullave Fiskale me ndihmën e temave të mëposhtme:

Zhvillimi i Rregullave Fiskale dhe Disiplina Fiskale;

Bazat e Financave Publike;

Praktika e Rregullave Fiskale në Turqi; Efikasiteti i rolit mbikëqyrës të SAI-ve mbi Financat Publike dhe Praktika e Gjykatës Turke të Llogarive.

Fjalët kyçe: Rregullat fiskale, Disiplina Fiskale, Auditimi i Rregullave Fiskale nga SAI-t, Gjykata Turke e Llogarive.

HYRJE

Rritja e deficiteve buxhetore rreth viteve 1980 çoi në rritjen e borxhit publik dhe përkeqësimin e bilancit të financave të shtetit; dëmtime të stabilitetit makroekonomik dhe në kriza ekonomike në një numër vendesh. Pas këtyre incidenteve, rregullat fiskale janë zbatuar gjerësisht në të gjitha vendet.

¹ Kumtesë e mbajtur në Konferencën e II-të Shkencore të KLSH-së, dhjetor 2013

Rregullat fiskale imponuan një kufizim afatgjatë në politikën fiskale nëpërmjet kufizimeve numerike në zërat e buxhetit. Kjo nënkupton që kufijtë e vendosur nga politikat fiskale, nuk mund të ndryshohen shpesh dhe se disa udhëzime operative vendosen duke specifikuar një objektiv numerik që kufizon një zë të veçantë të buxhetit. Rregullat synojnë të korrigojnë motivimet e pajustificuara dhe presionet për mbishpenzime, veçanërisht në kohë të mira, në këtë mënyrë sigurojnë përgjegjësinë fiskale dhe qëndrueshmërinë e borxhit.

Zhvillimi i Rregullave Fiskale dhe i Disiplinës Fiskale

Zhvillimi dhe Qëllimi i Rregullave Fiskale Gjatë dy dekadave të fundit, rregullat fiskale janë përhapur në mbarë botën. Në vitin 1990, vetëm pesë vende - Gjermania, Indonezia, Japonia, Luksemburgu dhe Shtetet e Bashkuara - kishin rregulla fiskale që mbulonin të paktën nivelin e qeverisjes qendrore. Në Japoni dhe Gjermani, rregullat fiskale kanë një traditë të gjatë që daton në fillim të viteve 1947 dhe 1969, respektivisht, edhe pse respektimi i shtetit ishte i dobët përgjatë kësaj periudhe. Gjatë dy dekadave të fundit, numri i vendeve me rregulla fiskale kombëtare dhe/ose rregullave që tejkalojnë kufijtë kombëtarë u rrit në 76 deri në fund të marsit 2012.² Kjo përfshin, më së fundi, përgjigjet ndaj krizës me qëllim sigurimin e një

angazhimi të besueshëm për disiplinën fiskale afatgjatë.

Rregullat fiskale në BE hynë në fuqi në vitin 1992 me Traktatin e Mastroiitit [dhe Paktin e Stabilitetit (SGP) më 1997], duke kapërcyer nivelin kombëtar. Kushtet më të rëndësishme të këtij traktati janë rregullat numerike që kërkojnë një deficit buxhetor kombëtar në ose nën 3% të PBB-së dhe borxh publik kombëtar jo më tepër se 60% të prodhimit të brendshëm bruto. Për më tepër, SGP gjithashtu përfshin një dispozitë, sipas së cilës vendet duhet të ndjekin objektiva specifike afatmesme (OTP), të përcaktuara në kushtet e bilancit buxhetor strukturor. Me "reformën e gjashtë rregullave" (rregulla strukturore kombëtare të bilancit të buxhetit, zbatim më të fortë të rregullave kombëtare, rregull i ri i borxhit në nivel tej-kombëtarit, etapë e re e shpenzimeve në nivel tej-kombëtarit, kritere më të gjera dhe proces më automatik për të hapur një EDP, procedura buxhetore dhe Këshilla të pavarura fiskale), nga nëntori 2011 është vendosur një rregull i ri për reduktimin e borxhit dhe standardet e rritjes së shpenzimeve.

Objektivat e Rregullave Fiskale:

Sigurimi i Qëndrueshmërisë së Deficitit Buxhetor dhe i Barrës së Borxhit;

Sigurimi i Stabilitetit në Disiplinën Fiskale;

Forcimi i Besimit në Politikat Fiskale;

Sigurimi i një Rënie të Riskut të Principalit për të Reduktuar Kostot e Huamarrjes.

² Andrea SCHAECHTER, Tidiane KINDA, Nina BUDINA, Anke WEBER, **IMF Working Paper**, "Fiscal Rules in Response to the Crisis—Toward the Next-Generation Rules. A New Dataset", WP/12/187, Fiscal Affairs Department, July 2012, p. 10

Llojet e Rregullave Fiskale³

Rregullat e borxhit vendosin një kufi të dukshëm ose të dëshirueshëm për borxhin publik të matur në % të PBB-së. Ky lloj rregulli është më efektiv në drejtim të sigurimit të konvergencës në një objektiv të borxhit dhe është relativisht i lehtë për t'u komunikuar. Megjithatë, nivelet e borxhit kanë nevojë për kohë për t'u ndikuar nga masat buxhetore dhe për këtë arsye nuk japin udhëzime të qarta afatshkurtra për hartuesit e politikave. Rregullat e bilancit buxhetor kufizojnë të ndryshueshmen që kryesisht ndikon raportin e borxhit dhe janë kryesisht nën kontrollin e politikëbërësve. Në këtë mënyrë, rregulla të tilla japin udhëzime të qarta operative dhe mund të ndihmojnë për të siguruar qëndrueshmërinë e borxhit. Rregullat e bilancit buxhetor mund të specifikohen si bilanc i përgjithshëm, bilanc strukturor ose i rregulluar periodikisht dhe ekuilibër "tej ciklit." Ndërsa lloji i parë i rregullit nuk ka karakteristika të stabilizimit ekonomik, tre të tjerët shprehimisht japin llogari për goditjet ekonomike.

Rregullat e shpenzimeve përcaktojnë kufizime në shpenzimet totale, fillestare, ose korente. Kufijtë përcaktohen në mënyrë tipike në terma absolute ose të normave të rritjes dhe herë pas here në përqindje të PBB-së me një afat kohor që varion shpesh nga tre deri në pesë vjet. Këto rregulla nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me objektivin e qëndrueshmërisë së borxhit pasi ato nuk e kufizojnë pjesën e të ardhurave. Ato mund të japin, megjithatë, një mjet operacional për të

sjellë konsolidimin e kërkuar fiskal në përputhje me qëndrueshmërinë, kur janë të shoqëruara nga borxhi ose rregullat e bilancit buxhetor.

Rregullat e të ardhurave vendosin tavane apo dysheme tek të ardhurat dhe kanë për qëllim rritjen e mbledhjes së të ardhurave dhe/ose parandalimin e një barrë të tepërt të taksave. Shumica e këtyre rregullave nuk janë të lidhura direkt me kontrollin e borxhit publik, pasi ato nuk kufizojnë shpenzimet. Duke marrë parasysh trade off-et, shumë vende kombinojnë dy ose më shumë rregulla fiskale. Jo të gjitha llojet e rregullave fiskale në mënyrë të barabartë mbështesin objektivat e qëndrueshmërisë, stabilitetit ekonomik dhe objektivat e qeverisë. Përdorimi i një kombinimi të rregullave fiskale mund të ndihmojë në adresimin e mangësive. Megjithatë, gjatë krizave, shumë vende pezullojnë rregullat e tyre fiskale.

Tronditja ekstreme e prodhimit devijoi ekonominë shumë larg kufijve të imponuar nga rregullat. Për më tepër, dëshira për të siguruar masa stimuluese kundër-ciklike shkoi në shumicën e rasteve përtej kufizimeve për kohët normale.

Duke qenë se pak shtete kishin klauzola shpëtuese në fuqi, rregullat ose nuk zbatoheshin ose pësonin ndryshime duke zgjeruar kufijtë në të njëjtën kohë dhe duke vendosur itinerare rregullues që jepnin pak fleksibilitet në një situatë të pasigurtë ekonomike.

Vetëm pak shtete ishin në gjendje të ndërtonin reformat e tyre të para-krizës për të gjetur dalje nga kriza. Shumë vende të tjera krijuan rregulla të reja ose riorganizuan ato ekzistuese.

Rregullat fiskale të gjeneratës së ardhshme në mënyrë eksplicite

³ SCHAECHTER, KINDA, BUDINA, ANKE, op. cit., p. 7

kombinojnë objektivin e qëndrueshmërisë me më shumë fleksibilitet për t'ju përshtatur goditjeve ekonomike. Shumë prej rregullave të reja vendosin objektiva buxhetore në terma të rregulluara ciklisht ose japin llogari për ciklin në mënyra të tjera.

Disa kombinojnë rregullat e reja të shpenzimeve me rregullat e reja apo ekzistuese të borxhit për të ofruar udhëzime operacionale për qëndrueshmërinë e borxhit.

Kompleksiteti i madh i kuadrit të rregullave gjithashtu krijon sfida të reja. Rritja e numrit të rregullave, ndërveprimi i tyre dhe sofistikimi mund të komplikojnë zbatimin, si edhe të bëjnë pajtueshmërinë më të vështirë për t'u shpjeguar dhe monitoruar.

Për të adresuar sfidën e parë, disa vende po reformojnë procedurat e tyre buxhetore dhe kuadrin buxhetor afatmesëm. Këshillat fiskale mund të luajnë një rol të rëndësishëm me sfidën e dytë. Në disa vende, reformat e fundit të qeverisjes kanë ngritur, ose miratuar plane për Këshilla të pavarura fiskale.

Këto organe mund të rrisin ndërgjegjësimin e votuesve në lidhje me pasojat e disa politikave, duke i ndihmuar ata të vlerësojnë opsione të dëshirueshme dhe të sanksionojnë politikat më të varfra duke siguruar mjete shtesë për zbatimin.

Disiplina Fiskale

Disiplina fiskale është ekuilibri mes të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike. Rritja e rëndësisë së disiplinës fiskale si në mjedisin kombëtar dhe ndërkombëtar mbështetet në deficitet e mëdha në buxhetet e vendeve dhe në rritjen e vazhdueshme në borxhet e tyre publike. Në shumicën e vendeve zbatimi

i reformës fiskale - për të siguruar disiplinën fiskale, duke vënë legjislacionet në praktikë për të rregulluar huamarrjen dhe procedurat e shpenzimeve, duke audituar organizmat e lidhur me përputhshmërinë me këto legjislacione dhe duke aplikuar sanksione në rast neglizhence juridike - jepet nga autoriteti ligjor sipas udhëzimeve të qeverisë qendrore. Në këtë kontekst, auditimi i zbatimit të rregullave fiskale nga SAI ka rëndësi jetike për të siguruar disiplinën fiskale.

Ka tre rregulla themelore për të siguruar disiplinën fiskale: numerike, procedurale dhe rregullat e transparencës.

Rregullat numerike i referohen objektivave sasiore specifike. Ato kanë për qëllim të imponojnë kufizime të përhershme në politikën fiskale, të përcaktuar në mënyrë tipike në aspektin e një treguesi të performancës së përgjithshme fiskale (si bilanci buxhetor dhe/ose borxhi publik). Shembuj të rregullave numerike ka me bollëk në nivelin e qeverisë qendrore ose të përgjithshme. Për shembull, në Bashkimin Evropian, tavanet janë të specifikuara për deficitin dhe raportet e borxhit.

Rregullat procedurale synojnë të përmirësojnë transparencën, llogaridhënien dhe menaxhimin fiskal. Ato zakonisht kërkojnë që qeveria të angazhohet me një strategji të monitorueshme të politikës fiskale, zakonisht për një periudhë shumë - vjeçare dhe të raportojë në mënyrë rutinore, si edhe të publikojë rezultatet fiskale dhe ndryshimet e strategjisë.

Rregullat e transparencës janë të dhëna buxhetore sistematike dhe në kohë (të gjithë informacionit përkatës fiskal) për

të monitoruar objektivat ekonomike, politikat shtetërore dhe rezultatet e tyre.

BAZAT E FINANCËS PUBLIKE

Parimet Bazë

Realizimi i politikës së financave publike të qëndrueshme, transparente dhe të përgjegjshme në linjë me politikat monetare dhe fiskale.

Plotësimi i nevojave financiare me kosto sa më të ulët të mundshme (me kusht që kushtet e tregut ndërkombëtar dhe vendas janë marrë parasysh).

Konceptet e Financave Shtetërore: Qëndrueshmëria, Brishtësia dhe Fleksibiliteti

Performanca e financave shtetërore duhet të vlerësohet me konceptet e qëndrueshmërisë, brishtësisë dhe fleksibilitetit. Masa e borxhit, prirja dhe struktura e tij janë faktorët bazë që ndikojnë në këta tregues.

Qëndrueshmëria është aftësia e një qeverie për të mbështetur shpenzimet e saj aktuale, taksat dhe politika të tjera në afat të gjatë pa kërcënuar aftësinë paguese të qeverisë ose mosplotësimin e disa prej përgjegjësisë të saj ose të shpenzimeve të premtuara. Për shkak të barrës së borxhit, ekonomitë e hapura përballen me probleme të rënda në aspektin e politikave fiskale, si dinamika të përkeqësuar të borxhit që çojnë në një rreth vicioz. Në një rast të tillë, madje edhe mosmarrëveshjet në lidhje me qëndrueshmërinë e borxhit mund të ndikojnë negativisht në pritshmëritë e tregut dhe në këtë mënyrë vetë niveli i stokut të borxhit bëhet një faktor rreziku, duke penguar stabilitetin ekonomik. Në këtë kuadër, analizat e qëndrueshmërisë dhe ndjeshmërisë kryhen në kuadër të

aktiviteteve të menaxhimit të riskut që zbatohen si pjesë e procesit të reformës në menaxhimin e borxhit dhe që vendosen në vëmendjen e politikëbërësve. Për më tepër, përhapja e rezultateve të këtyre analizave nëpërmjet internetit dhe disa publikimeve në përputhje me parimet e transparencës rrit ndërgjegjësimin e publikut.

Brishtësia është analizimi dhe demonstrimi i skenarëve më të keq të mundshëm që rrjedhin nga vartësia e shtetit tek burimet e huamarrjes në dispozicion, në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare dhe tek struktura e maturimit të borxhit.

Fleksibiliteti mund të përkufizohet si: fleksibiliteti i shtetit për të zgjedhur ose për të rritur të ardhurat ose barrën e borxhit për të përmbushur përgjegjësitë e tij.

PRAKTIKA E RREGULLAVE FISKALË NË TURQI

Histori dhe Legjislacion

Objektivi kryesor i politikës fiskale të zbatuar sidomos nga gjysma e dytë e 1990 deri më sot në Turqi është, që të ketë suficit buxhetor, të rrisë të ardhurat e privatizimit dhe të marrë kontrollin e stokut të borxhit të brendshëm nëpërmjet financimit me borxh të huaj. Nga ana tjetër, Turqia ka kufizuar variablat e saj ekonomike së bashku me FMN-në me programin e stabilizimit në vitin 1994, duke marrë një hap të rëndësishëm drejt një politike fiskale të bazuar tek rregullat. Qeveritë kanë vënë politikat e tyre në fuqi, së pari në drejtim të suficitit buxhetor si fillim duke filluar nga kriza e 1994. Objektivi kryesor i suficitit buxhetor, i cili është vënë në praktikë

pas krizës së vitit 2001, është elementi më themelor midis programeve makroekonomike të Turqisë dhe është bërë rregull në programet e mbështetura nga FMN.

Një rregull tjetër i nënkuptuar mund të jetë i lidhur me Kriteret e Mastrihtit. Duke marrë parasysh kriteret e Mastrihtit, duke e çuar borxhin publik në raport me PBB nën 60% dhe duke zvogëluar bilancin buxhetor ndaj PBB-së në 3%, është trajtuar si një tregues i performancës për politikat fiskale dhe është bërë rregull fiskal.

Pas krizës së vitit 2001, në studimet ekonomike dhe financiare që mund të konsiderohen si reforma në Turqi, është e mundur të gjeni shumë elemente të rregullave fiskale. Ato më të rëndësishmet gjenden tek këto legjislacione.

Në këtë kontekst:

Ligji i Financave Publike dhe i Menaxhimit të Borxhit, Nr. 4749, u miratua më 28 mars 2002, ka ri-organizuar dhe disiplinuar menaxhimin e borxhit publik. Me këtë ligj, kufizimi i huave publike është një aplikim i politikës fiskale sipas rregullave. Përveç kësaj, si rregull jo numerik, raportet e menaxhimit të borxhit publik do të përgatiten për çdo tremujor dhe publiku do të informohet për zhvillimet në lidhje me menaxhimin e borxhit publik.

Ligji i Menaxhimit të Financave Publike dhe Kontrollit, Nr. 5018, u miratua më 10 Dhjetor 2003 dhe hyri në fuqi në fillim të vitit 2006 për të ristrukturuar sistemin e menaxhimit të financave publike dhe disiplinën fiskale. Ky është një nga legjislacionet themelore si një përpjekje për të ristrukturuar menaxhimin financiar publik dhe për të

krijuar një disiplinë fiskale. Ky ligj ri-përcaktoi proceset buxhetore, zgjeroi fushëveprimin e buxhetit, rinovoi sistemin e kontrollit financiar tërësisht, projekttoi një sistem të auditimit të brendshëm, vendosi marrëdhëniet mes menaxhimit strategjik dhe performancës, zhvilloi një perspektivë afat-mesme, përcaktoi përgjegjësitë, së fundi infrastruktura institucionale e disiplinës fiskale u fuqizua prej tij. Me këtë ligj, gjatë tre viteve është përcaktuar përgatitja çdo vit e një Programi Afatmesëm (MTP) dhe e një Plani Financiar Afatmesëm (MTFP). MTP përfshin politikat makro, parimet dhe shifrat bazë ekonomike. Ligji ka shkaktuar fillimin e procesit të ligjërimit të buxhetimit të qeverisjes qendrore. Ai rregullon MTFP i cili përfshin të ardhurat e buxhetit dhe vlerësimet e shpenzimeve, tavanet e përvetësimit të administratave publike.

Në MTP, në Pjesën Politika makroekonomike/Politika fiskale, ka një seksion për TCA:

"Qasja e kontrollit dhe auditimit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Auditimit të Menaxhimit financiar, me bazën ligjore të kompletuar në thelb do të zbatohet me të gjithë komponentët e tij. Në këtë kontekst:

Në administratën publike, kjo do të sigurojë që sistemet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm funksionojnë në mënyrë efektive dhe në mënyrë të koordinuar dhe sistemi i kontrollit të brendshëm vepron në mënyrë të shëndetshme.

Në mënyrë që të sigurohet një auditim i jashtëm efektiv në administratat publike, kapaciteti zbatues i Gjykatës së Llogarive do të forcohet. "

Ligji për Pushtetin Vendor, nr 5393, Ligji i Komunave Metropolitane, nr 5216, dhe Ligji i veçantë i Administratës Rajonale, nr 5302, përfshijnë një dispozitë që kufizon mundësinë për të marrë hua për komunat, bashkitë metropolitane dhe administratat e veçanta rajonale, që sipas dispozitave të Ligji Nr 4749 lejohet vetëm për të financuar projektet në programet e tyre të investimeve.

Që nga ndryshimet e Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë në vitin 2001 u hoq avancimi i parave/dhënia hua Thesarit, sektorit publik dhe ndërmarrjeve ekonomike shtetërore; gjithashtu u ndaluan transaksionet në tregun primar të instrumenteve të huamarrjes të lëshuara nga Thesari dhe ndërmarrjet publike.

Të gjitha këto reforma në vendin tonë janë në thelb, një tregues formal i transformimit të procesit të menaxhimit fiskal në menaxhim fiskal të bazuar në rregulla.

Përtej këtyre rregullave, me Programin Afatmesëm që u shpall në shtator 2009, për periudhën 2010-2011, rregulli fiskal në Turqi u vendos zyrtarisht në rendin e ditës. Në këtë kontekst, në vitin 2010 u përgatit edhe "Projektligji për Rregullat fiskale".

Projektligji për Rregullat Fiskale në Turqi Duke qenë se janë aplikuar në mënyrë implicite dhe të pjesshme në Turqi që nga kriza e vitit 2001 këto rregulla u transformuan në një draft tekst ligjor në vitin 2010 me emrin Projektligji për Rregullat Fiskale. Projektligji u përgatit me qëllim që të prezantohej në Parlament. Qëllimi i projektligjit ishte të ruheshin arritjet pas krizës së vitit 2001 në menaxhimin e financave publike dhe për këto arsye ai fokusohet më tepër

në: prodhimin e politikave afat gjata në financat publike, në forcimin e stabilitetit makro ekonomik duke promovuar qëndrueshmëri dhe parashikueshmëri fiskale. Së fundi, ky ligj përqendrohej në përdorimin e rregullave fiskale që e bënin disiplinën fiskale të përhershme.

Përdorimi i rregullave fiskale mbulonte organet administrative publike të përgjithshme si: qeverinë qendrore, administrimin e sigurimeve shoqërore, bashkitë dhe administratën lokale, fondet e rimbursueshme, bizneset publike si edhe Fondin e Sigurimit të të Papunëve. Bizneset publike u përjashtuan nga rregullat fiskale, duke përfshirë këtu edhe ato që do privatizoheshin.

Rregulli fiskal u vendos duke u bazuar mbi parimet e transparencës, përgjegjshmërisë, sinqeritetit dhe thjeshtësisë. Rregulli fiskal është vlerësuar si hapi më i rëndësishëm i ndërmarrë në kontekstin e reformës strukturale në Turqi dhe u vlerësua si një spirancë për ekonominë. Për më tepër rregulli fiskal do të mund të sjellë parashikueshmëri për politikën e financave publike.

Rregulli fiskal i projektuar përbëhet nga dy elementë kryesor:

Deficiti për periudhën afatmesme dhe bilanci buxhetor afat-gjatë ishte parashikuar si 1% e prodhimit të brendshëm bruto (PBB),

Rritja vjetore ishte parashikuar në 5%.

Në kontekstin e rregullave fiskale për t'u aplikuar, ishte parashikuar që ekuilibri i bilancit do të mbështeste punësimin, rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë financiare. Parimi bazë është përsëri disiplina fiskale.

Edhe pse ishte planifikuar që aplikimi të fillonte në vitin 2011, është shtyrë për

më vonë. Megjithatë, një premtim nga qeveria mbetet i besueshëm, "pavarësisht nga rregulli fiskal i vendosur në vend, nuk do të ketë lëshime në disiplinën fiskale".

EFIKASITETI I ROLIT MBIKËQYRËS SË SAI-ve MBI FINANCAT PUBLIKE DHE PRAKTIKA E TCA-SË

Në Përgjithësi

Roli i SAI-ve në ruajtjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të politikave financiare kontribuon për të përmirësuar performancën e politikës fiskale dhe për të siguruar transparencën qeveritare dhe llogaridhënien në dobi të qytetarëve.

SAI-t mund të kontribuojnë për të adresuar qëndrueshmërinë fiskale afatgjatë dhe të nxisin kuptimin e detyrimeve afatgjata të qeverisë me anë të auditimit të pavarur. Ato shqyrtojnë rezultatet e auditimit të financave publike nga viti i kaluar fiskal, për të mbështetur proceset e vendim-marrjes në lidhje me të ardhurat, shpenzimet dhe borxhin publik për buxhetin e ardhshëm, si një hapësirë mundësish.

Auditimi financiar, në përputhje me ISSAI-t (ISSAI 5230: Udhëzime mbi Praktikën më të Mirë për Auditimin e Rregullave Ekonomike), luan një rol të rëndësishëm në auditimin dhe shprehjen e opinionit për borxhin publik.

Për të përmbledhur, SAI-t janë të aftë të kontribuojnë në aftësinë paguese, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë si të financave publike dhe të borxhit publik në periudhën afatmesme dhe afat gjatë. Praktika e TCA-së

Raportet e Transaksioneve të Thesarit, një shtojcë e Deklaratës së Raporteve të Sigurisë, formon bazën e auditimit të jashtëm të Rregullave Fiskale në Turqi që nga fillimi i viteve 2000.

Auditimet u përqëndruan te kreditë, huamarrjet dhe garancitë dhe gjetjet kryesore në lidhje me shumat e kredive kontradiktore dhe procedurat e pasakta të kontabilitetit, të cilat motivuan qeverinë për të aprovuar Ligjin për Financat Publike dhe Menaxhimin e Borxhit (Nr. 4749) në praktikë në vitin 2002.

Me ligjin e përmendur më lart dhe kufizimet e tij, kreditë (përfshirë kreditë e kushtëzuara) u bënë të menaxhueshme në mënyrë të shëndoshë dhe disiplina fiskale u ruajt. Edhe pse aplikimi i Ligjit Fiskal të Turqisë është shtyrë, Raportet e TCA për Transaksionet e Thesarit (së bashku me ligjet e përcaktuara në kapitullin e mëparshëm) ndihmojnë si legjislativin dhe ekzekutivin për të mbështetur menaxhimin e shëndoshë të borxhit. Mbajtja e opinionit publik të informuar për rezultatet e politikave ekonomike është një tjetër përfitim.

PËFUNDIME

Për të siguruar qëndrueshmërinë e financave publike si dhe të borxhit publik në terma afat mesme dhe afat gjata, përputhshmëria dhe përgjegjësia e administratës janë të nevojshme. Për këtë arsye, SAI-t e konsiderojnë të rëndësishme të bazojnë auditimet e tyre në rregullat fiskale (gjendja strukturore buxhetore, kufijtë e borxhit publik) së bashku me sistemet e planifikimit, transparencës dhe llogaridhënies. Qëndrueshmëria e financave publike ka të bëjë me

politikën monetare. SAI-t shqyrtojnë koordinimin aktual midis politikave fiskale dhe monetare.

Rezultatet e auditimeve të financave publike nga SAI-t janë të dobishme si për legjislativin dhe për ekzekutivin, si edhe për qytetarët. Sa i përket praktikës turke, rritja e rolit mbikëqyrës të TCA-së mbi financat shtetërore nëpërmjet Raporteve të Transaksioneve të Thesarit ka efekt pozitiv mbi brishtësinë e mishëruar në ekonomi dhe do të ndihmojë reduktimin e

rreziqeve të një krize të mundshme ekonomike.

Nxitimi i procesit të hyrjes në fuqi të ligjit turk Fiskal nga ana e qeverisë mund të quhet si një tjetër efekt pozitiv i auditimeve të TCA-së.

Nga ERDEM ELLER,
Auditues i Lartë,
Gjykata Turke e Llogarive

AUDITIMI DHE MENAXHIMI I PROJEKTIT

“Nuk mund të hidhet një hap, pa vlerësuar hapin paraardhës”.

**Prof. Dr. Skënder Osmani,
Gjovalin Preçi¹**

“Nuk mund të hidhet një hap, pa vlerësuar hapin paraardhës”.

Abstrakt

Auditimi është një aktivitet kompleks dhe dinamik, gjithëpërfshirës me specifikat përkatëse. Veprimtaria e auditimit në vendin tonë është me përvojë modeste, në hapat e para të auditimit nëpërmjet teknologjisë e informacionit, me burime njerëzore e financiare të kufizuara dhe që njëherësh, vitet e fundit ka përpjekje maksimale që auditimi të kryhet në përputhje me Standartet dhe strategjinë e INTOSAI-t.

Nga ana tjetër shoqëria jonë kërkon nga KLSH të rrisë auditimin si në gjerësi dhe në thellësi, për të realizuar një vlerësim sa më objektiv dhe profesional të performancës së njësive publike, madje vazhdimisht në rritje, problem i cili

bëhet akoma më i mprehtë në kushtet e krizës financiare.

Siç vërehet, KLSH ndodhet në një përballje ndërmjet “kërkesës së lartë për auditime dhe mundësisë së kufizuar për realizime”. Natyrshëm në këtë sfidë kërkohet një strategji me rrugë e metoda te reja, instrumente të rinj, etj . Ne këtë këndvështrim, prezantimi është një përpjekje modeste për të përmirësuar ndonjë problem sado të vogël që ndoshta mund të përfshihet në të ardhmen në strategjinë apo bashkësinë e çështjeve për rritje të reja të performancës së auditimit nga KLSH. Sipas standardeve të INTOSAI-t, për auditimin e aktiviteteve publike, shtrohen dy çështje thelbësore që kanë të bëjnë me pyetjet: çfarë duhet të auditohet dhe si duhet të auditohet në të ardhmen.

Aktivitetet audituese janë shumë të ndryshme, për rrjedhojë edhe metodat e tyre me standardet përkatëse, ashtu siç thuhet edhe në Manualin e Auditimit të Performancës "ato nuk mund të trajtohen si ne një libër kuzhine", pikërisht sepse ato përmbajnë gjëra të ndryshme. Kështu, ngrihet natyrshëm

¹ Kumtesë e mbajtur në Konferencën e II-të Shkencore të KLSH-së, dhjetor 2013

pyetja: po gjëra të përbashkëta a kanë këto aktivitete?

Auditimi është një proces dhe si i tillë ai ka input-in dhe output-in e tij. Në një kuptim të thjeshtuar, procesin me input-in dhe output-in e tij po e quajmë projekt. Pra projekti qëndron në themel të çdo veprimtarie njerëzore.

Duke u mbështetur tek kuptimi i projektit dhe i sistemit, punimi synon të plotësojë sado pak standardet dhe përvojën ekzistuese të aktiviteteve audituese në vendin tonë me kuptimet e “përbashkëta” të tyre që janë projekti dhe sistemi, madje mendojmë se ato mund sado pak e në mënyrë modeste ta zgjerojnë dhe ta thellojnë bazën e auditimit me kuptime e algoritma të rinj për bazën e auditimit, bazën e të dhënave, strukturat, klasat, sistemet eksperte, modelet e algoritmat e kontrollit etj.

Në këtë prezantim trajtohen këto çështje:

- Projekti
- Strategjia
- Menaxhimi i projektit dhe sistemi
- Risku
- Projektit me konflikt interesi
- Sistemi dhe kontrolli
- Dita e punës dhe e projektit

Në fund jepen përfundimet dhe rekomandimet përkatëse në të cilat theksohet që krahas përvojës audituese dhe zgjerimit të saj mbi bazën e standardeve të INTOSAI-t, standardet e projekteve dhe të sistemit (dixhital) të auditimit, me bazën dixhitale të KLSH, qendrat dhe rrjetet përkatëse të auditimit do të mundësojnë rritjen sado pak të performancës së veprimtarisë audituese të KLSH.

Projekti

*Një vendim me mend
e lëviz gurin nga një vend*

Jeta është një bashkësi aktiviteteve njerëzore. Çdo veprim që bën njeriu ka një qëllim të caktuar, për të marrë një rezultat mendor dhe material, shërbim etj. Kjo veprimtari nuk zhvillohet në boshllëk, ajo është një proces që shndërron input-et e procesit në output-e të tij

Input -----Procesi ----- Output

Kuptimi i thjeshtë i projektit.

Me marrëveshje këtë veprimtari njerëzore që shndërron inputet në outpute po e quajmë projekt. Ky është një kuptim i thjeshtuar i projektit që në gjerësinë dhe në thellësinë e tij studiohet në teorinë e menaxhimit të projektit. Këtu me menaxhim do të nënkuptojmë gjithë procesin që nga përcaktimi i qëllimit e deri në realizimin final të tij, marrjen e outputit. Sipas përkufizimit të mësipërm rezulton që jeta shoqërore është një bashkësi projektesh.

Në qoftë se në bashkësinë e projekteve do të konsiderojmë edhe lidhjet, marrëdhëniet ndërmjet projekteve etj., atëherë këtë bashkësi do ta quajmë sistem.

Veprimtaria njerëzore në përgjithësi është komplekse. Në këtë kontekst, veprimtaria mund të shpërbëhet në disa nën veprimtari, këto të fundit në nën-nën veprimtari të tjera e kështu me radhë deri në nën veprimtari të pandashme, që me marrëveshje po e quajmë “crisp”. Në fakt nën ndarja e veprimtarive ka në thelb shpërbërjen e bashkësisë të vetive, deri në veti elementare të pandashme (crisp).

Veprimtaritë që mbulon buxheti i shtetit dhe ato të administrimit të aseteve publike përbëjnë një numër shumë të konsiderueshëm për

auditimin e tyre për një vend si i yni, me vështirësi të shumta nga historia e zhvillimit të tij, etj. Në këto rrethana, auditimi vihet përballë disa pyetjeve: çfarë do të auditohet dhe pse, si do të auditohet, e pastaj me radhë, me çfarë do të auditohet, kur do të auditohet, ku do të auditohet, çfarë do të sjellë auditimi në rrafshin ekonomik, shoqëror, politik, demografik, kulturor arsimor etj.

Secila nga këto pyetje paraqet një problem të rëndësishëm, por në mënyrë të veçantë dy pyetjet e para sepse kanë të bëjnë me përcaktimin e strategjisë së auditimit dhe përmbajtjen e auditimit, përbërjen e bashkësisë të një inputi, deri në veti elementare të pandashme.

Me përkufizimet e mësipërme, del që një veprimtari njerëzore, mund të jetë një ose disa bashkësi projektesh dhe jeta si një shume e të gjithë këtyre projekteve është vetëm një projekt.

Kur bëjmë fjalë për projekt, kemi parasysh përfitimin e një outputi të ri që ndryshon në të paktën me një veti nga outputet e ngjashme me atë paraardhës të tij. Këtu fjala “i ri” nënkupton zhvillimin, pra ndryshim pozitiv, sepse përndryshe vetë outputi, pra edhe projekti përkatës nuk kishte pse të realizohej.

Që këtë, kur them që jeta është projekt, del që projekti është masë e zhvillimit të saj, pak më ndryshe nëse vihet re që jeta “nuk shkon mire” arsyet duhet ti kërkojmë në bashkësinë e përpjekjeve, në sistemin e tyre. Ç’do të thotë ti kërkojmë? Në një gjuhë të thjeshtë të bëjmë kontrollin e projekteve, vlerësimin e tyre e njëherësh të marrim masa për realizimin e tyre.

Pra, të metat dhe të mirat e një zhvillimi shoqëror duhen kërkuar, kontrolluar, angazhuar dhe vlerësuar në projektet apo sistemin përkatës të tyre. Kuptohet që pa këtë “vlerësim” apo auditim të përgjithshëm të projekteve nuk mund të bëhet fjalë për zhvillim të mirëfilltë shoqëror (e aq më pak shkencor) të saj. Pak më ndryshe, projekti dhe auditimi i tij janë një kusht i nevojshëm i zhvillimit të një veprimtarie ekonomike etj., ose çdo veprimtari ekonomike realizohet me një projekt. Kjo do të thotë që një veprimtari ekonomike ka një projekt dhe çdo kontroll dhe vlerësim i hallkave përbërëse të veprimtarisë nuk mund të bëhet pa projekt. Shkurt, Kontrolli i Lartë i Shtetit në një institucion shtetëror e fillon punën e tij kur në tavolinën e punës ka projektin e veprimtarisë së institucionit që do të auditohet.

Meqenëse auditimi i projektit është veprimtari njerëzore, ai vetë është një projekt që synon realizimin e qëllimit të auditimit. Pra kur fillon auditimi kemi dy projekte, njëri përballë tjetrit, projektin burim (të subjektit që auditohet) dhe projektin e auditimit.

Siç dihet, pas auditimit bëhet një raport. Vetë ky raport është një projekt që ka një input, projektin burim (të institucionit eventualisht edhe me ndryshimet që propozon audituesi), ndërsa si rezultat atë të propozimeve të raportit.

Nga përkufizimet e dhëna del që projekti është një kuptim i përgjithshëm i një veprimtarie të çfarëdoshme njerëzore që karakterizohet nga inputet, procesi, outputi. Thjeshte, ai është një kompjuter që shndërron (transformon) inputet ose burimet (të dhënat e tyre) në output (rezultat).

Ndryshe ai është një problem “jepet-kërkohet” dhe që zgjidhja e tij (e problemit) është ajo që parashikohet për tu realizuar nga outputi.

Përveç inputeve, operatorëve dhe outputeve, projekti ka edhe tipare (karakteristika) të tjera, p.sh koha e realizimit, kostoja e prodhimit etj.


P.sh një projekt synon një kosto minimale të outputit për inpute (dhe procese) të dhëna, ose maksimum të outputit për burime financiare të dhëna. Nga një pikëpamje, një projekt në mënyrë të thjeshtuar, karakterizohet nga :

Burimet dhe proceset (inputet)

Koha e realizimit (afati i projektit)

Performanca

Këtu me performancë kuptohet, optimizimi i një faktori (kosto, prodhim etj). Duke pasur parasysh që koha është para dhe koha e realizimit është tregues i performancës, në paraqitjen grafike të mëposhtme po i përmbahemi trekëndëshit që ndeshet jo rrallë herë në literature.



Siç duket një nga themelet e auditimit të një aktiviteti janë 3E, (ekonomiciteti, eficaenca dhe efektiviteti). Këtu lind pyetja e natyrshme: optimizimi i treguesve të një projekti a përkon, puqet apo ndryshon nga performanca e 3E? Kjo kërkon një analizë të hollësishme, megjithatë në thelb optimizimi i përmban 3E-të (burimet, ekonomizimin e tyre, eficaencën=koston). Natyrisht që ka edhe specifika, sepse përndryshe

ndërmjet tyre do të vihej shenja e barazimit. P.sh në auditimin e performancës është i rëndësishëm fakti se si shkojnë objektivat e parashikuara me ato të realizuara. P.sh objektivi i parashikuar sa i mundshëm apo sa i përafërt ka qenë me atë të realizuarin. Këtu tek fjala “i mundshëm” apo “i përafërt” janë ndërthurur dy kuptime: risku propabilitar (statistikë) dhe risku i pa përcaktuar. Në këtë mënyrë skema e treguesve të projektit plotësohet si më poshtë:



Megjithatë efektiviteti i një projekti nuk mund të konceptohet pa performancë (optimizim) dhe kjo e fundit është “pazgjidhshmërisht” me risk, del që nuk mund të bëhet kontrolli dhe vlerësimi i projektit, pa një analizë dhe vlerësim të riskut. Pak më ndryshe, vlerësimi i riskut do të thotë mënjanim gabimi dhe njëherësh rritje efektiviteti. Pra risku është komponent i rëndësishëm (themelor) i një projekti.

Strategjia

Pa strategji

nuk ka veprimtari

Aktiviteti i auditimit të performancës në KLSH ka ardhur duke u rritur nga pak auditime në 2007 në 13 të planifikuara në vitin 2013. Ai ka filluar me forma të thjeshtë auditimi dhe sot ka arritur dhe në trajta komplekse e integrale. Sipas kuadrit ligjor ekzistues të KLSH, objekti kryesor i veprimtarisë së tij është kontrolli i përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike dhe i zbatimit të ligjshmërisë në fushën

ekonomike dhe financiare. Bazuar në këtë infrastrukturë ligjore, detyrimet e KLSH janë shumë të mëdha, sepse lidhen me të gjithë veprimtaritë ekonomiko-financiare që mbulohen nga buxheti i shtetit dhe nga zhvillimi i aseteve publike. Për këtë qëllim kërkohet një strategji shkencore gjithëpërfshirëse, me kapacitete cilësore dhe ritme të larta. Ajo duhet të mbulojë fushat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomiko- shoqëror të vendit dhe njëherësh me kostot minimale, ose duhet të jetë një perspektivë integruese e bashkëpunuese me institucionet shkencore të vendit (universitetet, akademitë, organizatat e pavarura joqeveritare, ekspertë të fushave të ndryshme), me institucionet ndërkombëtare (INTOSAI, EUROSAI, SAI-et e vendeve me përvojë) me organizata të rëndësishme ekonomiko-financiare ndërkombëtare (Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve etj.).

Theksojmë që në dy vitet e fundit puna e KLSH është përmirësuar, ndërsa bashkëpunimi me institucione të ndryshme ndërkombëtare është premtues.

Detyrat që dalin aktualisht përpara KLSH është përfshirja e objektivave të reja në strategjinë e zhvillimit të këtij institucioni, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të saj, si dhe duke e konsideruar strategjinë si një bashkësi të të gjithë alternativave të mundshme për realizimin e qëllimit të dhënë.

Duke pasur parasysh që KLSH në bashkësinë e detyrave të tij ka objektiv themelor përdorimin efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirë administrimit financiar, zbatimin

e ligjshmërisë në fushën ekonomike, financiare etj., del që KLSH duhet të disponojë të gjitha mjetet e nevojshme, burimet e informacione, njerëzore, financiare, teknologjike, dixhitale etj., duke cilësuar:

Strategjinë e zhvillimit të vendit për një periudhë afat shkurtër, afatmesëm dhe vjetore, e cila shërben për hartimin e Strategjisë së KLSH, pasi nuk mund të konsiderohen të shkëputura njëra me tjetrën, në funksion të mirëqeverisjes në tërësi.

Projektet themelore të zhvillimit të ekonomisë që do të mbulohen nga buxheti i shtetit, për periudhën që KLSH do të hartojë strategjinë e tij. P.sh për vitin 2014 KLSH duhet të ketë në tavolinë listën e projekteve të parashikuara nga qeveria, së bashku me treguesit kryesor përkatës.

Projektet e bashkëpunimit me donatorë të huaj që janë në veprim apo që parashikohen për t'u zbatuar.

Informacionin e nevojshëm që lidhet me menaxhimin e projekteve, konkretisht me përgjigjet e pyetjeve të menaxhimit çfarë, pse, si, kur, ku, me çfarë etj etj. apo me specifikat e veçanta për burimet njerëzore, të burimeve natyrore në vendet e punës, me mbrojtjen e mjedisit, me financimet nga jashtë dhe ato publike etj, po kështu për faktorët e ndryshëm shoqëror, natyror, teknologjik, mjedisor, politik, etj që ndikojnë negativisht në realizimin dhe suksesin e projekteve, shkurt që i rrishtojnë ato.

Këto veprimtari (krahas objektivave të tjera të KLSH) që kanë një vëllim të madh të informacionit që duhet të ruhet, të grumbullohet, trajtohet, seleksionohet, përpunohet etj., gjithnjë e më tepër me teknologji të reja

(dixhitale). Që këtej mund të lindë ideja që sa më shpejt të fillojë puna për ngritjen e një njësie (departament, seksion, qendër biblioteke dixhitale) për rezervimin e të gjitha projekteve dixhitale që do të auditohen në të ardhmen. Kuptohet që kërkohet që hap pas hapi e paralelisht të përmirësohet vazhdimisht metoda e punës dhe organizimit të saj për auditimin dixhital, psh të ketë një normë ligjore që dokumentacioni që do të auditohet duhet të jetë dixhital (disqe ose bartës të tjerë të informacionit). Po kështu, një udhëzues për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së projekteve dixhitale, njëherësh duhet të rriten përpjekjet për kualifikimin dhe specializimin e punonjësve në fushën dixhitale të komunikimit etj.

Ngritja e kësaj njësie mund të ketë disa vlera:

Kompaktëson dhe globalizon vëllimin e informacionit në mënyrë dixhitale;

Përshejton seleksionimin, trajtimin, përdorimin dhe vlerësimin e tij;

Mundëson futjen e metodave e teknikave të reja të auditimit në një terren më rigoroz (matematikë, informatikë, etj.) dhe njëherësh rrit efektivitetin e tyre në cilësinë e auditimit;

Hap perspektivën për zhvillimin e fushave e disiplinave të reja më teorike të kontrollit matematik, të sistemeve të kontrollit, të automatizimit e robotizimit, të kërkimeve operacionale e të analizës së vendimit, analizës e menaxhimit të riskut, të teorisë "fuzzy";

Zgjeron dhe thellon auditimin me objekte të reja pune që e çojnë atë deri në vlerësimin e optimizimeve të projekteve që auditohen, të risqeve të gjetura e të njësuara në projekt, etj;

Rrit përvojën përgjithësuese të auditimit dhe nivelin shkencor të saj, shkurt rrit globalizimin e veprimtarisë së kontrollit dhe të qeverisjes së tij, më saktë "e-qeverisjen" me mjete elektronike, Krijon mundësi për të ardhmen që auditimi të kryhet pa vajtur përgjithësisht e në mënyrë të detyruar tek "dera e institucionit që do të auditohet";

Përmendim kalimthi që futja e kësaj teknologjie përveç globalizimit me rrjetet dixhitale përkatëse çon dhe në kompaktësimin e strukturave qeverisëse, jo vetëm brenda KLSH por edhe jashtë tij.

Menaxhimi i projektit dhe sistemi

Përpara çdo autoriteti auditues ngrihen dy pyetje themelore: Çfarë do të auditojmë dhe si do të auditojmë. E para ka të bëjë me strategjinë e auditimit, ndërsa e dyta me cilësinë dhe eficiencën e tij. Kjo e fundit realizohet dhe zbatohen në mënyra të ndryshme nga SAI-et e vendeve evropiane, sepse ato konsiderojnë specifikat e vendit, objektet e auditimit, kushtet e zhvillimit (shoqëror, ekonomik, politik, krizat, etj).

Sipas INTOSAI- t auditimi i performancës mund të orientohet nga tre qasjet e mëposhtme:

Rezultatet

Problemi

Sistemi

Përmbajtja e çdo njëres prej këtyre qasjeve shpaloset përkatësisht nga pyetjet:

Cilat janë rezultatet e performancës dhe a janë përmbushur kërkesat dhe objektivat e saj?

Cilat janë problemet që janë konstatuar gjatë auditimit, shkaqet dhe pasojat e tyre?

Cilat janë elementët themeltar të sistemit, rezultatet e performancës dhe problemet e konstatuara, anët pozitive dhe negative të çdo njërit prej tyre, etj. Njëherësh për vendin tonë këto tre pyetje përmbliken në një të vetme: si janë audituar aktivitetet e ndryshme publike? Kjo pyetje kërkon studime e analiza të përgjithshme për metodat e auditimit etj. Megjithatë mund të themi që ato janë fokusuar kryesisht në dy aspekte themelore: auditim financiar dhe ai i performancës së 3E-ve (ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti). Përmendim kalimthi që në mjaft vende, SAI-t në punën e tyre audituese i marrin në konsideratë dy kriteret e mësipërme. Krahas këtyre ka edhe vende të tjera që me vizionet e tyre kërkojnë të zgjerojnë, madje dhe ti tejkalojnë këto kriteret.

Përveç kësaj po të shqyrtohet strategjinë e veprimtarisë së INTOSAI gjatë 15 viteve të fundit (që nga Konferenca e Montevideos e 1998) vihet re se kjo strategji është bërë më komplekse dhe është përmirësuar nga një konferencë ndërkombëtare në tjetrën. Mund të mendohet që qëllimi themelor i këtij ndryshimi është që strategjia në fjalë të përshtatet në mënyrë sa më të plotë e të përgjithshme zhvillimit kompleks të shoqërisë, që kontrolli të ishte sa më eficient të paktën në aspektin ekonomik e juridik. Natyrisht, që sfida të tilla qëndrojnë edhe para vendit tonë.

Këtu menjëherë lind natyrshëm pyetja: si do të auditohet, cilat janë formatet e metodat me të cilat do të punohet në të ardhmen? Kuptohet që përvoja jonë e deri tanishme është modeste dhe e pa formësuar, e kushtëzuar nga një kompleks rrethanash që çojnë në një përfundim të parë që ne duhet të

vazhdojmë zgjerimin e përvojave ekzistuese të auditimit dhe sipas rastit, të mendojmë e të operojmë për një thellësi e ndryshim cilësor të tyre.

Natyrisht, auditimi financiar është një komponent shumë i rëndësishëm i kontrollit të çdo aktiviteti publik (dhe jo publik), paraja sot flet shumë si për zhvillimin në tërësi të aktivitetit, pavarësisht nga specifikimet e tij, burimet njerëzore, natyrore, teknologjike, mjedisi, sociologjia, politika etj. Megjithatë, kur kontrollohet një aktivitet financiar, audituesi mund të mos fokusohet në procesin e parës, e atë më pak bashkësinë e të gjithë proceseve që e prodhojnë apo “konsumojnë” parën. Në këtë këndvështrim mund të jetë i diskutueshëm qëndrimi nëse audituesi mund të duhet të ketë njohuri në përgjithësi për proceset e aktivitetit. N.q.s.e po dhe duke pasur parasysh që bashkësia e proceseve të një aktiviteti përbën projektin përkatës, del që audituesi mund të rrisë vlerën e kontrollit që bën nëse është i prirur të njohë projektin e aktivitetit. Pak më ndryshe kur bëhet fjalë për auditimin financiar apo një auditim specifik tjetër, ai nuk duhet ta shikojë këtë si një organ të vetëm në trupin e aktivitetit, por të njohë të gjithë lidhjet e tij edhe me organet e tjera që janë inputet, outputet, teknologjia, mjedisi, kolateralet. Shkurt është e dobishme që audituesi të njohë strategjinë dhe alternativat, qëllimin dhe objektivat, projektin e aktivitetit, veçanërisht kur aktiviteti është kompleks. E më pas, në sintoni me projektin që do të auditohet, audituesi duhet të përgatisë projektin e auditimit, në të cilin të paraqiten koha e auditimit, kostoja e auditimit, burimet e

teknologjitë e auditimit, optimizimi i auditimit, etj, etj. Në këtë mënyrë, del që kur është e mundur dhe shihet si një vlerë e shtuar, audituesi programin e tij të auditimit duhet ta paraqesë në trajtën e një projekti (ndoshta edhe elementar) ku të jetë afati, kosto, optimizimi i projektit, risku, etj.

Përmendim kalimthi që kuptimi, formati i projektit dhe metodat që zbatohen në përgjithësi në një projekt që auditohet, si rregull janë më komplekse se ato në një aktivitet financiar specifik apo edhe në manualin e INTOSAI-t. Ky argument kërkon një diskutim të veçantë që del jashtë qëllimit të vënë, megjithatë në këtë kontekst, më poshtë po trajtojmë vetëm riskun që është një element i përbashkët i kuptimit të projektit dhe i udhëzuesit të INTOSAI-t për "Auditimin e performancës".

Risku

Siç dihet për riskun ka disa teori e për rrjedhim disa përkufizime. Pavarësisht nga këto, risku sot është efektivitet, para, kohë e shkurtuar, etj. Pikërisht për këtë, analiza e riskut e veçanërisht menaxhimi i tij është njëherësh edhe analizë apo evidence për mashtrime, gabime eventuale, etj.

Më poshtë, në mënyrë të thjeshtuar e konsiderojmë riskun: masë (p.sh përqindje) e mos realizimit të një objekti (këtu fjala objekt është sinonim i fjalës objektiv). Siç dihet realizimi i një objekti kryhet nëpërmjet një ose disa procesesh dhe secili prej këtyre të fundit ka një mundësi realizimi, më tepër risku i objektit është një shprehje e "koncentruar" e risqesve, e mundësisë së ngjarjeve që çojnë në mosrealizimin e objektit, ose në përgjithësi të qëllimit të projektit. Po sjellim një shembull nga auditimi i projekteve me burime të huaja

financimi, në të cilat konstatohen dukuri negative që sjellin risqet përkatëse. Kësisoj:

Vazhdon të mbetet problematike realizimi në afat i projekteve, të shoqëruara me nivele të ulta disbursimi në krahasim me programin e marrëveshjes.

Cilësia e dobët e shërbimeve të projektimit në fazën e negocimit, hartimit e nënshkrimit të marrëveshjeve është një shqetësim i përhershëm.

Në projektet e infrastrukturës rrugore, një nga shkaqet kryesore të vonesave dhe rritjes së koston janë shpronësimet, ku përgjithësisht projektet nisin dhe kontratat nënshkruhen pa përfunduar plotësisht shpronësimet. Krahas këtyre, pamundësia financiare për kompletimin e plotë të segmenteve të veçanta rrugore ka çënuar sigurinë rrugore dhe standardet evropiane.

Jo në të gjitha rastet mbahen garancitë bankare për kontratat e nënshkuara, duke lënë shkak për mosmarrëveshje të detyrimeve kontraktore dhe mungesë penalizimi, kryesisht për kontratat e shërbimeve të konsulencës.

Mungesa e bashkërendimit të kohës së përfundimit të projektit me përgatitjen dhe kualifikimin e personelit të nevojshëm për të vënë në zbatim investimet e kryera.

Paaftësia e njësive të menaxhimit që ka shkaktuar zvogëlim të rezultateve dhe vonesa në realizimin e objektivave.

Cilësia e dobët e shërbimit të supervizionit gjatë zbatimit të kontratave, që është pasqyruar në mosrealizimin e parametrave teknikë, të përcaktuar në marrëveshje për punimet e raja apo rehabilituese.

Në fushën e prokurimeve janë hartuar kontrata pa objekt të matshëm dhe pa sanksione për mosarritje të treguesve.

Subjektet shtetërore përfitues nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur marrjes në dorëzim dhe administrimit të objekteve të projekteve.

Kontabilizimi, inventarizimi dhe arkivimi i dokumentacionit të projekteve ka lënë shumë për të dëshiruar.

Që këtej shihet se ndërtimi i këtyre projekteve në përgjithësi dhe i riskut në veçanti do të ishte i mangët, në qoftë se nuk njihen proceset që formësojnë objektet e projektit, faktorët nga të cilët ato kushtëzohen, bashkëlidhjet e tyre, masën e riskut të secilit prej tyre, etj. Pra është mirë që audituesi të njohë procesin që gjeneron riskun, në një kuptim të përgjithshëm dhe projektin e aktivitetit, madje në rastin e projekteve inxhinierike do të thonim që njohja e procesit nga audituesi është kusht i nevojshëm. Po sjellim një shembull nga auditimi i riskut.

Vlerësimi i riskut ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, madje sipas Gray dhe Mansol, përbën çështjen kryesore të auditimit.

Në auditimin financiar, risku shpreh një opinion auditimi të pamjaftueshëm sepse deklaratimet financiare janë të shtrembëruara. Përmendim që risku financiar ka tri komponentë që janë: a. Risku koherent ose i brendshëm, b. Risku i kontrollit dhe c. Risku detektiv ose zbulues.

Risku i brendshëm ka të bëjë me bilancet e kontabilitetit të kryera në mënyrë individuale ose kolektive, por që kanë informacion të gabuar; risku i kontrollit ka të bëjë me informacione të gabuara që zbulohen gjatë kontrollit, ndërsa risku detektiv quhet i tillë sepse

një procedurë auditimi nuk zbulon dot informacionin me gabime e për këtë mund të kërkohej "sipërmarrje" të tjera.

Auditimi i riskut në projektet inxhinierike është më i gjerë, kompleks, i përgjithshëm, etj, sepse të tilla janë kryesisht proceset që ndërthuren që nga të dhënat, ligjet, eksperimentet, testet, proceset teknologjike e mjedisore, marrëdhëniet dhe modulet e tyre, etj. Pra kërkesa ndaj detyrave të audituesit për vlerësimin e riskut nuk është e njëjtë për audituesin financiar dhe atë të një projekti inxhinierik.

Nga sa më sipër del që "qasjet" ndaj riskut në auditim e performancës të një aktiviteti financiar, etj., janë të ndryshme nga ato të auditimit të një projekti inxhinierik. Kjo është edhe një arsye që auditimi i projekteve të parashikohet në manualët përkatëse dhe jo në ato të auditimit tradicional të performancës.

Në këtë kontekst, meqenëse në vendin tonë realizohen projekte të ndryshme inxhinierike, në fushën e energjisë, naftës, burimeve minerale, të hidrocentraleve, mjedisit, etj., del në pah kualifikimi i burimeve njerëzore audituese të projekteve, sigurimi i literaturës së nevojshme, marrja e përvojave të huaja, hartimi apo përshtatja e një manuali për auditimin e projekteve, si dhe hartimi i normave ligjore për riskun e projekteve, që për fat të keq mungojnë deri më sot në vendin tonë.

Problemi i auditimit të projekteve është edhe më i gjerë se kaq kur bëhet fjalë për bazën e informacionit, krijimin dhe zhvillimin e traditës së auditimit, rritjes së efektivitetit të auditimit etj. Në këtë vështrim ndoshta ka ardhur koha për

ngritjen e një baze dixhitale pranë KLSH-së, për projektet dhe veprimtaritë ë tjera audituese publike etj., gjë që kërkon një studim të veçantë, duke i kaluar caqet e një prezantimi.

Projekte me konflikt interesi

Në projekt çdo njeri i ndershëm është mbret, mirëpo jo çdo mbret është i ndershëm

Çdo projekt pavarësisht nga fusha e zbatimit të tij hartohet në përputhje me ligjet e shtetit e me synimin e optimizimit të gjithë burimeve, faktorëve dhe marrëdhënieve të tyre, për arritjen e një qëllimi të caktuar. Në këtë vështrim, projekti është një optimizim me kushte i veprimtarisë që ai pasqyron, ndërsa nga pikëpamja e “zhvillimit” ai është një ekuilibër i qëndrueshëm i proceseve dhe sistemeve të tyre.

Por jo gjithmonë ky ekuilibër ruhet e aq me pak të jetë i qëndrueshëm. Në të tilla rrethana projekti del jashtë qëllimit e optimizimit të tij dhe duhen “ngacmime”, madje ndërhyrje nga jashtë për ta normalizuar. Pavarësisht se çdo njeri i ndershëm për punën e tij në projekt është “mbret” ka raste që jo çdo mbret është njeri i ndershëm, e aq më tepër kur është i mangët në dijet e tij.

Sido që të jenë në një projekt mangësitë në dije (të qëllimshme ose të paqëllimshme) ato zvogëlojnë treguesit e performancës, madje degjenerojnë ato aq sa në disa raste i bëjnë projektet të bartin konflikt interesi.

Në një vorbull të tillë mund të ziejnë shumë projekte që me kalimin e kohës nxehen shumë, aq sa mund të mos preken nga nxehtësia dhe kaosi që ato krijojnë, duke penguar mjaft zhvillimin. Ka disa shembuj, po përmendim disa syresh:

Një projekt i shfrytëzimit të një vendburimi nafte apo i energjisë të një rezervuari ujëmbajtës mund të realizojë treguesit e performancës, por nuk mund të konsiderohet optimal në kuptimin e mirë, sepse ai nuk plotëson kriteret e nevojshme të projektit. Në një projekt kromi, në të cilin operojnë me dhjetëra kompani private, mund të realizojë treguesit e planifikuar të prodhimit, ndoshta edhe me investime minimale, por pa plotësuar treguesit e efektivitetit, lë krom në galeri që nuk shfrytëzohet në vijim, nuk plotëson performancën e teknologjisë, etj. Po kështu një ndërmarrje nafte realizon prodhimin, por jo performancën në mbrojtjen e mjedisit, të shoqërisë, etj. Po kështu edhe në fushën e energjisë së rinovueshme, psh një basen ujëmbajtës mund të shfrytëzohet me një numër veprash hidroteknike, por pa realizuar “performancën” energjitike, etj. Konflikti është akoma më i gjerë: projekti i arsimit të lartë realizon hapjen e një numri të madh universitetesh paralelisht me universitetet shtetërore. Në pamje të parë duket që qëllimi i tyre është studentë në hyrje të diplomuar në dalje, mastera dhe doktorantë, ndërsa më pak puna dhe investimi i tyre në projekte, kualifikime të pjesshme, të vazhdueshme e të ndryshme të kuadrit të lartë me kurse verore etj. Në këtë vështrim, vështirë se mund të justifikohet prapambetja relative e shumë punonjësve që përfshihen në aktivitetet publike të buxhetit të shtetit pa një kualifikim të herëpashershëm që mund dhe duhet të bëjnë institucionet e arsimit të lartë.

Vërehet që çdo njëri nga shembujt e mësipërm përmban në thelb një konflikt sepse realizon “performancën”

brenda institucionit të tij, por ajo nuk puqet me interesa (kushte) jashtë institucionit të ministrive përkatëse, të Ekonomisë e Energjetikës dhe Arsimit. Në pamje të parë duket që kjo sëmundje e konfliktit të interesit mund të parandalohet në qoftë se dukuria përkatëse do të vëzhgohet e kontrollohet që në fillim të herës nga institucione që dalim përmbi institucionet e sipërpërmendura, ndër këto edhe KLSH, në qoftë se kuadri ligjor do ta bënte të mundur këtë gjë. Si rregull parandalimi është një masë më efektive se diagnostikimi apo shërimi i një sëmundjeje. Pra që të parandalohen (prevenohen) projekte me konflikt interesi duhet që institucione të caktuara, p.sh KLSH të ketë kompetenca ligjore për vëzhgimin, monitorimin dhe vendimin juridik përkatës.

Sistemi dhe kontrolli

Nuk ka sistem pa kontroll

Për studimin e një dukurie ose një objekti është e nevojshme të njihet struktura e objektit (pjesët ose elementët e punës së tij) dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre elementëve, e më pas të bëhet investigimi i dukurisë nëpërmjet informacionit (të dhënave dhe ligjeve që kushtëzojnë atë), kontrollit, vlerësimit etj., ose siç thuhet ndryshe "Kontrolli i menaxhimit".

Çfarë do të thotë kjo? Për familjarizim po sqarojnë më parë disa kuptime:

Objekt është një bashkësi e vetive.

Bashkësinë e alternativave të mundshme për realizimin e qëllimit (dhe e kushteve të tjera) e quajmë strategji.

Projekti është varianti optimal i një strategjie që zbatohet në praktikë.

Menaxhim është veprimtaria që fillon nga krijimi i qëllimit të një projekti, përcaktimi i tij, hartimi etj. dhe deri në arritjen e qëllimit (outputit) të tij. Menaxhimi përbëhet nga dy nën-veprimtari kryesore që janë strategjia dhe projekti. Kur flasim për menaxhim kontrolli kemi parasysh kontrollin e projektit.

Kujtojmë që procesi është ndryshimi të paktën i një vetie të një bashkësie, ndërsa sistemi është një bashkësi objketesh, procesesh (projektesh) ose ndryshe një strukturë në veprim. Meqenëse një bashkësi përbëhet nga disa nën bashkësi e kështu me radhë del që sistemi mund të përbëhet nga nënsisteme të rendit të parë, këto të fundit nga nënsisteme të rendit të dytë, etj.

Një nga prurjet e zhvillimit shoqëror ishte dhe kompleksiteti i tij. Në këtë vështrim, projekti nuk është një kuptim i dhënë njëherë e përgjithmonë, i mbyllur dhe "i patundshëm", veçanërisht kur çështje të caktuara dalin jashtë tij. Në këto rrethana, del nevoja që të zgjerohet dhe të thellohet apo të përgjithësohet, që në fund të fundit zbatimi i tij të jetë më i lehtë e më efektiv. Një zgjerim i kuptimit të projektit është sistemi. Po sjellim një shembull.

Në zhvillimin e legjislaturës aktuale është parashikuar hapja e 300.000 vendeve të punës në përputhje me projektet specifike në bujqësi, industri, turizëm, biznes etj. Megjithatë, problemi i vendeve të punës dhe i lidhjeve eventuale reciproke mund të dalë jashtë karakterit "lokal apo specifik" dhe nëse kjo ndodh, ai i takon një institucioni më të përgjithshëm, të themi një sistemi apo projekti

kombëtar. Nga sa më sipër, duket që problemet e veçanta të projekteve specifike në rrethana të caktuara mund e duhet të strukturoren në tërësinë e tyre, ose siç thuhet ndryshe në mënyrë holistike. Kuptimi që bën të mundur realizimin e këtij qëllimi është sistemi, ndërsa teoria përkatëse quhet teoria e sistemit. Sipas kësaj teorie çdo dukuri në një entitet, objekt etj., studiohet në tërësinë e saj, pra metodikat e kësaj teorie janë holistike.

Teoria e sistemit është një bashkësi disiplinash që studiojnë veprimtari të ndryshme nëpërmjet anëve të përbashkëta abstrakte të tyre e modeleve përkatëse (kryesisht matematike). P.sh klasa e studentëve është një sistem, aktivitetet e auditimit përsëri përbëjnë një sistem, etj.

Teoria e sistemit është mjaftë popullore dhe gjen zbatim të rëndësishëm në sociologji, inxhinieri, biologji, në teorinë e organizimit etj. Përveç këtyre mendojmë që kjo teori ka të ardhme edhe në auditimin e shumë aktiviteteve, veçanërisht kur ato mund të grupohen në klasa ose bashkësi edhe më të gjera që karakterizohen nga bashkëlidhje të caktuara. Edhe në jetën e përditshme kuptimi i sistemit është bërë i rëndomtë, psh flasim për sistem kombëtar, sistem të arsimit, të universiteteve, shkollave, etj.

Në fokusin e auditimit, pse është i rëndësishëm kuptimi i sistemit? Ai është një kuptim më i përgjithshëm se auditimi tradicional, ai përfshin në përgjithësi burimet njerëzore, natyrore, financiare, teknologjike, komunikimet, rrjetet, etj., brenda dhe jashtë tij që i shërbejnë auditimit kombëtar dhe gjithçka tjetër të mundshme për t'u planifikuar në të ardhmen.

Sistemi është një bazë më e gjerë për hartimin e strategjisë së auditimit, krahasuar me strategjinë ekzistuese, p.sh kualifikimi i burimeve njerëzore.

Sistemi rrit mundësinë dhe nivelet e komunikimit dhe njëherësh sasinë e cilësinë e informacionit, shkurt nivelin shkencor të tij.

Sistemi mundëson përdorimin dhe zbatimin e metodave më të përgjithshme të studimit dhe kërkimit shkencor, etj.

Sipas Wikipedias, kontrolli është vlerësim i një personi, organizate (ky është një kuptim më i zgjeruar i aktivitetit, projektit) sistemi, etj., ndërsa kibernetika është një disiplinë (metodë) për kërkimin e sistemeve rregulluese, strukturave të tyre, kushteve dhe mundësive. Që këtej del vendi dhe roli i sistemit si objekt për kontrollin e veprimtarive apo për studimin e qëndrueshmërisë e rregullin e tyre.

Edhe kontrolli ka teorinë e vet që është një disiplinë ndërmjet disiplinave kryesisht inxhinierike, matematike, por jo më pak kjo vlen edhe për sistemet financiare, apo të tjera sisteme ekonomike, mjedisore, etj. Dinamika e sistemeve ka modelet e saj kryesisht matematike në trajtën e transformimeve të ndryshme si ato të Laplasit, filtrat Wiener, Kalman, etj.

Që këtej, për studimin e kontrollit të një projekti, sistemi, etj. është i nevojshëm studimi i dinamikës së sistemit pra edhe i modeleve të kësaj dinamike. Pak më ndryshe e në mënyrë të specifikuar kjo vlen edhe për sistemin e auditimit.

Në mënyrë të përgjithshme, çdo sistem kontrolli ka katër funksione: matjet, kontrollin, llogaritjen dhe korrigjimin që janë të ngjashme me ato që kryen auditimi për çdo aktivitet, projekt apo sistem. Në teorinë e kontrollit përdoren

metoda te ndryshme kontrolli kryesisht për sisteme inxhinierike siç janë kontrollet optimale, kontrollet robust, kontrollet inteligjente, rrjetat Bayes, neural (rrjetat nervore) fuzzy, e evolucionit, etj.

Në vendin tonë auditimi nuk ka shumë përvojë dhe realizohet me aktivitete apo projekte relativisht jo të komplikuar, por duke pasur parasysh kërkesat gjithnjë në rritje të Kontrollit të Shtetit në të ardhmen do të kërkohej një rritje cilësore e metodave dhe modeleve të auditimit (kryesisht matematike), për rrjedhim teoria e sistemeve dhe ajo e kontrollit do të ketë një fushë veprimi gjithnjë në rritje. Për këtë duhet menduar mirë veçanërisht në kushtet e anëtarësimit të vendit në strukturat e BE dhe të një zhvillimi prespektiv shkencor të tij, sepse auditimi = efektivitet + antikorrupsion.

Dita e punës dhe e projektit

<i>Pa mundim</i>	<i>No pain</i>
<i>S'ka fitim</i>	<i>No gain</i>

Çdo individ, njësi familjare apo shoqërore, organizatë, komunitet, etj., kontribon (me punë) në zhvillimin e vendit. Masë e këtij kontributi janë vlerat e projektit individual dhe komunitar, kudo që ai kryhet, në familje e shoqëri. Çdokush me realizimin e projektit bën një analizë të rezultateve dhe mangësive për hartimin e projekteve të rinj (zhvillimor). Askush nuk mund të hedhë një hap përpara, pa bërë analizën e vlerësimit të hapit paraardhës, d.m.th të procesit që e karakterizon atë.

Projekti si alternativa më e mirë e një strategjie ka shumë elemente material e shpirtëror, psikologjik e arsimor,

teknologjik e mjedisor, demokratik dhe përparimtar, analitik dhe financiar, fitimprurës e evolucionar, frymëzues e mbarë kombëtar. Projekti është kusht i ekzistencës dhe zhvillimit të shoqërisë, është frymëzuesi shpirtëror dhe material për arritje të reja në jetë, për ngritjen dhe rritjen e nivelit të saj.

Realizimi i çdo projekti është një ditë e rëndësishme për çdo individ, komunitet, etj është një ditë e madhërishme që hera herës merr edhe përmasat e një kujtese të paharrueshme e të pa përsëritshme në jetën e secilit prej nesh. E meqë është kështu, a nuk duhet ta kujtojmë këtë veprimtari në një ditë të vitit, në ditën e punës e të projektit, ku secili nga ne: individ apo institucion ti tregojë shoqërisë mundin, frutin dhe fitimin njëvjeçar të punës së tij dhe çfarë duhet të bëjë më tej në emër të tij, për shoqërinë, për Shqipërinë.

Literatura:

Strategic plan 2011 -2016. International Organisations of Supreme Audit Institutions, INTOSAI, 2010.
Performance audit guidelines ISSAI 3000-3100. Udhëzuesi i Auditimit të performancës, KLSH 2012.
Internal audit report of project practice management.Nr. IAIG/2101, 2012.
Project audit methodology.Esf. Czech. Standards Institute 2005.
Guidelines for project and programe evaluations, Find draft Austrian Development Agency, Austria 2009.
Standarts for auditing projects. DIIR, 2008 Germany.
A. Yeong, Definitions of project, 2011.
B. Leskaj, Mirëqeverisja, paradigma e re në administrimin publik. Revista "Auditimi Publik", nr.5, 2013.

Gj. Preçi, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe mirëqeverisja. Gazeta Metropol, Tiranë 2013.

Gj. Preçi, Roli i KLSH në rritjen e efektivitetit të projekteve me financime të huaja, Gazeta Tirana Observer, 2013.

Grup autorësh, Shteti i të drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, 2011.

S. Osmani, Menaxhimi në inxhinieri, Tiranë 1998.

S. Osmani, Metodatat matematike në menaxhim, Tiranë 2006.

S. Osmani, Projekte dhe programe në C++, Tiranë 2007.

S. Osmani, Imazhe dhe vizione për menaxhimin dhe projektizimin. Revista "Auditimi Publik", nr.5, 2013.

A. Tamas, System theory in community development, 2000 CANADA.

A. Joldas etc, Pillars of the audit activity, materiality and audit risk, Annals of the University of Petrosan, 2010 ROMANIA.

Mirënjohje

Falënderojmë zj. Albana Agolli, zj. Irena Islami, z. Bajram Lame dhe z. Fatos Çoçoli për ndihmesën dhënë me idetë, mendimet dhe sugjerimet e tyre me vlerë.

Prof. Dr. Skënder Osmani,
Fakulteti Gjeologji-Miniera dhe
Gjovallin Preçi, KLSH

SI TË PËRZGJEDHIM TREGUESIT PËR MATJEN E ZHVILLIMIT RAJONAL?

Politikat e zhvillimit rajonal dhe kohezionit janë duke marrë gjithnjë e më shumë rëndësi në botën e globalizuar, ku struktura e ekonomive po ndryshon dhe globalizimi i produkteve është kaq shumë i pranishëm

**Nga: Prof. Dr. Ilia Kristo
Adela Llatja, PhD**

Abstrakt

Roli i rajoneve në ekonomitë kombëtare ka ndryshuar dukshëm në kohët e fundit, si rezultat i globalizimit dhe përshtatjes strukturore. Kuptimi i kapaciteteve të një rajoni është vendimtar në planifikimin për zhvillimin rajonal.

Politikat e zhvillimit rajonal dhe kohezionit janë duke marrë gjithnjë e më shumë rëndësi në botën e globalizuar, ku struktura e ekonomive po ndryshon dhe globalizimi i produkteve është kaq shumë i pranishëm. Ekonomitë dhe rajonet janë duke u bërë gjithnjë e më shumë të orientuara në specializim duke vënë të gjitha përpjekjet në sektorin e ekonomisë. Është me rëndësi për të matur dhe pastaj krahasuar zhvillimin rajonal.

Në këtë studim, ne do të japim një pasqyrë mbi llojet e treguesve dhe mbi

mënyrën e përzgjedhjes së treguesve më të mirë, për qëllimet që ata janë përdorur, të fokusuar në treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm.

Fjale kyçe: Ekonomi rajonale, zhvillim rajonal, tregues të zhvillimit të qëndrueshëm, matricë e treguesve zhvillimorë, përzgjedhja e treguesve, kapacitetet rajonale.

Hyrje

Për të matur zhvillimin rajonal është e domosdoshme të përcaktohen treguesit për matjen e tij. Zgjedhja e treguesve të cilët duhen monitoruar është një proces kompleks dhe i vështirë. Përpara se të zgjidhen treguesit duhet të përcaktohet qëllimi përse do të shërbejnë këta tregues dhe politikave të cilave do t'u shërbejnë. Organizata dhe institucione të ndryshme përdorin metoda të ndryshme për mbledhjen e treguesve, si dhe i klasifikojnë ndryshe treguesit për matje.

Matja e nivelit të zhvillimit të qëndrueshëm

Një tregues i zhvillimit të qëndrueshëm mund të kuptohet shpesh herë si të dhëna sasiore që analizojnë ndryshimin, duke matur dhe komunikuar ndryshime dhe progres të përdorimit të qëndrueshëm të faktorëve ekonomik, social, institucional dhe mjedisor. Një tregues jep një status apo situatë, dhe qëllimi bazë është të na tregojë se sa mirë sistemi po funksionon për arritjen e qëllimit të caktuar (Nordregion , 2004).

Treguesit përkufizohen si një matës i cili kap informacion të rëndësishëm dhe jep një informacion, i cili mund të përdoret për vendimmarrje (OECD, 2009). Treguesit sipas OECD ndahen në katër kategori:

- Burime- Inpute masin çfarë burimesh (p.sh. njerëz, para, kohë..), dhe në çfarë sasive janë përdorur për të prodhuar të mira dhe shërbime.
- Proceset masin mënyrën në të cilën aktiviteti kryhet nga një program apo projekt me burimet e dhëna.
- Përfundimi -Outpute masin të mirat dhe shërbimet që prodhohen nga aktivitetet (p.sh. nr i SME-ve të cilave u është shërbyer, kilometra rrugë të ndërtuara).
- Rezultatet - Outkame masin dimensionin i cili pritët të ndryshojë si rezultat i një ndërhyrje (politikat, programet, apo projektet) si dhe përfundimet e prodhuara.

Për treguesit duhet të bëhen dy dallime thelbësore, së pari duhet të dallojmë treguesit të cilët ndikohen nga faktorë ekzogjenë (të jashtëm) të zhvillimit rajonal si dhe tregues të cilët janë më të lidhur me zhvillimin rajonal. Një dallim

tjetër duhet të bëhet midis treguesve që tregojnë vlerë neto dhe vlerë bruto. Ky dallim ka vlerë sidomos për treguesit e rezultateve. Për shembull, për një politikë e cila synon të rritet niveli i punëzënies, kjo mund të arrihet në mënyrë direkte ose indirekte. Punëzënie bruto do të ishte ndryshimi në numrin total të të punësuarve para dhe pas zbatimit të politikës nxitëse, punëzënie neto do të ishte së çfarë do të kishte ndodhur po të mos ishin marrë masat e dhëna. Treguesit neto janë matës më të mirë për impaktin, por dhe më të vështirë për tu përllogaritur. Treguesit bruto janë matës më të mirë për rezultatet.

Përkufizimit e burimeve, proceseve, rezultateve dhe përfundimeve do të ndryshojnë nga një organizatë në tjetrën, në varësi të rolit dhe objektivave të tyre, por thelbi mbetet i njëjtë.

Bashkimi Evropian (European Commission , 2013) i referohet “outcomes (rezultateve)” si “rezultat” dhe “impakt”, gjatë monitorimit dhe vlerësimit të fondeve të kohezionit dhe atyre strukturore. Pjesë e rëndësishme e programeve të fondeve strukturore është vendosja e objektivave dhe shpërndarja e fondeve. Për të shpërndarë fondet në mënyrën më të mirë të mundshme duhet të përcaktohen saktë treguesit. Për qëllimet e saj BE-ja i klasifikon treguesit si më poshtë:

Rezultatet e pritshme: janë motivi i një ndërhyrje, nga e cila përfitojnë individët dhe shoqëria, pra ajo që duhet të ndryshojë me ndërhyrjen e dhënë. Një shembull është dhe shkurtimi i distancave, për të cilën ndërtohen

rrugë, hekurudha, linja ajrore etj. Pasi është zgjedhur rezultati i pritshëm duhet të identifikohen masat e duhura për matjen e saj. Kjo mund të bëhet me identifikimin e një ose më shumë treguesve të rezultatit. Për shembull, për rastin tonë, mund të jetë koha e udhëtimit, emetimi i Dioksidit të Karbonit, evitimi i trafikut etj. Politikat mund të fokusohen në reduktimin e njëres prej tyre.

Treguesit e rezultateve, janë variabla që japin informacion mbi disa aspekte specifike të rezultateve. Përzgjedhja e treguesve të qartë ndihmon në të kuptuarit e problemit dhe hapësirave për zhvillimin e politikave, të cilat më pas do të ndihmojnë në përcaktimin nëse janë arritur ose jo objektivat.

Përfundimet (Outputet)- ky tregues i referohet aktiviteteve. Ato maten në njësi fizike ose monetare (p.sh. gjatësi rrugë, numër punonjësish etj).

Për matjen e nivelit të zhvillimit rajonal në Angli janë përdorur katër modele të matjes së zhvillimit të qëndrueshëm (OECD, 2009). Të gjithë sistemet masin 12 tregues kryesorë: performacën ekonomike të rajonit, zhvillimin e qëndrueshëm, produktivitetin, punëzënia, sipërmarrja, tregtia ndërkombëtare, cilësia e lagjeve të banimit, shkenca dhe inovacioni, aftësitë, komunitet i qëndrueshëm, ferma të qëndrueshme dhe ushqim, vullnetarizmi dhe angazhimi i komunitetit. Të tjerë shtete dhe organizata përdorin sisteme të tjera matjeje dhe tregues të tjerë.

Përzgjedhja e treguesve

Treguesit për zhvillimin rajonal duhet të jenë në funksion të politikave për

zhvillim si dhe objektivave për të cilat mbliidhen. Objektivat për të cilat mbliidhen treguesit janë të shumta si: alokim fondesh, transparencë, kontroll i burimeve, efektivitet etj. Sistemet të cilat synojnë monitorimin e flukseve financiare do të monitorojnë treguesit e burimeve, duke parë burimet e përfshira. Sistemet e monitorimit të cilat synojnë të monitorojnë si “janë bërë gjërat” mund të fokusohen në procese, treguesit në nivel rezultati dhe përfundimi do të mbeten për vendimmarrësit dhe politik bërësit. Një sistem monitorimi mund të ketë shumë qëllime ndaj dhe mund të merren në konsideratë disa nivele treguesish.

Treguesit e zhvillimit rajonal përdoren ndryshe nga qeveri të ndryshme (OECD, 2009), kjo varet dhe nga objektivat që ato kanë për zhvillim, p.sh. në Mbretërinë e Bashkuar, politikat rajonale kontribuojnë në një nivel të lartë dhe të qëndrueshëm të rritjes dhe punëzënia në nivel kombëtar, në mënyrë që çdo rajon të arrijë maksimumin e zhvillimit.

Në Poloni, politikat rajonale synojnë të zhvillojnë polet dhe janë të fokusuara në promovimin dhe zhvillimin e rajoneve të mëdha.

Politikat rajonale në Portugali synojnë në integrimin e politikave të reformave strukturore, ndërkohë që shfrytëzojnë asetet endogjene të rajoneve. Për BE-në objektivat e zhvillimit rajonal janë kohezioni, konkurrueshmëria dhe punëzënia, dhe bashkëpunimi rajonal.

Nuk ka një numër të saktë treguesish për të arritur në sistemin më të mirë të matjes së nivelit të zhvillimit. E rëndësishme është që sistemi i matjes të jap informacion të nevojshëm për

politikbërësit. Në shumë raste treguesit dizajnohen nga qeveria qendrore, e cila ka informacione të limituara mbi rajonet dhe politikat e zhvillimit të tyre, si rrjedhim treguesit rezultojnë të jenë jo gjithëpërfshirës. Nga ana tjetër aktorët rajonal mund të mos kenë kapacitetet për mbledhjen e informacioneve për tregues sa më të saktë. Një tjetër problem është dhe fakti se treguesit mund të mos lexohen saktë dhe të mos përdoren për përmirësimin e politikave.

Sipas (OECD, 2009) disa faktorë të cilët ndikojnë në zhvillimin e treguesve janë: Karakteristikat e zhvillimit rajonal - zhvillimi rajonal është kompleks dhe përfshin treguesit e zhvillimit rajonal, të cilët mund të karakterizohen nga: karakteristika ndërsektoriale, sa më shumë sektorë të përfshihen, aq më e vështirë është mbledhja e informacionit.

Shumë aktorë, sa më shumë aktorë të përfshihen në mbledhjen e të dhënave, aq më kompleks bëhet procesi, ndaj kërkohet një koordinim i mirë i aktorëve.

Sipas teorive të reja të zhvillimit rajonal, çdo rajon duhet të ketë treguesit e tij për matjen e zhvillimit, nga ana tjetër duhet të ngrihet një sistem treguesish për matjen e nivelit të zhvillimit rajonal dhe krahasimin midis rajoneve. Kompleksiteti i tregueseve, e bën të vështirë gjetjen e një treguesi i cili të masë zhvillimin rajonal, kjo dhe nga kompleksiteti i të dhënave.

Aftësitë e aktorëve- shpesh aktorët e përfshirë në matjen e zhvillimit rajonal nuk kanë kapacitete të mjaftueshme

teknike apo njerëzore, për matjen e nivelit të zhvillimit.

Disponibiliteti i të dhënave - Shpesh në nivel rajonal mungojnë të dhënat dhe statistika, ose ato janë të pakrahasueshme, si në rastin tonë ku të dhënat zyrtare sipas INSTAT, të cilat duhet të përdoren për matjen e indikatorit, janë të viteve të ndryshme sipas rajoneve të ndryshme, nuk janë konsistente dhe me shumë mangësi.

Kostoja- Shpesh mbledhja e të dhënave është e kushtueshme, si dhe procesimi i tyre gjithashtu.

Përcaktimi i raportit mes kostove dhe përfitimeve, si dhe çfarë është disponibël do të përcaktojë përzgjedhjen e treguesve.

Iniciativa e Kombeve të bashkuara për të zbatuar politikat e zhvillimit të qëndrueshëm u konkretizua me Axhendën 21, bazuar në Konferencën për Zhvillim dhe Mjedis të Kombeve të Bashkuara në 1992, ku ju bë thirrje të gjithë institucioneve shtetërore dhe jo që të zhvillojnë treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm (United Nations). Këta tregues në të shumtën e rasteve janë treguesit të cilët do të masin zbatimin e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të vendeve që e aplikojnë.

Ndër vite janë zhvilluar takime dhe tryeza të përbashkëta, janë përcaktuar disa tregues për matjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Organizata e kombeve të bashkuara ka zhvilluar treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm, të cilët masin zbatimin e politikës për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve anëtare.(United Nations, 2006). Në kuadër të OKB-së po

zhvillohen treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm, nga qeveritë e vendeve anëtare, nga organizatat ndërkombëtare (United Nations).

Treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm sipas OKB janë të grupuar jo më në katër shtyllat bazë të zhvillimit të qëndrueshëm (ekonomik, social, mjedisor dhe institucional). Këto ndryshime tregojnë karakterin shumë dimensional të zhvillimit të qëndrueshëm. Fushat ku fokusohen treguesit janë: (1) Varfëria; (2) Qeverisja; (3) Shëndetësi; (4) Edukimi; (5) Demografia; (6) rreziqe natyrore; (7) atmosfera; (8) toka; (9) deti dhe vija bregdetare; (10) uji i pastër; (11) biodiversiteti; (12) zhvillimi ekonomik; (13) partnerët ekonomik global; (14) modelet e konsumit dhe prodhimit (United Nations, 2007).

Këshilli Evropian, ka identifikuar dhjetë fusha prioritare për zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo reflektohet dhe në treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm (1) zhvillimi ekonomik; (2) varfëria dhe përfshirja sociale; (3) mosha e popullsisë; (4) shëndeti publik; (5) ndryshimi klimaterik (6) modelet e konsumit dhe prodhimit; (7) Menaxhimi i burimeve natyrore; (8) transporti; (9) qeverisja e mirë; dhe (10) partneriteti global (European Commission , 2011). Treguesit e përdorur nga OKB për matjen e zhvillimit të qëndrueshëm janë tregues të cilët kanë ndërlidhje me

njëri tjetrit. Pra një tregues i ndodhur në një grupim mund të tregojë dhe për një fushe tjetër, siç mund të jenë aksesit në kanalizime tregon varfëri por dhe shëndetësi, akses në ujë të pijshëm, është tregues social dhe ekonomik. Ndaj këto grupime nuk duhen parë si të shkëputura.

Që treguesit e përzgjedhur të jenë domethënës duhet të jenë ose në seri kohore, ose të përdoren për bazë krahasimi ndërmjet rajoneve, duke identifikuar rajonin më të mirë dhe më pak të mirë. Figura 1 Matrica e adaptimit të treguesve të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Por a duhen marrë këto tregues të mirëqenë dhe duhet ti jepen zyrave të statistikave për ti grumbulluar? Vendet duhet të përcaktojnë treguesit e matjes së zhvillimit në funksion të karakteristikave të vendit, disponibilitetit e të dhënave, domethënies së të dhënave për një vend (OECD, 2009) (United Nations, 2007)(p.sh. popullsia që banon në zona bregdetare, nuk ka domethënie në zonat malore).

Përzgjedhja e treguesve do të varet nga disa faktorë. Faktorët për adaptimin e Indikatorëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komitetit të Zhvillimit të Qëndrueshëm paraqiten në figurën e më poshtme.

Figura 1 Matrica e adaptimit të treguesve të Zhvillimit të Qëndrueshëm

	I rëndësishëm	Tregues të ndërruarur të rëndësishëm	Irëndësishëm, por mungon	I parëndësishëm
Disponibël	Black	Dark Gray	Medium Gray	Light Gray
Mundësi për tu bërë disponibël	Black	Dark Gray	Medium Gray	Light Gray
Të dhëna të lidhura disponibël	Dark Gray	Dark Gray	Medium Gray	Light Gray
Të pa disponueshëm	Light Gray	Light Gray	Light Gray	Light Gray

Black	Për tu përdorur	Medium Gray	Për tu identifikuar
Dark Gray	Për tu modifikuar	Light Gray	Për tu hequr

Burimi, (United Nations, 2007)

Pra siç shihet nga figura e më sipërme, një tregues duhet të jetë i rëndësishëm, dhe disponibël, në mënyrë që të përzgjidhet në listën e treguesve.

Treguesit në vetvete na tregojnë pak ose aspak në lidhje me nivelin e zhvillimit rajonal dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sidomos kur treguesit diktohen nga një institucion i shkëputur nga specifikat e rajonit (Zeijl & Martens, 2010). Nga ana tjetër treguesit në vlerë absolute na tregojnë thuajse asgjë për nivelin e përgjithshëm të zhvillimit. Ka shumë lista treguesish, por shumë pak prej tyre mund të aplikohen në Shqipëri. Detyra jonë mbetet të identifikojmë treguesit më të

përshtatshëm për nivelin e zhvillimit në Shqipëri dhe specifikat e rajoneve tona. Shumë organizata ndërkombëtare kanë zhvilluar lista të treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat i shërbejnë specifikave të tyre. P.sh BE ka treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm të cilët masin nivelin e zbatimit të strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm nga vendet anëtare. Indikatorët e zhvilluar nga UNCSD synojnë të monitorojnë aplikimin e Axsendës 21, dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (United Nations, 2007). Pra treguesit në të shumtën e rasteve shërbejnë për të monitoruar një strategji apo politikë të caktuar, dhe nuk mund të transferohen lehtësisht nga një vend në tjetrit. Në Shqipëri ekzistojnë strategjitë e

zhvillimit të qëndrueshëm në nivele qarkesh. Në nivel kombëtar strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm nuk është e përditësuar dhe nuk është e plotësuar me kuadër ligjor e nën ligjor.

Përfundime dhe Rekomandime

Shumë organizata ndërkombëtare kanë zhvilluar lista të tregueseve të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat u shërbejnë specifikave të tyre. Ndaj nuk ka një listë të paracaktuar për matjen e zhvillimit. Çdo tregues duhet të mblihet për ti shërbyer një funksioni të caktuar.

Treguesit në vetvete na tregojnë pak ose aspak në lidhje me nivelin e zhvillimit rajonal dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sidomos kur treguesit diktohen nga një institucion i shkëputur nga specifikat e rajonit.

Treguesit e matjes së nivelit të zhvillimit rajonal duhet të dizajnohen me mbështetjen dhe bashkëpunim me pushtetin lokal.

Vendet duhet të përcaktojnë treguesit e matjes së zhvillimit në funksion të karakteristikave të vendit, disponibilitetit të të dhënave dhe domethënies së të dhënave për një vend.

Literatura e konsultuar

European Commission (2011). Sustainable development in the European Union. Eurostat.

European Commission (2013). Guidance Document On Monitoring and Evaluation - European Regional Development Fund and Cohesion Fund. Directorate General Regional and Urban Policy. European Commission.

Nordregion. (2004). Indicators for Sustainable Development. (Nordic Center for Spatial Development).

OECD. (2009). Governing Regional Development Policy - The use of Performance Indicators.

United Nations. (n.d.). RIO+20 United Nations Conference for Sustainable Development. Retrieved 10 10, 2012, from RIO +20 : <http://www.uncsd2012.org/>

United Nations. (n.d.). United Nations. Retrieved from <http://www.un.org/earthwatch/about/docs/a21ch40.htm#A.%20Bridging%20the%20data%20gap>

United Nations. (2006). Global Trends and Status of Indicators of Sustainable Development. Department for Economic and social affairs.

United Nations. (2007). Indicators of Sustainable Development: Guidelines and Methodologies (Vol. 3rd). New York : United Nations.

Zeijl, A. v., & Martens, R. &. (2010). An adaptive indicator framework for monitoring regional sustainable development: a case study of the INSURE project in Limburg, The Netherlands. Sustainability: Science, Practice, & Policy.

Prof. Dr. Ilia Kristo

Universiteti i Tiranës,
Fakulteti i Ekonomisë
iliakristo@feut.edu.al

Adela Llatja, PhD

Universiteti i Tiranës,
Fakulteti i Ekonomisë
adelallatja@feut.edu.al

ZONAT E MBROJTURA NË SHQIPËRI, ZONA “TË PAMBROJTURA”

Zonat e Mbrojtura kanë vlera natyrore, kulturore, historike, arkeologjike të trashëgimisë rajonale e ndërkombëtare, të cilave u jepet një status i veçantë për mbrojtjen e tyre

Prof.Asc. Sazan GURI

HYRJE

Zonat e Mbrojtura janë sipërfaqe me vlera të veçanta të peizazhit, formacione të rralla biologjike, gjeomorfologjike dhe pasuri të biodiversitetit. Ato kanë vlera natyrore, kulturore, historike, arkeologjike të trashëgimisë rajonale e ndërkombëtare, të cilave u jepet një status i veçantë për mbrojtjen e tyre. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të sistemin ndërkombëtar dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me të.

1. PROCESI I MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA

Menaxhimi i zonave të mbrojtura është proces operacional që fillon me shqyrtimin e situatës dhe vazhdon me analizën e pesë funksioneve të tij, që janë: planifikimi, organizimi, drejtimi, rekrutimi dhe kontrolli. Koncepti i menaxhimit të ZM duhet të shtjellojë

ide dhe të hapë perspektivën e zhvillimit të qendrueshëm. Kjo do të thotë koncepto imagjinatën, përgjithëso përvijën e vendeve të zhvilluara dhe koncepto skicë idenë e ZM. Nga ana tjetër, menaxhimi i ZM është mbrojtje, edukim dhe eksperiencë.



Zonat e Mbrojtura janë sipërfaqe me vlera të veçanta të peizazhit, formacione të rralla biologjike, gjeomorfologjike dhe pasuri të biodiversitetit. Ato kanë vlera natyrore, kulturore, historike, arkeologjike të trashëgimisë rajonale e ndërkombëtare

të cilave iu jepet një status i veçantë për mbrojtjen e tyre. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të sistemin ndërkombëtar dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me të. Sipas IUCN (The International Union for Conservation of Nature), Zonat e Mbrojtura mund të përfshihen në një nga kategoritë e mëposhtme:

rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor/ (Kategoria I);
park kombëtar (Kategoria II);
monument natyror (Kategoria III);
rezervat natyror i menaxhuar/zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).
Si rregull, përreth çdo Zone të Mbrojtur është shpallur edhe zona përkatëse buferike. Pra, për çdo kategori të zonave të mbrojtura zbatohet një shkallë e caktuar mbrojtjeje.

2.KATEGORITË E ZONAVE TË MBROJTURA

2.1 REZERVË STRIKTE NATYRORE (KATEGORIA-I)

Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë "strikte" natyrore. Në rezervën 'strikte' natyrore zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara:
-prerja e drurëve dhe e shkurreve;
-përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike;

-ndërtime të çdo lloji;
-nxjerrja e mineraleve dhe e torfave;
-gjuetia dhe peshkimi;
-ndezja e zjarreve;
-kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës;
-lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve;
-vojitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi;
-riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.

Zonë buferike e rezervatit 'strikt'



Laguna e Karavastasë

natyror mund të shpallet territori rreth rezervatit, me gjerësi rreth 100m nga kufiri i tij. Veprimtaritë e tjera, që kërkohen të ushtrohen në rezervat ose në zonën e tij buferike, duhet të pajisen me leje mjedisi. Si rezervat strikt natyror janë shpallur:

Laguna e Karavastasë p.sh., zona e parë e përfshire në listën e Konventës së RAMSAR-it. Ajo, ligjërisht është e mbrojtur, ndërsa praktikisht, ajo është në fatin e banoreve të Divjakës. Të gjitha ujërat e zeza të fshatrave përreth derdhen në këtë lagunë. Gjendet gjithmonë nën ndikimin e peshkimit të banoreve, të cilët e përdorin këtë si mënyrë tregtimi. Gjithashtu edhe

gjuetia është një aktivitet mjaft i përhapur në këtë zonë.

2.2 PARK KOMBËTAR (KATEGORIA-II)

Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.

Në parkun kombëtar zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, ku janë të ndaluara: shfrytëzimi i tokës me teknologji intensive;

neutralizimi i mbetjeve me origjinë jashtë territorit të parkut kombëtar; shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jo vendase, kur ato sjellin ndryshime në biodiversitetin e zonës;

riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut, me përjashtim të riprodhimeve shpëtuese;

ndërtimi i rrugëve, autostradave, hekurudhave, zonave urbane, linjave të tensionit të lartë dhe sistemeve të naftës dhe gazit me shtrirje të gjatë; veprimtari masive sportive, turistike, jashtë pikave të caktuara; organizimi i garave me automjete e motoçikleta.

Në këtë zonë mund të ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, veprimtaritë që synojnë:

ndryshimin e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura; ngritjen dhe funksionimin e objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje.

Kur administrata e ruajtjes së parkut vëren se cenohet qëllimi për të cilin ky park është shpallur park kombëtar, mund të kufizojë ose të ndalojë

përkohësisht lëvizjen e mjeteve të transportit, gjuetinë e peshkimit dhe veprimtari të tjera të lejuara. Zona buferike e parkut kombëtar mund të shpallet territori rreth parkut, me gjerësi rreth 50m nga kufiri i tij. Parqe Kombëtare në Shqipëri mund të përmendim:

Mali i Dajtit, Thethi, Lura, Llogara, Mali i Tomorit, Lugina e Valbonës, Butrinti.

Që të gjitha këto parqe vuajnë pasojat e guroreve, të cilat ndodhen jo rrallë brenda zonave tampon ose buferike. Pothuajse në të gjitha rastet, ato ndikojnë dhunshëm mbi jetën ekologjike të popullatave brenda zonave të mbrojtura. Lura, Dajti, Tomorri, etj., janë kthyer nga një mrekulli e natyrës në një vend të shkretë dhe kjo nga aktivitetet dhe presionet njerëzore pranë si edhe mbi-prerja e pyjeve.



Bredhi i Sotirës

2.3. MONUMENTET NATYROR (KATEGORIA III)

Në një monument natyror zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Si monumente natyrore mund të shpallen

shpellat. Ato mund të vizitohen, të përdoren për qëllime turistike ose mjekësore vetëm pasi të jenë përshtatur për këto veprimtari me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e agjencive rajonale të mjedisit dhe të strukturave përkatëse të turizmit dhe pushtetit vendor. Eksplorimi, hyrjet e autorizuar dhe çdo përdorim i shpellave, duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe pastërtinë e tyre, ruajtjen e mikroklimës, të regjimit ujor, të ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave. Për shpellat, kanionet e ujëvarat, zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes. Shpellat, kanionet dhe ujëvarat natyrore nuk rrethohen me zonë buferike. Monumentet e natyrës radhiten në vlerat e trashëgimisë kombëtare. Në to janë të ndaluara:

Tjetërsimi i vlerave për çfarëdo qëllimi të shfrytëzimit ekonomik; Punime apo veprimtari që ndryshojnë karakterin e monumentit apo rrjedhën natyrore të tij. Për pjesën më të madhe të monumenteve të natyrës, si ato gjeomonumente, biomonumente apo hidromonumente nuk zbatohet asnjë prej shkallëve të sigurisë së mbrojtjes, si rrethimi, shkalla buferike, kujdesi, mirëmbajtja, përkundrazi shumë prej tyre janë të lëna në harresë. Për pjesën më të madhe të monumenteve të natyrës, si ato gjeomonumente, biomonumente apo hidromonumente nuk zbatohet asnjë prej shkallëve të sigurisë së mbrojtjes, si rrethimi, shkalla buferike, kujdesi, mirëmbajtja, përkundrazi shumë prej tyre janë të lëna në harresë.



Mali i Tomorrit

2.4. REZERVAT NATYROR I MENAXHUAR (KATEGORIA-IV)

Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura, ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve). Në zonën e menaxhimit të habitateve dhe llojeve zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, ku ndalohen: ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura; depozitimi i kimikateve; lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim; mbledhja e bimëve, mineraleve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve; ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje.



Mali i Dajt-it (gurorë)

Në rezervat natyror të menaxhuar mund të përmendim:

Kune Vain

Rrushkulli

Pishë Poro

Karaburuni



Pamje nga Laguna Kune Vain

Zonë buferike e zonës së menaxhimit të habitateve dhe llojeve mund të shpallet territori rreth saj, me gjerësi 50m nga kufiri i zonës. Por këto zona të mbrojtura vuajnë presionin industrial pranë, sidomos shkarkimet e tyre në lagunat e mësipërme (rasti Shëngjin). Ndërtimet urbane jo vetëm që nuk respektojnë zonën tampon të tyre, por shpesh janë në brendësi të këtyre zonave të mbrojtura (rasti Volorek)

2.5. PEIZAZHI I MBROJTUR (KATEGORIA-V)

Territoret më të mëdha se 1000ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur. Në një peizazh të mbrojtur zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, ku ndalohen: mbjellja e pyjeve monokulturë;

neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara;
shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jo vendase;
gjuetia me ushqime të helmuara;
ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane.

Mali me gropa

Mali me gropa përben një nga formacionet më të mrekullueshme që ka krijuar nëna natyrë në Shqipëri, por që fatkeqësisht nuk ruhet, ose më sakt, në letra ajo është zonë e mbrojtur, por në realitet, ajo shpërdorohet nga banorët e zonës me mbikullotjen e bagëtive në këtë zonë. Liqeni i Pogradecit përbën një nga vatrat më të rëndësishme.



*Liqeni i Pogradecit
(vend depozitimi i plehrave)*

2.6. ZONË E MBROJTUR E BURIMEVE TË MENAXHUARA (KATEGORIAVI)

Zonat që përfshijnë territore të gjëra, e relativisht të izoluar dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara. Hyrja e kufizuar në to nënkupton që

këto zona, normalisht, do të kërkojnë kontroll, i cili do të varet nga presionet për të hyrë dhe përdorur zonën. Kjo kategori mund të përdoret dhe për ato zona që janë të mbrojtura me legjislacion, por që nuk janë përdorur për ndonjë arsye. Në një zonë të mbrojtur të burimeve të menaxhuara zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

Bjeshka e Oroshit me formacione gjeologjike mjaft interesante (shpella e puse karstike) me vlera shkencore e njohëse. Ka një bukuri natyrore mbresëlënëse, por që për fat të keq nuk ruhet dhe as nuk mirëmbahet nga pushtetarët vendas.

Zonat e mbrojtura në Shqipëri janë të shumta, por ajo që është për të ardhur keq është fakti që këto zona nuk mbrohen. Në grykat e Lagunës së Karavastasë gjenden rrjeta, ndërkohë që ai është vend depozitimi i vezëve të mjaft organizmave shtazore. Duke qenë se këto rrjeta janë vendosur aty për të peshkuar, ato jo vetëm marrin peshq, por edhe mjaft larva të këtyre organizmave shtazore, kjo çon në atë që ne e quajmë "varfëri biodiversiteti".

3. KONSTATIME DHE NEVOJA PËR PËRMIRËSIM

Në Zonat e Mbrojtura mungojnë ato më kryesoret, që një Zonë e Mbrojtur duhet të ketë:

tabela treguese për pozicionin e saktë të vendndodhjes së Zonës së mbrojtur; tabela orientuese për turistët, në mënyrë që të marrin pamjet më të bukura të vendit tonë;

gardhimi i Zonave të Mbrojtura, i cili jo vetëm që shërben si tregues i sipërfaqes së ZM, por edhe si një

mbrojtje nga ndërhyrjet e banorëve përreth, etj.

Në këto zona:

jo vetëm që peshkohet, por mbi peshkohet, jo vetëm që praktikohet sporti i gjahut në periudha të caktuara dhe të lejuara, por gjuetarët gjuajnë në çdo periudhë të vitit, duke vlarë në këtë mënyrë edhe shpendë e shpezë, të cilët kryejnë rolin e paralajmëruesit apo si sinjalizues për shpendët e tjerë që do të vijnë.

Nga ana tjetër, pyjet e zonave të mbrojtura në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë:

pasojat e mbi-prerjes, sepse edhe ato pak pyje që janë kanë një lartësi prej 2-3m të lartë dhe kjo falë proceseve natyrore të rigjenerimit të pyjeve të prera.

mos zëvendësimin e drurëve pyjorë, që janë prerë këto vitet e fundit.

Vendi ynë është në gjendjen më të pafavorshme të tij, si asnjëherë tjetër më parë, ku po t'iu referohemi shifrave në vitin 1943, në Shqipëri, ne kemi pasur një sipërfaqe pyjore që zinte 83% të territorit, ndërsa në vitet '80, kjo sipërfaqe pyjore shkoi në shifrat 34%, ndërsa në ditët e sotme këto shifra në praktikë kanë zbritur në 7-8%. Praktikisht, ne mund të kemi edhe më pak se kaq sipërfaqe pyjore. Nëse iu referohemi shifrave për vendet e tjera, ato na alarmojnë më shumë, po të krahasohemi. P.sh. Austria ka 37 parqe natyrore me një sipërfaqe 305.000 ha, Greqia ka 5 kategori zonash të mbrojtura: Park kombëtar (që janë 10 dhe që mbulojnë një sipërfaqe prej 68,732 ha), pyje estetike, monumente natyrore të mbrojtura, rezervate gjahu,

parqe detare. Italia ka 21 Parqe Kombëtare, që mbulojnë 1.5 milion ha ose rreth 5% të territorit. Mali i Zi ka vetëm 4 parqe kombëtare, por ka një sistem ruajtjeje dhe menaxhimi të rëndësishëm, i cili mbron të gjithë territorin e vendit dhe jo vetëm zonat e mbrojtura. Maqedonia ka një sipërfaqe prej 187,895ha ose 7.2% të të gjithë territorit të vendit.

Nëse ju referohemi vendeve të zhvilluara, standardet e tyre kanë bërë, jo vetëm një arritje në industri e teknologji, por edhe në një harmonizim me natyrën. Britania e madhe ka 12% të territorit të saj zona të mbrojtura. Gjermania ka parqe kombëtare, të cilat janë zona të egra, të cilat janë riaftësuar nga ndërhyrjet e organizatave përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës. Por, ajo çka na dallon ne nga shtetet e tjera nuk janë vetëm shifrat, por edhe mentaliteti për mbrojtjen e natyrës, si p.sh., në vendet e tjera, nëse ti hedh mbeturina në një zonë të mbrojtur (madje edhe në rrugë), ty të vendosin gjobë, ndërsa në vendin tonë, jo vetëm në rrugë hedhin mbeturina, por edhe në zona të mbrojtura, sepse mbi to nuk zbatohet ligji. Ai i hedh, sepse nuk e sheh njeri (pra, nuk ka policë ruajtës të zonës së mbrojtur), por edhe sepse në këto zona mungojnë koshat për mbeturina ose ata që janë - janë jashtë standardit.

Nëse do t'i referohemi ecursionit të Zonave të Mbrojtura të vendit tonë, shifrat kanë ardhur duke e zvogëluar sipërfaqen e tyre me kalimin e viteve. Ne vazhdojmë të jemi në një periudhë kalimtare, pasojat e së cilës po i vuajnë edhe Zonat e mbrojtura. Ato po e pësojnë rëndë mos-qeverisjen siç

duhet, që pasqyrohet në përdorimin kaotik të tyre. Sfidat më të madhe, për zonat e mbrojtura këto kohë e fundit, është ruajtja e tyre.

4. PROBLEMET KRYESORE DHE DOMOSDOSHMERIA E NDERHYRJES

Ndër problemet kryesore që po hasin këto zona të mbrojtura përmendim:

Përkeqësimi i infrastrukturës rrugore (Parku Kombëtar Lurë, Parku Kombëtar Butrint, Dajt, etj.);

Shkatërrimi i habitateve dhe degradimi i mëtejshëm i tyre (Lurë, Kune Vain, Karavasta, etj.);

Erozioni në përgjithësi dhe ai bregdetar në veçanti (Mali me gropa, Kune Vain, Pishë Poro, etj.);

Në këto zona të mbrojtura, zona buferike jo vetëm që është e vogël, por ajo nuk ekziston, pasi ndikimi i ndërtimeve jo vetëm që ndihet në kufijtë e zonës buferike, por edhe në brendësi të vetë zonës së mbrojtur;

Prerjet e pyjeve si brenda Zonave të Mbrojtura, ashtu edhe anash rrugëve (Lurë, Llogara, Dajt, etj.);

Përhapja e zjarreve gjatë stinës së verës (Llogara, Karaburun, Lurë, Divjakë, etj.);

Përndjekja e kafshëve dhe shpendëve të egra (fenomen shumë i hasur në Karavasta, Kune Vain etj.);

Mënyrat jo efektive të menaxhimit të kënetave për shpendët dimëruar (Karavasta, Kune Vain, etj.);

Menaxhim jo efektiv i aktiviteteve rekreative, të cilët përveç postbllokut për mbledhjen e tarifave në hyrje të zonës së Mbrojtur nuk kanë marrë asnjë veprim për krijimin e kushteve për mikpritjen e vizitorëve apo për parkimin e makinave (Dajt, Llogara, Divjakë, Kune Vain, etj.);

Kullotja e pakontrolluar (Mali me gropa, Divjakë, etj.);

Ndërtimet pa leje po zaptojnë Zonat e Mbrojtura (Dajt, Divjakë, Llogara, Liqeni i Pogradecit, Lurë, Theth, Kune Vain, etj);

Gjuetia, mbipeshkimi, peshkimi ilegal, si dhe përdorimi i mjeteve të ndaluara, si lëndë plasëse në kënetat, të cilat vrasin të gjithë organizmat që ndodhen aty, duke çuar në një varfëri biodiversiteti (Karavasta, Kune Vain, etj);

Mos menaxhimi i vizitorëve dhe i plehrave të ngurta që ata prodhojnë, duke dëmtuar peizazhin dhe vlerat estetike të zonës (Karavasta, Dajt, Llogara, Butrint, Lurë, Kune Vain, Liqeni i Pogradecit, etj);

Lokalet në brendësi të parkut, shpesh e marrin lejen për ushtrimin e aktivitetit të tyre vetëm nga njësitë vendore, pa marrë pëlqimin e organeve të shërbimit pyjor, (Llogara, Dajt, etj);

Guroret po përbëjnë një dukuri negative në shkatërrimin e habitateve dhe zvogëlimin e tyre, të cilët jo vetëm që po dëmtojnë peizazhin e parkut, gjendjen ekologjike të mjedisit përreth, por po krijojnë shqetësime për vizitorët dhe banorët e zonës (Llogara, Dajt, Tomor, Mali me gropa, Orosh, etj);

Përkeqësimi i gjendjes fizike, regjimi ujqor dhe cilësia e ujërave, shkarkimi i ujërave të zeza të qyteteve ose të fshatrave përreth, pakësimi i ujë këmbimit me detin, po i shkatërron pak e nga pak këto zona të mbrojtura (Karavasta, Kune-Vain, Pishë Poro, Orikum, Nartë, etj).

Në vendin tonë kalojnë 12 maune në orë drejt Greqisë dhe Maqedonisë.

90% e drurëve që priten janë të pakontrolluara.

Në mënyrë kategorike nuk duhet t'i afroresh zonës buferike apo tampon të zonave të mbrojtura dhe në qoftë se

vendoset të ndërtohet, kjo duhet bërë në një distancë prej 100m largësi.

Përfundimi, ja pse detyrohemi të pohojmë se Zonat e Mbrojtura në Shqipëri janë të Pambrojtura, se Liqenet janë pa shpezë dhe se pyjet janë pa kafshë.....

5. MENDIME QË MUND TË MERREN PARASYSH

Të krijohet dhe të fuqizohet një sistem kombëtar gjithërfshirës, përfaqësues dhe efektivisht i menaxhuar i ZM, i integruar në mjedise më të gjera tokësore dhe detare me qëllim, ruajtjen e strukturës e funksioneve ekologjike, arritjen e objektivave globale.

Të përmirësohen në mënyrë të qëndrueshme planifikimi dhe menaxhimi i ZM nëpërmjet mekanizmave për ndarjen e drejtë të kostove dhe përfitimeve që rrjedhin nga krijimi dhe menaxhimi i ZM, duke përfshirë plotësisht komunitetet vendore dhe aktorët e tjerë të interesuar në menaxhimin e zonave eksistuese dhe krijimin dhe menaxhimin e zonave të reja të mbrojtura.

Të krijohet një mjedis mbështetës dhe të sigurohet qëndrueshmëria financiare për një menaxhim më efektiv të ZM nëpërmjet rishikimit dhe përmirësimit të politikave, duke përfshirë edhe përdorimin e vlerësimeve dhe iniciativave social-ekonomike.

Të hartohen dhe të zbatohen programe dhe iniciativa gjithpërfshirëse për ngritjen e kapaciteteve, për aftësimin në nivel individual, institucional dhe komunitetesh; ngritjen e standardeve profesionale për planifikimin, krijimin dhe menaxhimin e ZM dhe për përmirësimin e komunikimit, edukimit

dhe ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë dhe përfitimet nga ZM.

Të krijohet sistemi kombëtar i monitorimit efektiv të gjendjes dhe tendencave në ZM për të lehtësuar vlerësimin dhe raportimin mbi efektivitetin e menaxhimit të ZM dhe për të ndihmuar vlerësimin e ecuresë në arritjen e objektivave globale të biodiversitetit.

Të sigurohen njohuritë shkencore mbi ZM për menaxhimin efektiv të ZM duke ndërmarrë aktivitete për përmirësim-kërkimin dhe bashkëpunimit shkencor në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Të kryhen kërkime shkencore ndërdisiplinore: metoda dhe teknika për vlerësimin e vlerave dhe shërbimeve në ZM apo mbështetje për përhapjen dhe lehtësimin e aksesit drejt informacionit teknik, publikimet për ZM, si dhe zhvillimi dhe fuqizimi i partneriteteve me organizatat dhe insitucionet shkencore ndërkombëtare, që kryejnë studime që rrisin shkallën e njohjes së biodiversitetit në ZM.

Të bëhet e mundur nxitja e mjedisit lehtësues për transferimin e metodave, teknologjive e bashkëpunimin për të përmirësuar menaxhimin e ZM.

6. STUDIME MBËSHTETËSE

Autori	Titulli	Viti
A.K.M	Buletini mjedisor	1998 - 99, 2004
Ambasada Angleze në Tiranë	Gazetaria investiguese në fushën e mjedisit	2004
Banka Botërore	E drejta për të treguar (Roli i medias në Zhvillimin Ekonomisë)	2003
Blue	Linja blu Shqiptare	2010

Editions		
Financuar nga BE Programi CARD	Qeverisje me pjesëmarrje qytetare OJF për procesin e decentralizimit	2003
G & G group	Plani i Veprimit për Mbetjet Urbane.	2005
G & G group	Vlerësim i Ndikimeve në Mjedis për zona urbane, Dajt, Kashar, Fark, etj.	2008
GEF	Konventa mbi diversitetin biologjik Raporti ndërkombëtar Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin	2009
Laze. P., Lushaj. Sh., Suljoti.	Studimi i problemeve të ndotjes së tokës dhe ujit në zonat më të ndjeshme mjedisore të vendit	1998
Maxhun D. , Nihat D.,Genti K. ,Gjon F.	Zonat e mbrojtura natyrore; Parqet kombëtare të Shqipërisë	2004
Miliekontakt OOST-EUROPA	Strategjia e Edukimit mjedisor	2005
MMPAU	Akte ligjore për pyjet, kullotat dhe zonat e mbrojtura	2005
MMPAU	RREZIKU "AMIANT"	2006
Pano N.	Pasuritë ujore të Shqipërisë	2008
Pasha M.	Mbulimi i tokës së Shqipërisë	2003
Peçuli. V., Mankolli. H.	Ekologjia e Aplikuar	2005
Ziu. T.	Biogjeografia	2006

Prof.Asc. Sazan GURI
Instituti "G&G Group"

AUDITIMI I FRYMËS SË DREJTIMIT TË LARTË

Analiza e krizës më të fundit financiare botërore, që nisi në vitin 2008, evidentoi një sërë shkaqesh, deri edhe përkeqësimin e përgjithshëm të etikës dhe standardeve

Nga: Teuta Baleta¹

Fjalë kyçe: auditim i brendshëm, kontroll, mjedis, drejtim

Abstrakt: Mjedisi i kontrollit, në veçanti fryma e drejtimit apo e drejtuesit të lartë, formojnë terrenin, i cili mbështet funksionimin me efektivitet të auditimit të brendshëm... ose mund ta izolojë këtë funksion, duke e penguar të përmbushë objektivin e vet, atë të ofrimit të shërbimit të sigurisë për drejtimin e institucionit apo palët e interesuara. Më së shumti, ky efektivitet çenohet nga fenomeni "i shurdhërisë" së drejtimit të lartë dhe dështimit të tij në ndërtimin e mekanizmit të pranimi të rrezikut. Një mjedis i tillë e vë funksionin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm përballë sfidave të vështira.

Nëntitull 1: Mësojmë nga kriza

Në ekonominë, institucionet apo shoqërinë e një vendi, herë pas here shpërthejnë kriza. Përtej pasojave, nganjëherë edhe shkatërruese, që mund të kenë ato, krizat kanë edhe rrjedhoja "pozitive". Kur "kalon furtuna" dhe gjithçka "qetësohet" fillon procesi i analizimit të shkaqeve që çuan në ngjarje të tilla. Ky proces ngjan me një intervistë në të cilën bëhen një numër pyetjesh, të tilla si: Çfarë e shkaktoi ngjarjen apo krizën? A mund të parandalohet ajo? Nëse po përse nuk u parandalua? Nëse jo, a ishte e mundur të përgatitej situata për të pësuar sa më pak dëme? Cili ka përgjegjësi (individuale ose institucionale) për ngjarjen? A do të vihen përgjegjësit përpara përgjegjësisë? Çfarë masash po

¹Opinionet e shprehura në këtë artikull përfaqësojnë opinione personale të autorit.

merren për të kapërcyer situatën? A janë këto masa të mjaftueshme? etj., etj., për të arritur në grupin ndoshta më të rëndësishëm të pyetjeve të cilat lidhen me përgatitjen për të ardhmen: A po studiohet një sistem mekanizmash ose masash që kjo ngjarje a krizë të mos përsëritet? A janë ato efektive për parandalimin e ngjarjes apo krizës?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave si këto nxjerrin në pah dobësitë e një sistemi / mjedisi / institucioni / mënyre të menduarit apo të vepruarit, të cilat në pamje të parë ngjajnë si dobësi të vogla, të neglizhueshme dhe të padëmshme. Por të tilla dobësi mbartin në vetvete rrezikun e shtresëzimit, rritjes së tyre derisa krijojnë kushtet e përshtatshme për shpërthim të krizës apo ndodhje të ngjarjeve të rënda me pasoja të dëmshme. Pikërisht në momentin e shpërthimit e më pas bëhet e qartë se ishte mungesa e vëmendjes, neglizhenca, harresa, shurdhëria ato që lejuan mbarsjen e problemit.

Krizat ose ngjarjet e rënda ndodhin me apo pa frekuencë/cikël të njohur. Një pjesë e tyre janë fenomene të reja, të pa përjetuara më parë, pra edhe të vështira për t'u parandaluar apo administruar me kohë e me sa më pak kosto. Në këtë kuptim, krizat shërbejnë si mekanizma rregullimi apo shkolla ku mësohet. Prej tyre nxitet një proces i tërë përmirësimi teknologjie, produktesh, sistemesh, institucionesh, e deri në ndryshimin e mënyrës së të menduarit.

Por disa prej tyre u përngjasojnë ngjarjeve të së kaluarës, e madje mund të kenë të njëjtat shkaqe, fenomen i cili

tregon se shpeshherë, me ose pa qëllim, anashkalohen apo nuk respektohen elementët më bazë të kontrollit. Prandaj, nuk është e rastësishme që pas të tilla ngjarjeve vëmendja kthehet në parimet apo mësimet bazë të kontrollit. Por kuptohet ky rikthim shoqërohet me elementë të rinj të të kuptuarit apo të zhvilluarit të konceptit.

Autoritetet gjithnjë kanë reaguar kundrejt krizave apo skandaleve të shoqërive aksionare përmes reformave, rregullave dhe forcimit të qeverisjes. E megjithatë, gjithnjë bëhet pyetja: Përse ndodhin ende mashtrime dhe dështime? Analiza e krizës më të fundit financiare botërore, që nisi në vitin 2008, evidentoi një sërë shkaqesh, deri edhe përkeqësimin e përgjithshëm të etikës dhe standardeve. Erkens et al., (2010) sugjeruan që në vetvete qeverisja e mirë nuk mund t'ia dalë me sukses ndaj kulturës helmuese të shoqërisë aksionare. Që në vitin 2004, në Forumin Ekonomik Botëror të Davosit ishte pranuar se ekzistenca e një ndjenje më të lartë përgjegjësie morale në nivelet e bordeve/këshillave është më e efektshme sesa rregullat. Ky Forum vuri theksin në sjelljen njerëzore si një element kyç në reformën e qeverisjes. Pra, kontrollet nuk funksionuan më së shumti për shkak se diçka nuk funksionoi në kulturën e korporatave. Roth (2010:49) thekson se "... shkak kryesor i mashtrimeve më të mëdha dhe dështimeve më të mëdha të biznesit është pothuaj gjithmonë një dobësi në kulturën e shoqërisë aksionare; ose e thënë me fjalë të tjera një dobësi e kontrolleve të buta."

Në analizimin e shkaqeve të krizës më të fundit financiare botërore natyrshëm u shtruan edhe pyetje të tilla si: “Ku ishin audituesit?”; “Çfarë bënë audituesit?” Kriza në fakt vuri në provë supozimet kyçe mbi të cilat ngrihet roli i auditimit të brendshëm; teknikat e auditimit të bazuara në rrezik, si dhe të modelit me tri vija mbrojtjeje në administrimin e rrezikut (Piper 2014).

Çfarë nënkupton shtrimi i pyetjeve të tilla? Sigurisht jo vendosjen e barrës së fajit tërësisht apo kryesisht në funksionet e auditimit të brendshëm e të jashtëm. Por duke analizuar mesazhin që përçojnë të tilla pyetje dhe duke u përpjekur të jepen përgjigje për to, rishqyrtohet funksioni i auditimit, si pjesë e mekanizmit, dhe orientohet zhvillimi i tij drejt përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit.

Pikërisht kjo tendencë zhvillimi u vërejt pas krizës financiare botërore. Auditimi në tërësi, dhe sidomos funksioni i auditimit të brendshëm, u vendos në një përmasë më të gjerë dhe të rëndësishme në kuadër të organizatës. Nëse i referohemi Standardeve Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale për Auditimin e Brendshëm (në vijim i referohemi thjesht si Standarde), të nxjerra në vitin 2008 dhe të rishikuara më pas, vërehet se në tërësi rishikimet që ato kanë pësuar kanë përforcuar rolin e auditimit të brendshëm si një funksion i rëndësishëm në qeverisjen e një organizate. Nga një krahasim i thjeshtë i versionit të rishikuar në vitin 2012 kundrejt versionit të rishikuar në vitin 2010, standardi 2100: Natyra e Punës, që ka të bëjë me kërkesat për

vlerësimin dhe kontributin në përmirësimin e qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit, ka forcuar kërkesat për rolin e auditimit të brendshëm në drejtim të proceseve të qeverisjes, duke përfshirë vlerësimin e përmbushjes së objektivave strategjikë të organizatës.

Në standardin 2120.A1 parashtrohet që veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë ekspozimin ndaj rrezikut në lidhje me qeverisjen, operacionet dhe sistemet e informacionit të organizatës, që kanë të bëjnë jo vetëm me besueshmërinë dhe integritetin e informacionit operacional dhe financiar; efektivitetin dhe efektshmërinë e operacioneve dhe programeve; ruajtjen e pasurive/aktiveve apo pajtueshmërinë me ligjet, rregullat, politikat, procedurat dhe kontratat (përcaktuar në versionin e rishikuar në vitin 2010) por në radhë të parë edhe me arritjen e objektivave strategjikë të organizatës (versioni i rishikuar në vitin 2012).

Më tej në standardet që lidhen me planifikimin dhe objektivat e një angazhimi auditimi (grupi 2200) në konsideratat e planifikimit versioni i rishikuar në vitin 2012 përfshin edhe qeverisjen, krahas administrimi të rrezikut dhe proceseve të kontrollit.

Nëntitull 2: Fryma e drejtimit të lartë

Pohimi: Institucioni merr fytyrën e atij që e drejton, është gjerësisht i njohur dhe i pranuar, duke marrë praktikisht vlerën e një aksiome. Në mënyrë të sintetizuar, ky pohim shpreh pothuaj gjithçka për qeverisjen e një

institucionit. Mesazhi i drejtpërdrejtë që jepet në këtë pohim na tregon se drejtimi apo drejtuesi i një institucioni ka mundësi të përvijojë një organizatë që funksionon me integritet, standard të lartë moral, me kulturë të shëndoshë e të suksesshme, apo të orientohej nga objektiva krejt të tjerë. E thënë në gjuhë teknike, fryma e drejtimit apo drejtuesit të lartë (në gjuhën angleze: Tone at the Top) është një variabël i rëndësishëm në funksionimin e institucionit, sepse ajo përçohet në të gjithë organizatën dhe te gjithkush në të.

Në tetor të vitit 1987 Treadway Commission në shqyrtimin e një sërë faktorëve që çuan në mashtrime me raportimet financiare, në formulimin e rekomandimeve se si të shmangeshin mashtrimet, u përqendrua veçanërisht në trajtimin e elementit të "frymës së drejtimit të lartë" dhe theksoi: "Fryma që jep drejtimi i lartë, mjedisi ose kultura e shoqërisë aksionare, në të cilin kryhet raportimi financiar i shoqërive aksionare, është faktori më i rëndësishëm që kontribuon në integritetin e procesit të raportimit financiar. Pavarësisht kuadrit mbresëlënës të rregullave dhe procedurave të shkruara, nëse fryma (toni) e përcaktuar nga drejtimi është e dobët, atëherë ka më tepër të ngjarë që në raportimin financiar të ketë mashtrime."

Nga shqyrtimi i literaturës së fushës së kontrollit, pajtueshmërisë dhe auditimit kuptohet se fryma e drejtimit të lartë është një term që përdoret për të përcaktuar udhëheqjen që bën drejtimi (drejtuesit) dhe angazhimi, dhe ritheksimi i angazhimit, nga ana e drejtuesve, kundrejt vlerave të tilla si, të

qenit i hapur, i ndershëm, me integritet dhe me sjellje etike.

Pra, fryma e drejtimit të lartë është mesazhi, qëndrimi dhe kultura që këshilli (bordi) i drejtorëve përhap në të gjithë organizatën. Për disa ajo përbën elementin më të rëndësishëm të mjedisit të kontrollit dhe për disa të tjerë është ekuivalenti i mjedisit të kontrollit të brendshëm. Në një organizatë, ajo ka një ndikim apo përçohet nga lart-poshtë te çdo nivel i mesëm i drejtimit, si edhe te të gjithë individët. Fryma e drejtimit të lartë përshkruhet si konsistenca në pohime, deklarime dhe shpjegime të drejtuesve, si dhe me veprimet e tyre. Si rregull, nëse drejtimi i përmbahet vlerave të ndershëmërisë, integritetit dhe etikës, edhe punonjësit ka shumë më tepër të ngjarë t'u përmbahen të njëjtave vlera. Në këtë formulim vërehen disa elementë të rëndësishëm:

Përcaktori "i lartë" nënkupton jo drejtues të një niveli të çfarëdoshëm në organizatë, apo drejtuesin e përgjithshëm ekzekutiv, por drejtuesin më të lartë në shkallën hierarkike, pra kreun e institucionit, Kryetarin e Këshillit (Bordit). Nga kjo "lartësi" vjen mesazhi dhe angazhimi.

Fjala "mesazh" nënkupton një përmbajtje dhe angazhim kundrejt standardeve më të larta etike në çdo aspekt të veprimtarisë së organizatës.

Mesazhi do të duhet të komunikohet, ku rëndësi merr edhe mënyra se si përçohet ai. Mesazhi nuk mund të konsiderohet se është komunikuar në mënyrën e duhur kur transmetohet njëherë, me një dokument të shkruar.

Mesazhi nevojitet të përçohet në mënyrë të vazhdueshme, duke u shndërruar në pjesë përbërëse të të gjithë aktivitetit të organizatës, përmes edukimit dhe trajnimit, por ajo që është më e rëndësishme përmes veprave, të vepruarit në praktikë dhe dhënies së shembujve.

Së fundi, është elementi i pritësit të mesazhit, pra kujt i komunikohet ai. Mesazhi ka nevojë të shkojë te të gjithë punonjësit e organizatës në çdo nivel të saj, të cilët duhet të kuptojnë dhe pranojnë rëndësinë e sjelljes etike dhe respektimin e një sjelljeje të tillë.

Literatura e drejtimit trajton sistemet e kontrollit të drejtimit. Sipas kësaj shkolle mendimi, fryma e drejtimit të lartë është formë e kontrolleve kulturore, që nënkupton se funksionimi i kontrolleve varet nga presioni që ushtron grupi mbi individin, i cili është shmangur nga një sistem vlerash të caktuara. Bruinsma dhe Wemmenhove (2009) nga kjo shkollë mendimi citojnë pesë metoda të kontrolleve kulturore, që janë kodi i sjelljes, shpërblimet në grup, transfertat, kontrollet fizike dhe sociale, si dhe fryma e drejtimit të lartë, e cila përbën një pjesë të rëndësishme në kodeve të qeverisjes së shoqërive aksionare.

Përcaktimi i frymës së drejtimit të lartë nënkupton që kultura në një organizatë formohet në mënyrë të tillë që pranon dhe mban një mjedis kontrolli efektiv, duke ndërtuar strukturën dhe disiplinën e nevojshme për të ndikuar në vetëdijen e organizatës. Pra, sjellja e drejtimit duhet të përputhet me kulturën që përpiqet të formojë.

Konsensusi i ekspertëve (Bruinsma dhe Wemmenhove 2009) konkludon se fryma e drejtimit të lartë ndërtohet mbi katër gurë themeli: drejtimi, kultura, komunikimi dhe struktura, si dhe përcaktojnë një sërë elementësh që në fakt përbëjnë një listë referimi kundrejt të cilave mund të vlerësohet fryma e drejtimit të lartë (shih tabelën në vijim). Nga drejtuesit, udhëheqja komunikimi dhe përcimi i kulturës duhet të jetë konsistent dhe njëherësh udhëheqja duhet të mbikëqyrë kulturën në organizatë, si dhe komunikimin. Fryma e drejtimit të lartë përcaktohet në nivelet e larta të drejtimit, komunikohet në të gjithë organizatën dhe cikli mbyllet përsëri te drejtimi i lartë përmes procesit të mbikëqyrjes.

Për këtë arsye pas shpërthimit të skandaleve të shoqërive aksionare në vitet 2000 (Enron etj.) u ndërmorën një sërë reformash, të cilat e vinin theksin te kultura e shoqërive dhe mjedisi i kontrollit. Në veçanti legjislacioni i miratuar në SHBA pas këtyre skandaleve, i njohur si Sarbanes-Oxley ka si pjesë të rëndësishme dispozitën për kontrollin e brendshëm, duke theksuar "pohimin e kontrollit". Ky element ka të bëjë me faktin që drejtuesi i përgjithshëm ekzekutiv dhe drejtuesi financiar (që ka përgjegjësi për administrimin financiar, CFO) i një shoqërie duhet të pohojnë se ata "e kanë gjendjen nën kontroll" apo "janë në kontroll të situatës", gjë që nënkupton se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon mirë. Ky ligj në veçanti, por në përgjithësi e gjithë reforma e qeverisjes që pasoi skandalet e shoqërive aksionare e vunë theksin në

përgjegjësinë e drejtuesve më të lartë, duke ia lënë atyre drejtpërdrejt përgjegjësinë, funksionimin e mirë të sistemeve të kontrolleve të brendshme. Një konceptim i tillë i përgjegjësisë i ndërtuar në sektorin privat u përkrah më pas edhe nga ai publik, njësitë e pushtetit ekzekutiv apo institucionet e pavarura, veçanërisht autoritetet rregullatore të tregjeve / industrive.

Tabela: Gurët e themelit dhe elementët e frymës së drejtimit të lartë

Guri i themelit dhe përcaktimi i tij	Elementët
Drejtimi Drejtuesit dhe Drejtuesi i Përgjithshëm Ekzekutiv (CEO) duhet të udhëheqin duke treguar integritet, duke i kushtuar vëmendje aftësive të burimeve njerëzore dhe duke dhënë shembullin e duhur përmes veprimit.	Udhëheqje që frymëzon Veprim me anë të shembullit Vëmendje për burimet njerëzore Integritet në opinionet që jep Integritet në stilin e drejtimit I vetëdijshëm ndaj rrezikut Konsistent në veprime dhe mesazhe Me angazhim për të vepruar me competence
Komunikimi Komunikimi ka të bëjë me ndërveprimin nga lart poshtë dhe anasjellas në të gjitha format e mundshme.	Ndërveprim Lart poshtë dhe anasjellas E drejtë/e gabuar/simbole/zakone /supozime Verbale/electronike/vizuale/me shkrim Kode sjelljeje/etike
Kultura Kultura lidhet me vlerat etike, zakonet dhe supozimet. Që fryma e drejtimit të lartë të jetë e suksesshme nevojitet një	Kulturë rreziku që është e pavarur dhe aktive Fuqizim/delegim kompetencash Sisteme shpërbmi Norma dhe vlera Politikë alarmdhënësve

kulturë rreziku që është e pavarur dhe aktive; që punonjësit të fuqizohen nga pikëpamja e kompetencave që u delegohen për të marrë vendime e deri te nevoja për mbrojtjen e individëve që veprojnë si alarmdhënës në rastet kur diçka shkon keq.	
Struktura Shkalla e rrezikut që merr përsipër organizata duhet të përshtatet me strategjinë, prandaj kërkohet përcaktim përgjegjësish, informim i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, si dhe një bord aktiv.	Lidhja e marrjes përsipër të rrezikut (ose siç njihet me termin oreksi për rrezik) me strategjinë Këshill mbikëqyrës i pavarur, aktiv dhe i anagzhuar Përcaktimi i përgjegjësive Struktura informimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme të drejtimit

Burimi: Bruinsma dhe Wemmenhove (2009)

Nëse i referohemi rastit më të fundit të ndodhur në bankën qendrore të Shqipërisë, duke e përqendruar diskutimin vetëm në elementët administrativë, është e qartë se skandali u mundësua edhe si rrjedhojë e mosfunksionimit të një apo disa kontrolleve. Analiza e plotë e shkaqeve të mosfunksionimit të kontrolleve është detyrë e autoriteteve të këtij institucioni, prandaj ky artikull nuk përmban ndonjë analizë më të hollësishme. Por ajo çka duhet theksuar është që përgjegjësinë për "mbajtjen nën kontroll të situatës" në radhë të

parë e mbi të gjithë e kanë ata drejtues të bankës qendrore që luajnë rolet e CEO dhe CFO. Për këtë arsye, mungesa për një kohë të konsiderueshme e zëvendësguvernatorit të dytë të bankës qendrore (që ka edhe rolin e CFO) përbën një mangësi të rëndësishme në grupin e drejtuesve që kishin përgjegjësinë për të mbajtur në funksionim të mirë sistemin e kontrolleve të brendshme.

Nga ana tjetër, meqenëse fryma e drejtimit të lartë lidhet me elementë të patrupëzuar, vlerësimi i saj paraqet vështirësi. Në publikimin "Tone at the Top" i IIA (nëntor 2003), por dhe nga autorë të tjerë jepet një listë interesante dhe të dobishme pyetjesh, të cilat çdo organizatë mund t'i përdorë për të vetvlerësuar mjedisin e kontrollit. Thelbi në këtë listë pyetjesh qëndron në përcaktimin që fryma etike e drejtimit të lartë (kreut) komunikohet me anë të punës dhe veprave, duke patur një këshill drejtorësh aktivë, të pavarur dhe të mirëinformuar, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë, duke e deleguar autoritetin në përpjesëtim të drejtë me përgjegjësinë; duke vendosur teknika komunikimi të shpeshta ndërmjet drejtuesve të lartë dhe atyre operacionale, e gjitha kjo e shoqëruar me politikë punësimi që orientohet kah tërheqja e personelit të kualifikuar, etik, që promovohet, trajtohet dhe kompensohet sipas procedurave dhe politikave të përshtatshme dhe për të cilët kryhet kontrolli biografik, sidomos në rastet kur emërohen në pozicione me ndjeshmëri të lartë.

Me një shikim të shpejtë shumica e drejtuesve të organizatave mund të shprehin se përmbushen këto kërkesa e për rrjedhojë të konkludohet se në organizatë është vendosur një mjedis kontrolli efektiv. Por a është në realitet kështu? Përgjigjja për këto pyetje varet nga sinjeriteti i procesit të vetvlerësimit.

Nëntitull 3: Auditimi dhe roli i tij

Siç e theksuam, mjedisi i kontrollit përfshin faktorë të tillë si integriteti, vlerat etike dhe kompetenca e punonjësve të organizatës; filozofia e drejtimit dhe stili i punës së drejtimit; mënyra se si drejtimi cakton autoritetin dhe përgjegjësinë, si dhe organizon dhe zhvillon punonjësit; dhe vëmendja e drejtimit në vendosjen e objektivave.

Auditimi i brendshëm në një organizatë ka nevojë të përfshijë në objektin e tij të punës edhe frymën e drejtimit të lartë. Për Roth (1997:6) nëse zbatohet COSO "Na duhet të vlerësojmë jo vetëm veprimtaritë e prekshme të kontrollit, pra kontrollet "e forta", por edhe të gjithë elementët e paprekshëm, pra kontrollet "e buta" që përdoren prej drejtuesve për të kontrolluar një organizatë". Nëse kontrollet e forta janë politikat, procedurat, struktura organizative, burokracia dhe proceset e formalizara kufizuese, kontrollet e buta kanë të bëjnë me pjesën joformale të kontrollit, si fryma e drejtimit të lartë, kompetenca, besimi, vlerat, udhëheqja e fortë, pirtshmëri të larta, të qenit i hapur dhe me standarde të larta etike. Kontrollet e buta përbëjnë elementë të kulturës së shoqërisë aksionare dhe kjo

kulturë përkufizohet si tërësia e kontrolleve të buta (Roth, 2010).

Njerëzit përbëjnë një element thelbësor të sistemit të kontrollit dhe janë ata që mund t'i shkelin, anashkalojnë, apo të gjejnë mënyra për manipulimin e kontrolleve. Kompetenca dhe aftësitë e punonjësve dhe drejtuesve janë një aspekt i elementëve mbrojtës (kontrolleve). Por, po kaq rëndësi marrin edhe elementë të tillë si integriteti, vlerat etike dhe fryma e shëndoshë që kanë punonjësit dhe veçanërisht drejtuesit. Në një mjedis jo etik rritet shkalla e rrezikut të manipulimit apo mosfunksionimit të sistemit të kontrollit, edhe nëse kontrollet e vendosura janë mëse të përshtatshme.

Është pikërisht ky element i patrupëzuar dhe tepër i rëndësishëm i sistemit të kontrollit, që natyrshëm tërheq mbi vete edhe nevojën për t'u audituar. Kuptohet se auditimi me objektivitet i këtyre elementëve përbën realisht një sfidë, sepse ka të bëjë me perceptimet, ndjenjat, sjelljen njerëzore, marrëdhëniet dhe kulturën. Mbi të gjitha vështirësia e auditimit lidhet me shkallën e të kuptuarit të kontrolleve të buta dhe ndikimit që ato kanë në organizatë, veçanërisht në nivelin e mesëm të drejtuesve dhe në punonjës, nga ana e drejtimit.

Ky proces paraqet vështirësi edhe për vetë audituesin e brendshëm, të cilat lidhen me njohuritë, përvojën, disponueshmërinë e mjeteve dhe teknikave të vlerësimit, gjetjen e evidencës për të mbështetur konkluzionet e auditimit, raportimin e gjetjeve e kështu me radhë, sepse të

tilla kontrolle janë subjektive; dobësitë e vërejtura në këto kontrolle janë sensitive, si dhe janë të vështirë për t'u përshkruar. Mbi të gjitha vështirësia qëndron në mjedisin ku do të kryhet auditimi. Roth (2010) sugjeron që aty ku audituesit kanë marrëdhënie jo të mira me mjedisin që auditojnë, ka pak të ngjarë që të tilla auditime të kenë sukses.

Nëntitull 4: Mënyra për auditim

Angazhimet e auditimit për kontrollet e buta, hasin vështirësi por ato nuk janë të pamundura. Në tërësi procesi i auditimit të kontrolleve të buta ndjek të njëjtin shteg si edhe auditimi i kontrolleve të forta. Nga literatura sugjerohet që në të tilla auditime të angazhohen auditues të brendshëm me përvojë dhe në pozita më të larta. Buhariwalla (2006) mbështet idenë e angazhimit madje edhe të ekspertëve të fushës së psikologjisë apo të administrimit të burimeve njerëzore.

Mjeti i përdorur më shpesh për auditimin e kontrolleve të buta duket se janë vrojtimit; organizimi i takimeve të diskutimit për vetvlerësimin e kontrolleve; trajnimi dhe takimet e diskutimit dhe testet thelbësore. Këto mjete mund të përdoren veçmas ose të kombinuara.

Për Allsup et. al., hapi i parë në të tilla angazhime auditimi është edukimi, veçanërisht i drejtimit me të tilla kontrolle dhe rëndësinë që ato kanë. Reinecke e rithekson nevojën e edukimit duke vënë në dukje faktin që në trajtimin e të tilla kontrolleve: **"Përgjigjja tipike që merr nga drejtuesit e lartë është që dobësia në kontrollet e**

buta ... nuk ka ndonjë ndikim në rezultatet financiare dhe, për rrjedhojë, duhet të trajtohet vetëm me njësinë e burimeve njerëzore.” Prandaj sugjerohet që në planifikimin e auditimeve të tilla të përfshihet dhe drejtuesi (Roth 2009).

Vetvlerësimet dhe takimet e diskutimit për vlerësimin e kontrolleve janë metoda të cilat përdoren për të kuptuar kontrollet e buta dhe nga ku evidentohet edhe kultura e shoqërisë, sepse në të tilla aktivitete mbliidhen perceptimet e punonjësve.

Një tjetër metodë e mirë, sipas Mitchell (2006, 2008) është vërtetimi, sepse ndihmon audituesit e brendshëm të vlerësojnë mjedisin e kontrollit, forcon komunikimin duke hapur dialogun, merret informacion dhe ndjesi se çfarë kujdesi tregon drejtimi për çështje të ndryshme dhe se si administrohet institucioni. Por vërtetimi është një metodë efektive nëse ka mbështetje nga drejtuesit dhe nëse ata janë të gatshëm të dëgjojnë të vërtetën dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për përmirësim. Roth (2010:55) thekson se: “Vërtetimet nuk janë mjeti i përsosur për vlerësimin e kontrolleve të buta të të gjithë njësive, por janë mjeti më mirë që është i disponueshëm. Ato ofrojnë një matje me saktësi të arsyeshme të kulturës së shoqërisë.”

Së fundi, procesi i raportimi duhet t'i përshtatet llojit të kontrolleve të audituara. Raportimi mund të bëhet me shkrim ose me gojë, me diskutime formale apo në formën e prezantimeve. Forma e raportimit varet gjerësisht nga audienca e raporteve. E rëndësishme

është që metoda e përdorur për raportim të ketë probabilitetin më të madh që të shoqërohet me masa korrektuese.

Në një vërtetim të kryer nga PriceWaterhouseCoopers (2012), 87% e të anketuarve pranojnë që fryma e drejtimit të lartë është kritike për zbutjen në mënyrë të efektshme të rrezikut të organizatës së tyre për mashtrimin, korrupsionin dhe sjelljen etike dhe "rojtari" kryesor i kulturës konsiderohet drejtuesi i përgjithshëm ekzekutiv i organizatës. Po në këtë vërtetim konkludohet se vetëm kur vlerat ritheksohen në mënyrë konsistente dhe përsëriten në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet sjelljes koherente dhe të qartë të drejtuesve arrihet që standardet etike të bëhen pjesë e organizatës dhe njerëzve të saj. "...Përndryshe, nëse nuk ekziston fryma e drejtimit të lartë, çdo gjë tjetër do të dështojë", citon raporti njërin prej të vërtetuarve (f. 7).

Duke e analizuar nga jashtë institucionit, skandali më i fundit në bankën qendrore shfaq pikërisht dobësi në frymën që përçoi drejtimi i lartë në të gjithë institucionin, në vlerat dhe sjelljen etike. Përsëri literatura këshillon që audituesi i brendshëm duhet të kërkojë në organizatë sinjale paralajmërimi, të tilla si “shenjat e dukshme të suksesit” që shoqërohen me përdorim të tepruar të privilegjeve që ofron ajo, si për shembull përdorimi i tepruar i helikopterëve apo automjeteve të institucionit; pajisja e zyrave me orëndi tepër luksoze; shpërndarja e shpërblimeve të tepruara etj.. Këto elementë janë për një

auditues të brendshëm shenja paralajmëruese, që ai të përgatitet se mund të ndodhë shpejt një veprim i keq. Të tjera mjete që i sugjerohen audituesit për t'u përdorur si shenja paralajmëruese janë përdorimi i linjave telefonike anonime apo në tërësi i marrjes së mesazheve anonime. Kryerja e vrojtimeve të rregullta me punonjësit e organizatës në lidhje me kulturën e organizatës dhe perceptimet e punonjësve është një tjetër mjet që shërben si sinjal i hershëm lajmërimi. Por është e qartë që informacioni i siguruar me këto mjete është thjesht sinjal apo tërheqje vëmendjeje, që tregon se ka hapësira apo krijohen mundësi që mund të keqpërdoren bazuar në motive financiare. Sinjalet e marra nga rrugë të tilla nuk përbëjnë fakte të vlefshme për të konkluduar auditimin, por duhet kërkuar më tej.

Nëntitull 5: Shurdhëria

Në një institucion me mjedis etik, ku ka frymë të shëndoshë dhe pozitive të drejtimit të lartë, puna e audituesit të brendshëm është e efetshme. Por jo të gjithë audituesit e kanë fatin të punojnë në mjedise të tilla. Në një numër organizatash drejtuesit e lartë dhe/ose këshillat janë të shurdhët dhe të heshtur, gjë që prodhon një mjedis joproduktiv. Një mjedis i tillë sigurisht është i vështirë për këdo dhe aq më tepër për audituesin e brendshëm. Chambers (2014) thekson se aty ku drejtuesit janë të paafte ose jo të gatshëm, mundësia që audituesi i brendshëm të ndryshojë diçka është e kufizuar. Për këtë autor një gjë është e qartë që si auditues të brendshëm: "Ne nuk mund dhe nuk duhet të përpiqemi të bashkëekzistojmë në një mjedis që i

mungon fryma e duhur e drejtimit të lartë. Nëse ekziston një gjendje e tillë, përparësia jonë duhet të jetë të punojmë pa u lodhur për të edukuar dhe ndihmuar drejtimin dhe bordet që ta kthejnë anijen në drejtimin e duhur.... . Për disa, mjedisi i punës mund jetë ai ku ne të ballafaqohemi me vështirësi të panumërta. Për disa të tjerë, ndoshta ne duhet të largohemi."

Ky fenomen, që në gjuhën shqipe "pagëzohet" më së miri me termin "shurdhëri", merr një formë të drejtpërdrejtë me mos ndërtimin nga ana e drejtuesve të mekanizmit të pranimi të rrezikut në organizatë. Standardi 2600 përcakton qartësisht detyrimin që ka drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm për të raportuar në nivele të larta të drejtimit nëse rreziku i mbetur i pranuar nga drejtimi është në nivele të papranueshme për audituesit. Interpretimi i këtij standardi konkludon se nuk është përgjegjësi e drejtuesit të auditimit të brendshëm të zgjidhë çështjen e rrezikut. Në fakt kjo përgjegjësi i takon drejtimit. Por nëse drejtimi nuk shprehet, nuk komunikon, nuk ndërton ndonjë mekanizëm për pranimin e tij, atëherë efektiviteti i auditimit të brendshëm dëmtohet së tepërmi.

Auditimi i brendshëm në Shqipëri, veçanërisht në sektorin publik, po përballet me nevojën për të "zgjeruar portofolin e objekteve të auditimit", duke e shtrirë në aspektet e kulturës, etikës, frymës së drejtimit dhe në përgjithësi drejt kontroleve të buta. Është proces i vështirë dhe ndoshta do të shoqërohet edhe me ndeshje të forta, sidomos në kushtet kur ende

është e përhapur gjerësisht kultura e mosndëshkueshmërisë dhe shurdhërisë. Por ky zhvillim nuk mund të shmanget. Skandalet e ndodhura në institucionet e vendit duhet të shërbejnë si argumente të forta mbështetëse për të zgjeruar objektin e auditimit. Në këtë aspekt Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të luajë një rol të rëndësishëm duke nxitur auditimin e brendshëm në institucione të përfshihet më tepër në auditimin e qeverisjes, si dhe duke evidentuar e mbështetur pavarësinë e auditimit të brendshëm. Ndërsa vetë audituesit e brendshëm kanë interes të drejtpërdrejtë të zhvillojnë aftësitë për të audituar qeverisjen, etikën, kulturën etj., sepse në fund të fundit kanë detyrimin të mbrojnë reputacionin e profesionit.

Literatura

Allsup, L., Beth, M., Hollis, N., Lantrip, S., & Smith, S., "Soft controls: A Dallas / Fort Worth Perspective", the 1998-1999 Research Project conducted by the Dallas Chapter of the IIA Research Project Committee, as in section III, a. <http://www.dallasiaa.org/ResearchCom m/98-99.pdf>.

Bruinsma C., & Wemmenhove P., (2009), "Tone at the Top is Vital!", <http://www.isaca.org/Journal/Past-Issues/2009/Volume-3/Pages/Tone-at-the-Top-Is-Vital1.aspx>
 Buhariwalla, A. (2006), "The softer side of controls: a people-focused approach to controls doesn't mean the organization is going easy on risks", Internal Auditor, October 1.

Chambers R., (22 September 2014), "Internal Auditing in a Tone-deaf

Environment", <https://iaonline.theiia.org/internal-auditing-in-a-tone-deaf-environment>.

Chambers R., (29 July 2014), "Auditing the Organizational Culture: A New Frontier for Internal Audit", <https://iaonline.theiia.org/auditing-the-organizational-culture#>.

Erkens, D., Hung, M., & Matos, P. (September 2010), "Corporate Governance in the 2007-2008 Financial Crisis: Evidence from Financial Institutions Worldwide", <http://ssrn.com/abstract=1397685>.

IIA (June 2014), "Sustaining an Ethical Culture", Tone at the Top, Nr. 68.

IIA (November 2003), "Controls are Everybody's Business", Tone at the Top, Nr. 20.

IIA (në fuqi 1 janar 2013), "International standards for the professional practice of internal auditing (standards)", <https://na.theiia.org/standards-guidance/Public%20Documents/IPPF%202013%20English.pdf>.

Jackson, R. A., (1 April 2013), "By the Book", <https://iaonline.theiia.org/by-the-book#>.

Mitchell, M.B. (2008), "Understanding the importance of soft controls in improving operations", Nov. 12, "Soft controls: What you need to know", <http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=4&ved=0CC8QFjAD&url=http%3A%2F%2Fwww.aug-olympia.org%2Fattachments%2F111208>

MITCHELL11-12-08.ppt&ei=ukCyTpyNAYTd8QPypdSFCA&usg=AFQjCNGV5KBbHpaTVv7WZtZcYkqTJxhojA&sig2=2topU6nvBv3i9NANzHvBQQ; June 26,
<http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CBoQFjAA&url=http%3A%2F%2Fwww.nysica.com%2Fpowerpoint%2Fsoftcontrols%28mitchell%292008.ppt&ei=ukCyTpyNAYTd8QPypdSFCA&usg=AFQjCNFfbLZi8OPPIYKJlcO4-AdpJSbuow&sig2=M1ajlaccVLfGC3pdooV6lg>; (2006), "Understanding and evaluating soft controls", Sept. 18,
http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=2&ved=0CCEQFjAB&url=http%3A%2F%2Fwww.nysica.com%2Fconference%2Fsoft-controls%28mitchell%29.ppt&ei=ukCyTpyNAYTd8QPypdSFCA&usg=AFQjCNHhNZdukTrakXfRtjuCWRQ64T_3Q&sig2=0sqdKoogPkU_e5yOGXW7mA

Piper A., (October 10, 2014), "Auditing in a Post-crisis World",

<https://iaonline.theiia.org/auditing-in-a-post-crisis-world>
PWC, (2012), "Tone from the Top. Transforming words into action",
http://www.ibe.org.uk/userimages/pwc_tone_from_the_top_2013.pdf.

Ratley J., & Snell R., (26 November 2014), "Fraud at the Top",
<https://iaonline.theiia.org/fraud-at-the-top>.

Roth, J. (2010), "Best Practices: Evaluating the Corporate Culture", the IIA Research Foundation.

Roth, J. (2009), "Soft controls in the Netherlands: more recognized than anywhere else", Audit magazine, Number 4, December.

Teuta Baleta

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

AUDITIMI I INTEGRITETIT: RISI DHE DREJTIM QENDROR I AUDITIMIT NË KLSH

Integriteti nuk është një koncept i thjeshtë për t'u përcaktuar. Shumë përkufizime mbivendosen dhe përcaktime të dallueshme përdoren. Termi rrjedh nga latinishtja “in-tangere”, që do të thotë “i paprekur”. Ai i referohet virtytit, moskorrupsionit dhe gjendjes se të qenit i papërlyer.

**Nga: Bajram Lamaj,
Fatos Çoçoli**

Abstrakt

Integriteti nuk është një koncept i thjeshtë për t'u përcaktuar. Shumë përkufizime mbivendosen dhe përcaktime të dallueshme përdoren. Termi rrjedh nga latinishtja “in-tangere”, që do të thotë “i paprekur”. Ai i referohet virtytit, moskorrupsionit dhe gjendjes se të qenit i papërlyer. Integriteti është i lidhur ngushtë me mungesën e mashtrimit dhe korrupsionit, por ai gjithashtu përfshin mirësjelljen e zakonshme. Në këtë kontekst, ai është një koncept pozitiv dhe i gjerë në lidhje me etikën dhe kulturën. Paketa SAINT e Gjykatës Holandeze të Auditimit përdor një përkufizim të gjerë dhe pozitiv të integritetit.

Po çfarë është kuadri i integritetit? Sipas Guilherme d'Oliveira Martins,

President i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe Kryetar i Task Forcës së EUROSAT-t për Auditimin dhe Etikën, në parathënien e botimit të EUROSAT-t, “Mbështetja e SAI-ve për të ngritur infrastrukturën e tyre etike”, “Përvojat e SAI-ve për integritetin ishin të grumbulluara dhe të analizuara rreth elementëve kyç të një Infrastrukture etike (kuadri i integritetit), dhe gjithashtu rreth kontrolleve të forta dhe të buta që ndikojnë sjelljen etike: politikat e qarta dhe koherente, angazhimi nga lidhshëmi, deklaratat e vlerave, të tilla si kodet e etikës/sjelljes, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, duke përfshirë arsimin dhe trajnimin, caktimi i përgjegjësive të etikës, mekanizmat për të parandaluar konfliktin e interesave dhe shkeljeve të tjera të sjelljes etike dhe mjeteve të brendshme dhe të jashtme vlerësuese. Këto anë elemente thelbësore të një kuadri dhe mjedisi etik që favorizojnë sjelljen etike në SAI”.

Sipas Nismës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI), "Sjellja etike e SAI-t dhe e punonjësve të tij përbëjnë gurin e themelit për një funksionim të mirë të SAI-t. Që një SAI të udhëheqë sipas shembullit dhe të sjellë vlera dhe dobi tek qytetarët, nuk mjafton vetëm që të miratojë kodin e duhur të etikës, por gjithashtu të vendosë zbatimin me rigorozitet të tij dhe të ketë një kuadër rregullator, i cili ti detyrojë punonjësit të zbatojnë etikën në praktikë".

KLSH ka përkthyer në gjuhën shqipe dhe botuar një përmbledhje të dy broshurave: "Menaxhimi i Etikës në Institucionet Supreme të Auditimit" dhe "Auditimi i Etikës në Institucionet e Sektorit Publik", të përgatitura nga Task Forca e EUROSAT-t për Auditimin e etikës.

Fjalë kyçe: Auditimi i integritetit, kuadri i integritetit, etika, INTOSAIN, politika e integritetit, integriteti i bazuar, parandalimi i korrupsionit, konflikt i interesave, kontrolli për të zvogëluar riskun e korrupsionit.

Hyrje

Integriteti do të thotë më shumë se thjesht të respektohet rregullat dhe ligjet. Ligji parashikon një limit më të ulët dhe një pikë morale minimale fillestare. Një politikë e integritetit bën thirrje për një kombinim të ndalimit të korrupsionit e mashtrimit, si dhe për parandalimin e tyre. Nga njëra anë, një organizatë duhet të miratojë masa për të marrë njohuri dhe informacion, nëse stafi i saj vepron në mënyrë të papërshtatshme (ndalimi). Nga ana tjetër, ajo duhet të bëjë ç'është e mundur për të hequr tundimet që

mund të nxisin nëpunësit civilë për të vepruar në mënyrë të papërshtatshme (parandalimi). Prioritet duhet t'i jepet parandalimit. Jo vetëm se është më efektive, por në bilancin e investimeve, është shumë herë më e vogël puna parandaluese, se sa kostoja e riparimit të dëmit të shkaktuar nga sjellja e papërshtatshme (shkelje e rregullave të etikës, konflikt i interesit, mashtrim, korrupsion, etj.).

Faza e kryerjes së auditimit të integritetit

Faza e kryerjes së auditimit të integritetit fillon me fundin e fazës së planifikimit dhe fillimin e punës në terren. Detyra e parë që audituesit duhet të kryejnë është të shkruajnë një program auditimi të përshtatur për objektivat e auditimit të integritetit dhe luftës kundër korrupsionit. Ata do të ndjekin procedura standarde për zhvillimin e programit të auditimit. Për qëllimin e fokusuar në mundësitë e rritjes së integritetit dhe uljes së korrupsionit, auditimi do të trajtojë dy çështje kryesore:

- ☐ Çështje të përgjithshme që lidhen me funksionet e përbashkëta në shumicën e organizatës ose njësisë publike;

- ☐ Çështje specifike që lidhen me operacionet e specializuara të organizatës ose njësisë publike;

Çështjet e përgjithshme

Për ta fokusuar auditimin në zbulimin e mundësive për korrupsion, audituesit duhet të ndërtojnë programin e auditimit duke ndjekur dhe respektuar parimet e përgjithshme

- ☐ Transparencën

- ☐ Mirëqeverisjen

- ☐ Ekonomicitetin
- ☐ Eficiencën
- ☐ Efektivitetin

Çështjet e përgjithshme do të kenë të bëjnë me funksione të përbashkëta, si administratat e përgjithshme, prokurimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore të organizatës, kontrollin e brendshëm, etj.

Çështjet specifike

Çështjet specifike do të lidhen me operacionet teknike ose të specializuara të njësisë apo institucionit që auditohet. Për shembull, këto çështje do të lidhen për të rishikuar ligjet dhe rregullat e veçanta që kanë të bëjnë me punën teknike të njësisë, të tilla si Ligji i Tatimit mbi të ardhurat, Ligji Doganor, si dhe ligje, rregulla dhe procedurat të tjera.

Duke konfirmuar të kuptuarit e problemit në institucionin që auditon... Me inventarin e mundësive për korrupsion, të zhvilluar në fazën e planifikimit dhe listën e shkurtuar të këtyre mundësive kryesore, audituesit duhet të fillojnë punën në terren për konfirmimin apo verifikimin e të kuptuarit të mundësive të përzgjedhura për korrupsion dhe shkelje të integritetit të organizatës, duke tërhequr në mënyrë sistematike mostra evidencash. Kjo punë do të kërkojë diskutime rutinë me stafin e organizatës dhe intervista me zyrtarët e përfshirë në rastet e ekzaminuara.

Audituesit do të verifikojë nëse kontrollet e pretenduara që janë kryer kanë ndodhur realisht dhe a janë kryer gjatë gjithë periudhës që auditohet.

Puna në terren mund të bëje fije-fije fushat e konsensusit të përgjithshëm

dhe të zbulojë fushat e mosmarrëveshjeve. Audituesit duhet të analizojnë me kujdes këto dy lloj zonash.

Në përgjithësi, zonat ku ekziston një konsensus mes menaxhimit dhe stafit për mundësinë e korrupsionit, duhet të përbëjë shqetësimin primar të audituesve. Kjo do t'ju ofrojë atyre një listë të mundësive të konfirmuara për korrupsion dhe shkelje integriteti në organizatë, edhe pse ata nuk do të kenë dëshmi nëse korrupsioni ka ndodhur dhe kush është i përfshirë. Kjo është zona e hetimit dhe del jashtë përgjegjësisë së audituesve.

Vrojtmet publike

Natyra e auditimit të integritetit dhe uljes së korrupsionit kërkon që Audituesit të dalin nga qasja e tyre tradicionale dhe të përshtatin teknika të reja. Pikëpamja tradicionale që Audituesit duhet të mbeten të kufizuar në të dhënat e brendshme dhe nuk duhet të provojnë të mbledhin informacion nga jashtë, nuk përshtatet mirë me konceptin e auditimit të Integritetit dhe uljes së korrupsionit.

Audituesit duhet të mbledhin informacione të përgjithshme publike, nga përdoruesit e shërbimeve publike dhe të atyre që ofron institucioni që po auditohet, nëse është e nevojshme. Një nga hapat në terren të auditimit, mund të jetë vrojtimi i opinionit të publikut të gjerë mbi punën dhe shërbimet e organizatës publike që auditohet, si dhe vrojtimi i mendimeve të të punësuarve në organizatë. Audituesit duhet të ndërmarrin kryerjen e këtyre vrojtimit nën dritën e vendimeve të tyre të planifikimit. Në përgjithësi, një vendim për të kryer një vrojtım publik duhet të

konsiderohet në të gjitha ato raste ku organizata që auditohet ofron ose ka ofruar ndonjë shërbim për qytetarët dhe publikun e gjerë. Një vrojtim i opinioneve të publikut të gjerë apo përdoruesve të shërbimit publik, mund të demaskojë praktikat korruptive nëse ato kryhen, sepse shumë njerëz do të donin të ngrinin zërin e tyre në shenjë proteste, në rast se ata kontaktohen dhe janë të pakënaqur me shërbimin publik të ofruar.

Vrojtimi i punonjësve

Një tjetër mundësi në këtë fazë të punës në terren është kryerja e një vrojtimi apo pyetësori tek punonjësit e organizatës. Një vrojtim i tillë do të ishte i përshtatshëm në rast se madhësia e organizatës është e konsiderueshme dhe/ose e shtrirë në filiale në zona të ndryshme të vendit. Ky vrojtim duhet të kryhet konfidencial, dhe anonim, pasi punonjësit kanë një tendencë të mos flasin për rastet e shkeljes së integritetit, konfliktit të interesave dhe për kolegët dhe (akoma më shumë) menaxherët e korruptuar. Prandaj, pyetësori duhet të shprehet në një gjuhë të tillë, që t'u japë mundësinë punonjësve të flasin për fenomenet korruptive në organizatë, pa përmendur askënd (me përjashtim të rasteve, kuptohet, kur ata vetë duan të përmendim emra). Vrojtimi mund të përmbajë pyetje të cilat testojnë gjendjen nisur nga përgjigjet e dhëna më parë. Duhet të përjashtohen pyetjet provokuese që mund të detyrojnë të anketuarin të japë përgjigje të rreme. Vrojtimi mund të kryhet edhe nëpërmjet e-mail me secilin nga punonjësit.

Dizenjimi i një pyetësori publik për auditimin e integritetit

Audituesit mund të vendosin për të kryer një vrojtim të qytetarëve për vlerësimin e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve të ofruara nga agjencia apo institucioni publik që auditohet. Ata duhet të përdorin planin e ofrimit të shërbimeve si pikë referimi të tyre, dhe pastaj të mbledhin të dhëna për treguesit e mëposhtëm. Treguesit përdoren për të krahasuar shkallën e arritjes së rezultateve, në krahasim me planin e organizatës. Këto udhëzime janë për anketat në shkallë të vogël, rreth shërbimeve të ofruara nga një organizatë në një zonë të caktuar. Për sondazhe në shkallë të madhe, që duhet të shpërndahen në zona të gjera në të gjithë vendin, sondazhi do të kërkojë aftësi më të larta teknike për hartimin e pyetësorit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Treguesit e mëposhtëm do të mbeten të rëndësishëm, por duhet të modifikohen në mënyrë të konsiderueshme, sipas madhësisë së pyetësorit apo vrojtim.

Pyetësori për plotësimin e kërkesave të përdoruesve publikë të shërbimit

Treguesit e përfshirë

1. Ndërgjegjësimi i të anketuarit lidhur me:

Objektivat

Mbulimin

Qëllimi dhe përfitimet e pritura, si dhe kosto e shërbimit të ofruar nga agjencia apo institucioni publik që po auditohet

Inputet, kostot dhe burimet e përdorura

2. Sasitë e shpërndara (outputet)

3. Cilësia e shërbimit

4. Koha e pritjes për nisjen e shërbimit
5. Përshtatshmëria e shërbimit të dhënë në lidhje me:

A është i saktë ky shërbim
Periodiciteti i dhënies së shërbimit
Koha
Rregullshmeria
Nevojat e përfituesve

6. Pëlqimi i plotë i përdoruesve me dhënien e shërbimit

7. Koha e përgjigjes publike, në rast të një shërbimi difektoz apo dështimi në dhënien e shërbimit

8. Sjellja e zyrtarëve që e ofrojnë shërbimin

9. Perceptimi i përfituesve në lidhje me korrupsionin në agjencinë apo institucionin që jep shërbimin

10. Bakshishet e paguara për ta marre shërbimin

11. Bakshishet e paguara për mirëmbajtjen e shërbimit.

Raportimi i Rezultateve të Auditimit të Integritetit dhe uljes së Korrupsionit
Rezultatet e raportimit të auditimit të Integritetit dhe uljes së korrupsionit do të ndjekin formën e zakonshme të raportimeve të auditimit.

Megjithatë, fokusi i raportimit do të jenë rekomandimet për të mbushur boshllëqet në operacionet, sistemet, procedurat, rregullat dhe rregulloret e organizatës së audituar, që mund të ofrojnë mundësitë për korrupsion. Raporti i auditimit nuk duhet dhe nuk mund të tregojë gishtin për çdo person të veçantë me akuza për korrupsion. Roli i raportit të auditimit është kryesisht për të parandaluar korrupsionin, apo për të sugjeruar masa

për minimizimin e mundësive për korrupsion.

KLSH dhe auditimi i integritetit

Të gjitha njësitë publike janë duke u bërë gjithnjë e më të vetëdijshme për faktin se pa identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të korrupsionit, nga të cilat gjenden të kërcënuara, ata nuk mund të arrijnë qëllimet e tyre në mënyrë efektive dhe të kryejnë detyrat e tyre, për një qeverisje të mirë. Duke e parë treguesin e përhapjes së "të menduarit në drejtim të rreziqeve", si dhe rritjen e numrit të mendimeve, opinionëve apo dhe strategjive të publikuara që kanë të bëjnë me forcimin e integritetit në administratën publike dhe nevojën e zhvillimit të kulturës organizative dhe për rëndësinë e luftimit të korrupsionit, në kuadrin e reformimit të KLSH- it dhe qasjeve të metodave të reja të auditimit, po vlerësohet që dhe KLSH si institucioni më i lartë i auditimit, të kryejë një auditim(pilot ndoshta në formë anketimi) për integritetin në një ose dy njësi vendore apo institucione qendrore që përballen me rrezikun e korrupsionit.

Fryma e integritetit është e pranishme në të gjitha auditimet që ne kryejmë. Po punojmë si institucion suprem auditimi, që të strukturojmë rregullat dhe kërkesat e integritetit, për të ndihmuar institucionet publike që auditojmë, që ta ngrenë stekën në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve, duke zbatuar rreptësisht normat e etikës institucionale.

Ky auditim do të kryhet në të ardhmen e afërt, duke u mbështetur në përvojën e marrë në trajnimin e zhvilluar nga

Zyra e Auditimit Shtetëror të Hungarisë në Budapest, ku një grup audituesish të KLSH janë trajnuar për këtë lloj auditimi. Puna do kryhet me metoda bashkëkohore, duke u mbështetur tek përgjigjet e marra, ku ne mund të përcaktojmë se paralel me rritjen e kompleksitetit të detyrave të grupeve të ndryshme të institucioneve, niveli i rreziqeve të korrupsionit është gjithashtu në rritje.

KLSH po përgatit audituesit e vet dhe me bazën e plotë teorike dhe praktike për realizimin e auditimit të integritetit. Bazuar në Deklaratën e Limës (ISSAI 1), në ISSAI 12 "Vlera dhe përfitimet e SAI-ve: të bësh diferencën në jetët e qytetarëve", në ISSAI 20 "Parimet e Transparencës dhe të Llogaridhenies", në ISSAI 21 "Parimet e Transparencës dhe të Llogaridhenies dhe Praktikën e Mira" dhe në ISSAI 30 "Kodi i Etikës", institucioni ka përkthyer dhe përgatitur botimin "Forcimi i infrastrukturës etike në Institucionet Supreme të Auditimit dhe Auditimi i Etikës në sektorin publik".

Ky botim përmbledh katër broshura të EUROSAT-i, të përgatitura nga Grupit i Punës (Task Force) i tij për Auditimin dhe Etikën, me synim reflektimin e aktiviteteve të Grupit, si Seminari mbi sfidat e auditimit të Etikës, i zhvilluar në shtator 2013 në Luksemburg, Takimi i Katërt i Grupit në janar 2014 në Lisbonë, Portugali, me 32 SAI evropiane pjesëmarrëse në një anketim lidhur me etikën e SAI-eve, si dhe Takimi i Pestë i zhvilluar në Polana Brasov, Rumania për diskutimin dhe miratimin e dy dokumenteve themelore të këtij auditimi. Botimi i sjell këto dy dokumente në formën e katër

broshurave, që i lidh filli logjik i identifikimit të tendencave kryesore, qasjeve dhe pikave të forta në auditimin e Etikës, si për vetë SAI-n, ashtu dhe për institucionet publike që auditohen prej tij.

Gjithashtu, mund të thuhet se sot në aktualitetin shqiptar, vërejmë se kemi një korrelacion të qartë në mes të normës së rreziqeve tipike të një grupi të caktuar të institucioneve dhe nivelin e kontrollit të ngritur në menaxhimin e këtyre rreziqeve. Synimi i auditimit të integritetit do të nxjerrë në pah arritjet që janë bërë në fushat e trajnimit kundër korrupsionit, rregullimi i çështjes së konfliktit të interesave dhe rregullimit mbi kushtet e pranimit të dhuratave, ftesave, etj. Nga marrja e masave të veçanta anti-korrupsion, do të kërkohet përparim i rëndësishëm në të ardhmen në lidhje me masat e veçanta anti-korrupsion, të cilat mund të përdoren për të rritur rezistencën e njësive publike të sektorit publik kundër rreziqeve të korrupsionit. Mundësia e ndryshimit të kulturës së caktuar nga implementimi i projekteve të veçanta për Integritetin, do të sjellë një funksionim më efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësi të ndryshme publike, ose më saktë nga efektiviteti dhe efikasiteti i menaxhimit të rreziqeve që vijnë në këto sisteme. Nga auditimi do të përcaktohen pikat më të prekshme të rreziqeve të sektorit publik dhe do të hedhim dritë mbi përshtatshmërinë e niveleve të kontrolleve me qëllim menaxhimin e rreziqeve. Kështu që do të rrisim ndërgjegjësimin e sektorit publik, Institucioneve, si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj rreziqeve, të cilat mund të

provojnë se janë një bazë për një kulturë të re të administratës publike.

Auditimet pilot

Në zbatimin e këtij projekti (auditimi pilot) për Integritetin, qëllimi është që të vlerësojmë ekspozimin e institucioneve të sektorit publik përballë rreziqeve të korrupsionit, si dhe niveli i kontrolleve që shërbejnë për të zvogëluar rreziqet e tilla dhe promovimin e zbatimit praktik të qasjes së integritetit si qëllim prioritar. Pra promovimi i qasjes së integritetit, lufta kundër korrupsionit në bazë të parandalimit dhe të menduarit në drejtim të rreziqeve, supozimi fillestar është se në çdo rast, statusi ligjor dhe fusha e përgjegjësisë të institucioneve të dhëna, shërbejnë si bazë për përcaktimin e aktiviteteve që ushtron pushteti ekzekutiv ose në shërbimet publike që kryhen (prokurimet, sipërmarrje të ndryshme, koncesionet, etj), ku kërcënimi i korrupsionit është i pranishëm. Megjithatë, nga shumë institucione integriteti është vlerësuar si pjesë e rëndësishme e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm (MFKB), nga auditimi do të synohet se lufta kundër korrupsionit dhe promovimi i një kulture administrative që favorizon funksionimin organizativ në përputhje me kriteret e integritetit do të trajtohen si “Objektivat e një rëndësie strategjike”. Nga ky aspekt, kjo do të jetë një përvojë shumë e rëndësishme që institucionet buxhetore dhe publike, të bëhen të vetëdijshëm për kërcënimin e rrezikut të korrupsionit dhe si rezultat, ata do të tregojnë më shumë vëmendje për të parandaluar këto rreziqe dhe nevojën për krijimin

dhe funksionimin e kontrolleve që përforcojnë integritetin.

Në Shqipëri megjithatë kemi literaturë, kemi studime për integritetin nga OJF të ndryshme, ka ardhur koha që organet e pushtetit ekzekutiv të kontribuojnë në zhvillimin e një integritety based (Integritet i bazuar) të quajtur “Kultura e administratës publike”. Krijimi i saj do të identifikojë rreziqet midis institucioneve të ekzaminuara që mund të dëmtojnë integritetin e këtyre institucioneve dhe pikënisjen për punën që duhet të bëjnë në fushën e menaxhimit të rrezikut të korrupsionit. Gjithashtu përvojën që do të nxirret nga ky auditim integriteti, KLSH do ta përcjellë në organet e pushtetit vendor dhe qeverisjes qendrore si dhe në institucionet e tjera të pavarura apo OJF që kanë interes në shfrytëzimin e këtyre materialeve në aktivitetet e tyre kundër korrupsionit.

Harta me karakteristikat e mjedisit ligjor/institucional të institucioneve buxhetore, parashikueshmëria dhe stabiliteti i funksionimit të tyre, si dhe ndryshueshmëria e këtyre faktorëve të ndikuar nga Vendimet e marra nga drejtuesit aktualë gjatë funksionimit të institucioneve, duhet të jenë në përputhje me qëllimet strategjike, krijimin e një strukture dhe kulture organizative, si dhe me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe buxhetore. Ekzistenca e kontrolleve reflekton nëse njësia publike ka kryer kontrolle në vend, dhe nëse këto kontrolle vërtetë përmbushin objektivat e tyre. Në këtë vlerësim, përfshihen faktorë të tillë si rregullorja e brendshme e njësisë publike, ka pasur auditim të jashtëm

dhe të brendshëm, si dhe kontrollet e tjera për integritetin, ku përfshihen: përcaktimi i kërkesave etike, menaxhimi i situatave që përfshijnë konfliktet e interesit, nepotizëm, trajtimin objektiv të raporteve dhe ankesat, analiza e rregullt e rrezikut të korrupsionit dhe menaxhimi i vetëdijshëm strategjik.

Ne kategorizimin e kontrolleve që kryhen, janë përcaktuar në mënyrë të detyrueshme në statutet si kontrollet “e buta”, të cilat përfshijnë zonat që lidhen me etikën apo menaxhimin e burimeve njerëzore. Në këtu kontrolle, ekzistojnë elemente të tjera “të buta”, në synimin e nxjerrjes së rreziqeve të korrupsionit, ku më i rëndësishmi është kodi i etikës, me të cilin institucionet rregullojnë marrëdhëniet me aktorët e jashtëm dhe të brendshëm dhe përqendrohet në përmirësimin dhe rritjen e kulturës organizative.

Auditimet që kryhen për integritetin mund të masin dhe të identifikojnë sukseset dhe dështimet, të cilat vijnë nga zbatimi i programeve të reformës dhe kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara në drejtim të rritjes së integritetit të nënpunësve publikë dhe administratës tonë publike për një sjellje etike dhe me integritet.

Integriteti është gur themeli për mirëqeverisjen, si dhe parakusht i legjitimitetit të veprimeve të një qeverie, (Integrity Framework, OECD), prandaj instalimi i një kulture administrative mbi integritetin me të gjithë komponentët e saj përbërës, do të sjellë rritjen e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe shoqërisë tonë mbi këtë çështje të rëndësishme

dhe nevojën e auditimeve dhe vlerësimeve profesionale si nga KLSH, por dhe nga organizatat e tjera joqeveritare që merren me luftën antikorrupsion. Pikërisht procesi i institucionalizimit të tij dhe ngritja e sistemeve efikase të kontrollit të brendshëm, është kërkesë me prioritet të lartë dhe e vazhdueshme. Individit i korruptuar nuk është “molla e vetme e keqe” dhe heqja e tij nuk do ta shpëtojë sistemin. Duhet trajtuar komplet sistemi, ose përndryshe personi që zëvendëson “mollën e keqe” do të jetë subjekt i të njëjtave nxitje. Parandalimi mund të jetë më efektiv dhe shumë më ekonomik se sa hetimi apo përndjekja (Jeremy Pope, Transparenca Ndërkombëtare). Monitorimi kërkon matje efektive dhe matja më e mirë bëhet nëpërmjet auditimeve, kontrolleve dhe vetëvlerësimeve që kryhen nga vetë institucionet, duke evidentuar praktikën më të mira, ndërsa në ato më pak dhe ndoshta më të korruptuarat, mund të identifikohen edhe hapat që mund të merren për të rregulluar performancën e tyre.

Detyra për të arritur reforma të qëndrueshme anti-korrupsion në vendin tonë, do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Që pengesat do të jenë të shumta, kjo nuk diskutohet, por tani për tani, koha në të cilën ne mund të kemi një impakt domethënës në këtë fenomen, është akoma e pasigurtë. Nga njëra anë, mund të ndodhë që njerëzit të mos kenë më besim në praktikën demokratike dhe t'i kthehen autoritarizmit, si reaksion logjik ndaj dështimit të metodave demokratike. Sigurisht, nuk ka arsye të supozohet se një cikël tjetër i autokracisë do të jetë

më pak shkatërrimtar se sa në të kaluarën, prandaj është detyrë e çdo institucioni shtetëror, atyre të pavaruara, OJF dhe organizmave ndërkombëtare që merren me luftën anti korrupsion që mos të dobësojnë punën e tyre, por ta rrisin atë dhe shfrytëzojnë oportunitetet që kanë për të përballuar korrupsionin në mënyrë efektive, shanset nuk do të vijnë më. Korrupsioni do të minojë vazhdimisht demokracinë e brishtë në Shqipëri dhe do të vazhdojë të ketë një impakt negativ në të drejtat njerëzore, në mjedis dhe në të gjithë aspektet e shoqërisë tonë.

Sigurisht një program reforme “ Sistemi i Integritet Kombëtar”, mund të vendosë një reformë progresive, por kjo duhet të koordinohet dhe brenda kufijve të një programi holistik, që përqafon zonat më të rëndësishme dhe ndërveprimin e tyre me të tjerët.

Mbrapa vlerësimit të sistemit të integritetit, qëndron bindja se të gjitha çështjet e shqetësimit aktual në fushën e qeverisjes dhe zhvillimit të kapaciteteve, orientimit të rezultateve, pjesëmarrja publike dhe nxitja e integritetit kombëtar, duhet të trajtohen në një pamje shumë të gjerë, ku auditimi i integritetit në njësitë publike do të japë një kontribut të rëndësishëm në luftën antikorrupsion.

Konkluzione dhe rekomandime

1.Detyra për të arritur reforma të qëndrueshme për instalimin e integritetit dhe etikës dhe uljen e korrupsionit në administratën publike në vendin tonë, do të jetë e gjatë dhe e vështirë;

2. Korrupsioni do të minojë vazhdimisht demokracinë e brishtë në Shqipëri dhe do të vazhdojë të ketë një impakt negativ në ofrimin e shërbimeve publike, në të drejtat njerëzore dhe në mjedis;

3. Parandalimi i korrupsionit mund të jetë më efektiv dhe shumë më ekonomik se sa hetimi apo përndjekja e tij;

4.Integriteti është gur themeli për mirëqeverisjen, si dhe parakusht i legjitimitetit të veprimeve të një qeverie;

5.Një program reforme “ Sistemi i Integritetit Kombëtar”, mund të vendosë një reformë progresive, por kjo duhet të koordinohet dhe brenda kufijve të një programi holistik, që përqafon zonat më të rëndësishme dhe ndërveprimin e tyre me të tjerët.

6.Organet e pushtetit ekzekutiv të kontribuojnë në zhvillimin e një qasjeje “integrity based (Integritet i bazuar) të quajtur “Kultura e administratës publike”. Krijimi i saj do të identifikojë rreziqet midis institucioneve të ekzaminuara që mund të dëmtojnë integritetin e këtyre institucioneve dhe pikënisjen për punën që duhet të bëjnë në fushën e menaxhimit të rrezikut të korrupsionit.

Literatura e konsultuar:

1.Guilherme d’Oliveira Martins, parathënie në botimin e Task Forcës së EUROSAT-it për Auditimin e Etikes: “Mbështetja e SAT-ve për të ngritur infrastrukturën e tyre etike”, Mars 2014

2.Iniciativa për Zhvillim të INTOSAT-it (IDI): “Etika në SAT”, nga botimi i Task Forcës së EUROSAT-it për Auditimin e

Etikes: “Auditimi i Etikes ne Sektorin Publik”, Maj 2014

3. Transparency International. “Praktika te mira per te strukturuar institucionet e auditimit suprem”, 14 Mars 2013, http://www.transparency.org/whatwedo/answer/good_practice_for_structuring_supreme_audit_institutions

4. Qendra Burimore e Antikorrupsionit “U4”: “Roli i institucioneve supreme te auditimit ne luften kunder korrupsionit”, 1 janar 2008, <file:///E:/Documents%20and%20Settings/tosi/My%20Documents/Downloads/expert-helpdesk-203.pdf>

5. “Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik”, Botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit në gjuhën shqipe.

6. Parimet bazë të INTOSAINT, Gjykata e Auditimit e Holandës, 2010, http://www.courttofaudit.nl/english/Publications/Topics/IntoSAINT/Basic_principles_of_IntoSAINT

7. Dye, Kenneth M., & Rick Staphenurst, “Shtyllat e Integritetit: Rendesia e Institucioneve supreme te Auditimit ne uljen e korrupsionit”, Ribotim, Banka Boterore, 2011.

8. Klitgaard, R., Maclean-Abaroa, R., & Parris, H.L., “Qytete te Korruptuara: : Një Udhëzues Praktik për Kurë dhe

Parandalim”, ribotim, World Bank Institute, 2007.

9. Timothy G. Kizirian, Brian W. Mayhew dhe L. Dwight Sneathen Jr. : “Impakti i Integritetit te Menaxhimit ne Planifikimin dhe Evidencen e Auditimit”, Revista “Auditimi-Nje Reviste e Praktikës dhe Evidences”, Vell. 24, Nr. 2, 2005

10. Sparberg, Detlev, “Te luftosh Korrupsionin dhe Mashtrimin”, International Journal of Government Auditing, Washington: (27:3), Korrik 2000

11. Stern, Esther, “Te Auditosh per Ndryshim Shoqeror ne kontekstin e Objektivave te Zhvillimit te Mijevjeçarit”, 2005

12. Staphenurst, Rick & Sahr J. Kpundeh, “Te frenosh korrupsionin: Drejt një Modeli për ndërtimin e Integritetit Kombetar”, Ribotim, World Bank Institute, 2009

Bajram Lamaj

Drejtor Departamenti, KLSH

Fatos Çoçoli, Ekspert i Jashtëm, KLSH

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DHE BUXHETI I SHTETIT

Sistemi demokratik shprehet përmes parlamentarizimit, si forma më e evoluar e organizimit të shtetit për t'i shërbyer sa më mirë shoqërisë. Qeveria, produkt i mazhorancës së parlamentit, përfaqson këtë vullnet. Ajo financon, përmes buxhetit, shërbimet publike në funksion të mirëqënies sociale. Kontrolli i këtij aktiviteti qeveritar nga parlamenti, e sidomos nga minoranca, kryhet përmes institucioneve të pavarura, si Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rëndësia e pavarësisë së këtij informacioni nënkupton një funksionim më të mirë të debatit politik dhe të parlamentarizimit në tërësi. Në kushtet e standartizimit të llojeve të krizave ekonomike e financiare të vendeve, janë rritur kërkesat për një unifikim të metodave audituese ndaj performancës qeveritare në drejtim të krijimit dhe përdorimit të fondeve publike, si një domosdoshëri për rritjen e mirëqënies ekonomike dhe funksionimit të demokracisë.

**Nga : Dr. Edvin Stefani dhe
Albana Agolli¹ KLSH**

Abstrakt

Ky artikull tenton të shpjegojë lidhjen mes funksionimit normal të demokracisë dhe auditimit të performancës qeveritare në drejtim të krijimit dhe përdorimit të buxhetit të shtetit. Rëndësia e këtij auditimi nga institucionet e pavarura rritet në kushtet e standartizimit të krizave financiare të vendeve në zhvillim. Auditimi i dyanshëm i buxhetit krijon

informacionin më të mirë e të pavarur nga KLSH për parlamentin.

Fjalët Kyçe; KLSH, buxhet, komisioni european, korrupsion, INCOSAI.

Funksionim i ngjashëm

Në përgjithësi, në të gjithë vendet, çdo vit parlamenti miraton burxhetin për qeverinë për periudhën një vjeçare. Ky buxhet përdoret nga qeveria dhe në fund të periudhës ajo raporton në parlament. Vërtetësia dhe rregullshmëria e zbatimit të ligjit të buxhetit, i raportohet Parlamentit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në këtë mënyrë, Parlamenti informohet nga një organ i pavarur nga qeveria mbi zbatimin e buxhetit, pra K.L.SH shfaqet si një element i rëndësishëm në ruajtjen e integritetit të sistemit. K.LSH i siguron

¹ Kumtesë e mbajtur në Konferencën e II-të Shkencore të KLSH-së, dhjetor 2013

Parlamentit një informacion dhe opinion të pavarur mbi zbatimin e buxhetit nga qeveria. Çdo vit, vendet në zhvillim dhe kudo humbasin vlera të mëdha në të ardhurat kombëtare nga praktikatat e dëmshme të taksimit. Erozioni i bazës së tatueshme dhe transferimi i çmimit, transparenca e sistemit tatimor dhe praktikatat e taksimit ishin çështjet që u diskutuan si emergjente në Task Forcën e ngritur nga Komisioni Europian në konferencën e vendeve anëtare të OSBE-së, në Seul, në Tetor 2013.

Në veprimtarinë e saj, Qeveria vepron në përputhje me legjislacionin e miratuar nga Parlamenti. Në sistemin demokratik të ndeshur në të gjithë vendet e Komunitetit Europian, parlamenti është i organizuar zakonisht në dy krahë politikë, në opionencë të njëri tjetrit. Një krah në pozitë dhe një në opozitë. Krahun në pozitë është ai që krijon qeverinë, ndërsa opozita krijon mendimin opozitar, në opionencë të qeverisë. Në këto kushte, veprimtaria e qeverisë monitorohet nga parlamenti përmes informacionit të pavarur, ku rolin kryesor e zë informacioni i dhënë nga KLSH. Njëkohësisht Qeveria organizon auditimin e saj të brendshëm, financiarisht i varur prej saj dhe në funksion të përmirësimit të punës së saj.

Qeveria luan rolin e menaxhuesit të ekonomisë duke ndikuar në zhvillimin dhe mirëqënien e shoqërisë. Realizimi i treguesve të buxhetit ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit. Kushte optimale për një zhvillim ekonomik është stabiliteti makroekonomik, borxh qeveritar në nivele të ulëta dhe inflacion një shifror. Barazimi makroekonomik:

$$Y = C + I + G + Nx$$

paraqet në një krah të ardhurat kombëtare dhe në një krah konsumatorët finalë (C – konsumi familjar, I – konsumi i biznesit privat, G – konsumi qeveritar dhe Nx konsumi nga të huajt. Roli i qeverisë është në të dy kahët e ekuacionit.

Krijimi i të ardhurave buxhetore bëhet ose përmes mbledhjes së detyrimeve tatimore, ose duke marrë borxh, ose të dyja bashkë. Të tre skenarët kanë efekte të ndryshme në ekonomi. Shërbimi i borxhit të jashtëm është një kosto që ndikon në uljen e nivelit të konsumit që bëjnë konsumatorët finalë. Në kushte të një borxhi nga jashtë, ekuacioni i mësipërm mund të transformohet në këtë mënyrë:

$$Y = C + I + G + Nx + i$$

Ku i – interesi i paguar për principalin e borxhit

Në këtë aspekt sa më i vogël borxhi dhe sa më e lartë pjesa e të ardhurave kombëtare të destinuara për konsum final.

Mënyra e krijimit të të ardhurave buxhetore ndikon në të ardhurat kombëtare. Shkenca e ekomomiksit të zhvillimit krijon një relacion të qartë midis mënyrës së mbledhjes së të ardhurave buxhetore dhe të ardhurave kombëtare (Y). Një mbledhje me një bazë sa më të gjerë, përmes normave tatimore sa më të ulëta, krijon kushte të favorshme për krijimin e të ardhurave kombëtare (Y) sa më të larta.

Gjithashtu përmes shpenzimeve buxhetore, Qeveria paraqitet si një konsumator final i rëndësishëm për prodhimin kombëtar. Në këtë mënyrë, Qeveria ndikon në të dy anët e ekuacionit si në atë të të ardhurave

kombëtarë (Y) ashtu dhe në atë të shpenzimeve kombëtare (G).

$$Y = C + I + G + Nx$$

Ndonëse një barazim i ekuacionit nuk është i nevojshëm, një mosbarazim i lartë nuk është i rekomandueshëm për zhvillimin ekonomik. Si një faktor endogjen i konsumit të brendshëm shpenzimet qeveritare G, janë pjesë e kërkesës primare finale për mallra dhe produkte. Në këtë mënyrë, shpenzimet qeveritare ndikojnë në rritjen e ciklit të prodhimit në mënyrë direkte dhe indirekte duke rritur prodhimin e brendshëm bruto. Në anën tjetër të ekuacionit, në atë të ardhurave kombëtare Y, veprimtaria e qeverisë luan një rol parësor stimulues. Duke qenë se, në të gjithë vendet e sistemit të decentralizuar ekonomik, pjesa e ekonomisë shtetërore është në një rënie të vazhdueshme në krahasim me ekonominë private, peshën kryesore të të ardhurave kombëtare e zënë të ardhurat nga biznesi privat. Adresimi përmes politikave fiskale të caktuara krijon kushtet për rritjen e iniciativës private (I), e si rezultat të rritjes së prodhimit kombëtar bruto. Në këtë aspekt, roli i SAI-ve në informimin e parlamentit për politikën e ndryshme fiskale dhe për performancën e shpenzimeve qeveritare ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik.


Probleme të njëjta

Organizata Transparency International ka publikuar Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2013, duke renditur 177 vende në bazë të niveleve të tyre të korrupsionit në sektorin publik. Në këtë listë prej 177 vendesh Shqipëria ndodhet në vend të 116. Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, si Shqipëria edhe Kosova janë më

poshtë se Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja, Serbia dhe Moldavia.

Në raportin e saj, organizata Transparency International thotë se treguesit e këtij viti janë një paralajmërim se shpërdorimi i pushtetit, marrëveshjet e fshehta dhe ryshfetet vazhdojnë t'u sjellin shkatërtime shoqërive kudo në botë. Ky nivel korrupsioni syrgjeron rritjen e rolit të auditimit të jashëm të veprimtarisë qeveritare si një informacion bazë për një parlament demokratik.

Grafiku; Indeksi i korrupsionit/PBB për frymë, Transparency International



P.B.B për frymë

te torte ane negativ mes niveit të korrupsionit dhe nivelit të Prodhimit të Brendshëm Bruto për frymë. Ky korelacion syrgjeron një rritje të rolit auditues të veprimtarisë qeveritare si një faktor direkt në zhvillimin ekonomik. Veprime të përbashkëta Kongresi i XXI i INCOSAI i mbajtur në Pekin, Kinë, në 26 Tetor 2013 cilësoi adoptimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara mbi "Promovimin e efijencies, llogaridhënies, efektivitetit

dhe transparencës së administrimit publik përmes forcimit të auditimit nga ana e SAI-ve” nën dritën e principeve të Deklaratës së Limës dhe Meksikës.

Lidhur me adoptimin e standarteve më të fundit të auditimit, fokusi ishte në tre çështje:

ISSAI 12 “Vlerat dhe dobëtë e SAI-ve – bërja e ndryshimit në jetën e qytetarëve”

Zbatimi i parimeve të auditimit në auditimin e performancës, auditimit financiar dhe të përputhshmërisë si dhe aplikimi i Udhëzuesit mbi Auditimin e ndihmave për rastet e emergjencave.

Urgjenca për të hamonizuar veprimet në rang botëror ishte një pjesë e rëndësishme e rekomandimeve të Kongresit. Globalizimi dhe standartizimi i problematikave që ndesh ekonomia botërore kërkon bashkpunimin më të ngushtë të SAI-ve me Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Në këtë aspekt parimet e auditimit të jashtëm të parashtruara në Deklaratën e Limës dhe të Meksikës si dhe në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara A/66/209 duhet të implementohen në nivel kombëtar, si kërkesë parësore për zhvillimin e qëndrueshëm të financave publike. Për zbatimin e rekomandimeve dhe konkluzioneve të Kongresit, Task Force për Krizën Globale Fianciare u konvertua në një Grup Pune mbi Reformën Rregullatore dhe të Modernizimit Financiar. Si konkluzion nxjerrim se është rritur kërkesa për harmonizim dhe aplikimin në nivel kombëtar të standaretve të auditimit. Kjo pasi kriza globale financiare nuk është më vetëm një temë debatesh nëpër konferenca ndërkombëtare, por një çështje që ka prekur të gjithë vendet e zhvilluara dhe në zhvillim.

Rritja e mardhënieve ndërkombëtare dhe globalizimi i ekonomisë ka standartizuar problematikën e ndeshur në financat publike kombëtare. Niveli i lartë i borxhit, performanca e ulët e menaxhimit financiar qeveritar janë fenomene që ndeshen rutinë në të gjithë vendet. Ky standartizim i problematikave kërkon një standartizim dhe të metodave të auditimit nga ana e SAI-ve në të gjithë vendet.

Pranë Komisionit European është ngritur Komiteti mbi Auditimin e Politikave Fiskale. Ky rrjet është themeluar në 2008 nga SAI-et e Suedisë dhe Finlandës. Qëllimi i Rjetit është përmirësimi i praktikave dhe metodologjive të auditimit të politikave fiskale kombëtare duke përdorur praktikatat më të mira dhe duke shkëmbyer informacion. Krijimi i këtij rrjeti dhe shkëmbimi i informacionit midis SAI-ve të ndryshme konsiderohet si me rëndësi të veçantë nga Komisioni European.

K.L.SH luan një rol të rëndësishëm në përdorimin e politikave të duhura fiskale dhe monetare përmes auditimit të pavarur. Një kërkesë parësore për SAI-et është, që brenda mandatit të tyre, të luajnë një rol në promovimin e zhvillimit institucional të vendit, transmetimin e informacionit mbi problematikat e ndeshura në auditim dhe shkëmbimi i eksperiencave për të rritur ndërgjegjësimin e riskut të vazhdueshëm që politikatat fiskale dhe monetare mund të aplikohen larg nga projeksioni fillestar.

Në seksionin e 20-të të Deklaratës së Limës mbi auditimin e tatimeve citohet: SAI-et duhet të kenë fuqinë që të auditojnë sa më gjerë mbledhien e

tatimeve duke egzaminuar dosjet individuale

Auditimet në tatimeve janë kryesisht të karakterit ligjor dhe të përputhshmërisë, sidoqoftë kur auditon aplikimin e ligjeve tatimore, SAI duhet të auditojë dhe eficiencën e mbledhjes së tatimeve, përmbushjen e realizimit të planit të të ardhurave tatimore.

Konkluzion

Vihet re një globalizim i krizës financiare me një standartizim të problematikës në të gjithë vendet e zhvilluara dhe në zhvillim. Problematikat kryesore sot në botë janë borxhi i lartë publik, destabilizim monetar, performancë jo e kënaqshme e qeverive në përmbushjen e objektivave makroekonomike. Globalizimi i ekonomisë e i problemeve të saj kërkon një harmonizim të masave për t'u marrë mes të gjithë vendeve. Kjo shprehet në orientimet që jep Komisioni Europian dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Si një instrument i rëndësishëm i parlamenteve demokratike, SAI të ndryshme në botë kanë për detyrë gjithashtu harmonizimin e veprimeve në nivel global. Për këtë qëllim kongresi i XXI i mbajtur në Pekin, orienton një bashkrendim të forcave mes SAI-ve në të gjithë botën. Ky bashkrendim ka si prioritet unifikimin e standarteve të auditimit, rritjen e rolit të SAI-ve për "sjelljen e ndryshimit në jetën e qytetarëve", duke audituar dhe rekomanduar qeveritë për veprimtaritë e tyre. Relacionet midis veprimtarisë së qeverisë dhe krizës financiare janë të

forta. Me veprimtarinë e saj ajo shfaqet në dy role; atë të konsumatorit final dhe atë të stimuluesit të prodhimit të brendshëm bruto. Politikat fiskale qeveritare ndikojnë drejtpërdrejtë në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e të ardhurave kombëtare. Në këtë aspekt auditimi i tyre nga SAI duke harmonizuar veprimet përbën një rol parësor në reduktimin e korrupsionit, rritjen e nivelit të performancës së qeverisë dhe rritjen e mirëqënies së shoqërisë.

Referencat

"Responding to the challenges of Supreme Audit Institutions: Can legislatures and civil society help?" by Albert van Zyl, Vivek Ramkumar and Paolo de Renzio.

"The Role of Supreme Audit Institutions on Safeguarding Long-Term Sustainability of Financial Policies" XXI INCOSAI, Theme II, "The role of Supreme Audit Institutions in fight against the consequences of financial and economic crisis: A theoretical approach", Sándor Nagy, 2012

"How Supreme Audit Institution Should Perform and is to be Managed for External Audit" Neva Maher, Slovenia.

"Beijing Declaration on promotion of Good Governance by Supreme Audit Institutions", XXI INCOSAI.

**Nga: Dr. Edvin Stefani dhe
Albana Agolli, KLSH**

AUDITIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË PROJEKTIN E INFORMATIZIMIT TË SHËNDETËSISË NË REPUBLIKËN E SLLOVENISË

Implementimi i Teknologjisë së Informacionit është mbështetje për shërbimet publike dhe funksionimi i tij është investim i rëndësishëm publik.

**Nga: Maja Hmelak,
Masa Zeleznik,
Gjykata e Auditimit e Republikës së
Sllovenisë**

Implementimi i Teknologjisë së Informacionit është mbështetje për shërbimet publike dhe funksionimi i tij është investim i rëndësishëm publik.

Rrjedhimisht, mangësitë e zbatimit dhe keqfunksionimi i këtyre Projekteve tërheqin zakonisht vëmendjen e një publiku të gjerë si dhe të mediave. Në vitin 2013, disa çështje që u hasen gjatë implementimit të Teknologjisë së Informacionit arritën të tërheqin vëmendjen e mediave në nivel global: psh në Shtetet e Bashkuara, përmirësimet në sistemin për pagesat e papunësisë në Florida, Pensilvani, Kaliforni dhe Masaçusets lanë pa pagesa me qindra e mijëra qytetarë të papunë. Sërish në Shtetet e Bashkuara, faqja e internetit në mbështetje të Akteve ligjore të Kujdesit Shëndetësor

(Affordable Care Act) nuk funksionoi në mënyrë efikase për disa muaj. Në Australi, Sistemi i Shëndetit Publik i Queensland, i cili administron sistemin shëndetësor publik, pati probleme të mëdha gjatë implementimit të listave të pagave. Për rrjedhojë mijra punëtorë u paguan më pak, më shumë ose nuk u paguan fare. Publiku pret shumë nga projektet mbështetëse të Teknologjisë së Informacionit, por nga ana tjetër edhe projektet më të mira të planifikuara mbeten të ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta dhe janë të prirura për të mos funksionuar mirë ose për të dështuar totalisht.

Ashtu si vendet e tjera, Republika e Sllovenisë ka hasur probleme me sistemin mbështetës të Teknologjisë së Informacionit ndaj shërbimeve publike. Gjykata e Auditimit e Republikës së Sllovenisë është organi më i lartë i Sllovenisë për mbikëqyrjen e llogarive shtetërore, buxhetit të shtetit dhe të gjitha shpenzimeve publike dhe për këtë ka kryer një numër auditimesh të

performancës së Teknologjisë së Informacionit. Gjykata e auditimeve i ka përqendruar këto auditime mbi efektivitetin dhe efikasitetin e Teknologjisë së Informacionit, vlerësimet e saj të pavarura dhe analizat për Teknologjinë e Informacionit kanë mbuluar fusha të ndryshme të shërbimit publik, të tilla si sistemet e tatimeve dhe doganat, shëndetit publik, politikave bujqësore dhe përfitimet sociale. Në disa raste, gjetjet e Gjykatës së Auditimeve kanë shërbyer si bazë për vendimet e marra mbi zhvillimin e ardhshëm dhe aktivitetet në shërbimin publik.

Projekti i Informatizimit të Shëndetësisë në Republikën e Sllovenisë

Dështimet e shumta të kohëve të fundit në implementimin e Teknologjisë së Informacionit, si teknologji mbështetëse në disa fusha, ishin bërë shumë të njohura për publikun, ndërkohë që një nga projektet më të mëdha të Teknologjisë së Informacionit në Slloveni u mbajt “i fshehur” për një kohë të gjatë nga publiku i gjerë. Projekti Informatizimi i Shëndetësisë i Ministrisë së Shëndetësisë kishte për qëllim modernizimin e të gjitha aspekteve të shërbimeve shëndetësore ndaj publikut me një numër të ri zgjidhjesh nëpërmjet sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Projekti synonte 1) lidhjen e mijëra klinikave që ushtrojnë aktivitetin në fushën e shëndetësisë me një rrjet komunikimi të sigurtë, 2) standardizimin dhe unifikimin e shkëmbimeve të dokumentacionit dhe të të dhënave të pacientëve, 3) hapjen (krijimin) e rrugëve të reja të komunikimit për pacientët dhe klinikat (punonjësit) e shërbimeve shëndetësore dhe 4) futjen e njohurive

të avancuara lidhur me shëndetin, bazat e të dhënave dhe mekanizmave mbështetës.

Projekti filloi zyrtarisht në vitin 2005; megjithatë, plani e projektit nuk u finalizuan deri në vitin 2009. Plani ishte për të prezantuar gradualisht zgjidhjet e Teknologjisë së Informacionit çdo vit, deri në vitin 2015. Kostoja e zhvillimit, zbatimit dhe mbështetjes fillestare për këto zgjidhje të Teknologjisë së Informacionit ishte vlerësuar 67.5 milionë euro, me një shtesë buxhetore prej 65.5 milionë Euro për mbështetjen ndaj përmirësimeve eventuale deri në fund të vitit 2023.

Deri nga mesi i 2012, projekti nuk kishte arritur asnjë nga qëllimet e vendosura. Gjykata e Auditimit vendosi të kryejë një Auditim Performance për projektin e Informatizimit të Shëndetësisë, për të identifikuar arsyet e vonësive dhe riskun potencial që projekti nuk arriti të jepte rezultatet e pritura në afatin e parashikuar.

Qasjet e Gjykatës së Auditimit:

Për të kuptuar nëse Ministria ka qenë efektive në menaxhimin e Projektit të Informatizimit të Shëndetësisë, Gjykata e Auditimit e kishte të nevojshme të realizonte një qasje konkrete për të kompensuar faktin se në kohën e auditimit, projekti nuk ishte përfunduar ende. Implementimi i Projekteve të mëdha të Teknologjisë së Informacionit, shpesh herë realizohet në përputhje me strukturat e menaxhimit të projekteve të njohura ndërkombëtarisht, të cilat mund të përdoren për të zhvilluar një qasje të auditimit të Performancës së projektit të TI në praktikë. Ministria, megjithatë, nuk kishte përdorur ndonjë standard formal në planifikimin dhe

menaxhimin e Projektit të Informatizimit të Shëndetësisë. Gjykata e Auditimit u përqendrua vetëm në katër fusha të menaxhimit të projektit: 1) Përbajtja e projektit për Informatizimin e Shëndetësisë, 2) Organizimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore të projektit, 3) Menaxhimi i afatit kohor të projektit, dhe 4) Menaxhimi i projektit financiar.

Sfidat

Përbajtja e projektit Informatizimi i Shëndetësisë kishte ndryshuar disa herë dhe të dhënat mbi këto ndryshime ishin të kufizuara. Kjo do të thotë se as qëllimi, e as rezultatet e pritshme për zgjedhjen e projektit të Teknologjisë së Informacionit nuk ishin të qarta.

Deri në fund të vitit 2012, Ministria kishte shpenzuar të paktën 8.8 milionë euro për projektin Informatizimi i Shëndetësisë. Për shkak të mungesës së transparencës, Gjykata e Auditimit shpesh herë nuk mund të lidhte në mënyrë të besueshme faktet, nëse blerjet nga Ministria të hardwara-ve, software-ve, dhe shërbimet e ndryshme, ishin realizuar në përputhje me kërkesat e veçanta të projektit, duke e bërë të vështirë përcaktimin, nëse këto blerje ishin të justifikuara.

Në një afat të gjatë kohor, projekti Informatizimi i Shëndetësisë ishte drejtuar nga disa menaxherë të projektit. Ndërkohë nuk ishin përcaktuar qartë as kompetencat e tyre dhe as kompetencat e palëve të tjera të interesuara. Në disa raste, Gjykata e Auditimit nuk ishte në gjendje për të përcaktuar se kush kishte autorizuar ndryshime të rëndësishme në lidhje me përbajtjen. Transparenca e projektit reduktohej akoma më shumë me një

dokumentacion që përditësohej në mënyrë të vazhdueshme, i paorganizuar mirë dhe që ekzistonte shpesh në disa versione që ishin të papajtueshme me njëri tjetrin. Gjetja e informacionit të besueshëm mbi ngjarjet e së kaluarës, kërkonte një punë të madhe.

Për të sjellë rregull në këtë kaos, Gjykata e Auditimit bëri një përpjekje të konsiderueshme në organizimin e informacionit të shpërndarë dhe që nuk përputhej, mbi gjendjen e projektit Informatizimi i Shëndetësisë, duke e sjellë në një panoramë të qartë dhe koncize. Dokumentacioni i pa kompletuar i projektit paraqet gjithmonë një rrezik dështimi, duke zbuluar parregullsi të rëndësishme. Për të minimizuar këtë rrezik, Gjykata e Auditimit rishqyrtoi disa qindra dokumente të ruajtura në vende të ndryshme (jo domosdoshmërisht të lidhura me projektin Informatizimi i Shëndetësisë), me shpresën për të mbledhur sa më shumë informacion që të ishte e mundur. Gjykata e Auditimit, rriti gjithashtu, numrin e të gjithë testeve në lidhje me pagesat, si rezultat i të cilëve, në disa raste duheshin shqyrtuar të gjitha pagesat që lidheshin me një pjesë të veçantë të projektit.

Rezultatet e Auditimit:

Gjykata e Auditimit ka konstatuar se në periudhën Janar 2004 - Shtator 2013, Ministria nuk kishte menaxhuar efektivisht projektin Informatizimi i Shëndetësisë. Megjithatë deri në shtator 2013, Ministria kishte arritur të lidhte Institucionet më të mëdha të shëndetit publik me një rrjet komunikimi, ajo kishte dështuar në futjen e zgjidhjeve të TI, të planifikuara fillimisht, ose në zhvillimin e të dhënave

të standartizuara të pacientëve. Në total, Ministria aktivizoi vetëm 10 (nga qindra) praktika shëndetësore për të shkëmbyer dokumentet e pacienteve në mënyrë dixhitale. Gjykata e Auditimit në këtë mënyrë arriti në përfundimin se nuk janë përmbushur as afatet, as ndonjë nga qëllimet e projektit të planifikuara fillimisht.

Gjykata e Auditimit gjithashtu vlerësoi se përpara vitit 2013, projekti Informatizimi i Shëndetësisë nuk ishte organizuar në mënyrë efektive. Meqenëse projekti shfrytëzoi një numër të madh konsulentësh të jashtëm, shpesh nuk ishte e qartë se cilët ishin anëtarët e ekipit të projektit, apo cili ishte roli i tyre. Meqenëse kompetencat e aktorëve të ndryshëm të projektit nuk ishin përcaktuar në mënyrë të qartë, llogaridhënia e tyre personale është reduktuar në mënyrë të ndjeshme.

Kjo, nga ana tjetër, çoi në një mbikëqyrje të zvogëluar mbi shpenzimet e projektit. Për shembull, Ministria bleu pajisje informatike, por më pas, për afro dy vjet, nuk arriti ti vendosë në punë. Pavarësisht mospërdorimit të këtyre mjeteve, Ministria pagoi për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tyre. Ministria gjithashtu pagoi për konsulentët e jashtëm, të cilët ishin të shumtë në numër dhe kontributi i tyre në këtë projekt ishte shpesh i paqartë. Ministria gjeti të paktën një software që ishte implementuar në vetëm dy institucione shëndetësore publike (dhe më pas ishte hequr dorë), dhe pagoi për përmirësimin e disa softwer-ve që kishin funksione të mbivendosura. Ministria gjithashtu pagoi edhe për përmirësimin e software-ve ekzistues

në sektorin e shëndetësisë, në pronësi të kompanive që tregtojnë software, për të cilat ofruesit e shërbimeve të shëndetit publik ndërkohë paguajnë taksat për licencën dhe mirëmbajtjen. Meqenëse Ministria nxori si arsye kryesore për fillimin e projektit Informatizimi i Shëndetësisë, mangësitë teknike të këtyre software-ve, investimi për përmirësim dukej që ishte në kundërshtim me ndërmarrjen e gjithë projektit.

Mësimet e nxjerra

Edhe pse nivelet e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit në qeverisje ndryshojnë shumë nga një vend në tjetrin, audituesit e SAL-ve që planifikojnë të ndërmarrin një Auditim të Performancës në fushën e implementimit të Teknologjisë së Informacionit mund të marrin parasysh rreziqet e mëposhtme:

Përcaktimi i përgjegjësisë për marrjen e vendimeve kyçe të projektit mund të jetë i vështirë. Pse? Për shkak se ndërtimi i çdo projekti mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme sipas organizimit të ministrive. Organizimi i projektit, kompetencat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në projekt, duhet të përcaktohen në dokumentacionin e projektit. Megjithatë, organizimi i një ministrie mbështetet në aktet dhe rregullat e brendshme të ministrisë, kështu që këto dokumente mund të keq-interpretohen.

Gjithashtu, projektet zakonisht zgjasin më gjatë se afatet e kontratave të zyrtarëve dhe ndryshimet e mëvonshme të personelit mund të komplikojnë çështjen e përgjegjësisë.

Për shkak të menaxhimit të dobët të dokumentacionit të projektit, afatit kohor të çeshtjeve kryesore, palëve të përfshira, kompetencave të dhëna, e madje edhe shtrirjes së projektit, vendim-marrja vështirësohet. Një Ministri e caktuar menaxhon dokumentacionin e saj në përputhje me Udhëzimet zyrtare, të cilat mund të jenë të papërshtatshme për menaxhimin efektiv të projektit.

Nëse projekti është financuar nga burime të shumta, llogaritja e kostos së tij të plotë mund të jetë e vështirë dhe kërkon kohë.

Nëse kontraktuesit e përfshirë në projekt kanë qenë të shumtë, dhe në qoftë se kontratat e tyre nuk janë përgatitur në mënyrë të përshtatshme, përkufizimi i roleve në projekt nuk është gjithmonë përfundimtar.

Kushtet e lidhura me Teknologjinë e Informacionit janë shpesh të paqarta. Të gjitha pikat e projektit duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe pa ekuivokë, në të kundërt do të jetë

shumë i vështirë përcaktimi, nëse, qoftë edhe një detyrë e vetme në kuadër të projektit, ka arritur qëllimin për të cilin është vendosur.

Konkluzione:

Në vitin 2013, Ministria ka zvogëluar planet e projektit Informatizimi i Shëndetësisë. Ajo ka përmirësuar organizimin e projektit, mbikëqyrjen e shpenzimeve të tij dhe përgjegjësinë personale të ekipit të projektit. Megjithatë, ende nuk është e qartë nëse projekti do të realizojë objektivat e parashikuara. Gjykata e Auditimit do të vazhdojë të monitorojë projektin në fazat e mëtejshme të zhvillimit të tij.

Përktheu : Amantia Patozi

Departamenti i Kërkimit Shkencor KLSH.

Maja Hmelak,
Masa Zeleznik M.Sc,
Gjykata e Auditimit e Republikës së Sllovenisë.

BASHKËPUNIMI ME QYTETARËT- PËRVOJA KOREANE NË PËRFSHIRJEN E QYTETARËVE NË PROCESET AUDITUESE

Qëllimi i këtij prezantimi është ti paraqesë publikut të interesuar kërkesën për pjesëmarrje aktive në auditim dhe të përdorë përvojat e mëparshme për të adresuar tre çështje kyçe që lidhen me bashkëpunimin e SAI-t me qytetarët

Nga Dr. Seongjun Kim
Drejtor i Përgjithshëm i Bordit të
Auditimit dhe Inspektimit të Koresë

Bordi i Auditimit dhe Inspektimit i Koresë (Board of Audit and Inspection of Korea - BAI) ka vendosur mënyra të ndryshme bashkëpunimi me qytetarët. BAI p.sh., merr këshilla për çështjet e korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve publike si dhe shqyrton petitionet, ankesat dhe kërkesat për auditim të marra nga qytetarët. BAI gjithashtu i publikon të gjithë raportet e tij në faqen zyrtare të internetit për t'u lehtësuar qytetarëve aksesin në punën e tij. Qëllimi i këtij prezantimi është ti paraqesë publikut të interesuar kërkesën për pjesëmarrje aktive në auditim dhe të përdorë përvojat e mëparshme për të adresuar tre çështje kyçe që lidhen me bashkëpunimin e SAI-t me qytetarët. Këto çështje janë: vlerat dhe përfitimet e pjesëmarrjes aktive në auditim, mekanizmat e riskut dhe

kontrollit si dhe përvoja e përfituar dhe sfidat e përballuara gjatë këtij procesi.

Paraqitja e kërkesës për pjesëmarrje në auditim për çështje që i interesojnë publikut.

BAI në vitin 1996, në bazë të rregullores së brendshme, paraqiti kërkesën për pjesëmarrje në auditim për çështje me interes për publikun, sipas të cilës organizata të shoqërisë civile me një anëtarësi prej 300 personash ose më shumë, mund ti kërkonin BAI të kryente një auditim në një fushë specifike me interes për opinionin publik.

Dokumenti Anti-Korrupsion i vitit 2002 përcaktoi bazën ligjore, e cila qartësoi mënyrën se si qytetarët mund të kërkonin kryerjen e një auditimi nga BAI.

Në këndvështrimin e legjitimitetit të kërkesësve, qëllimit të auditimit dhe

limitit kohor që duhet për të raportuar, kërkesa për auditim për çështjet me interes për opinionin publik është më e gjerë se kërkesa e një shtetasi për auditim.

	Kërkesë auditimi për çështjet me interes për publikun	Kërkesë e shtetasve për auditim
Legjitimimi i kërkesës për auditim	me shumë se 300 qytetarë organizata të shoqërisë civile drejtues të entiteteve publike këshillat lokalë	me shumë se 300 qytetarë
Çështjet e auditimit (subjektet)	akte të paligjshme/akte korruptive keqmenaxhim i progresi interesat publike	akte të paligjshme/akte korruptive
Çështjet që përjashtohen nga auditimi	çështje aktuale që hetohen/gjyohen çështje personale	çështje aktuale që hetohen/gjyohen çështje personale çështje nën juridiksionin e qeverisjes lokale

Vlerat dhe përfitimet e auditimeve të kryera me përfshirjen e qytetarëve. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në auditim dhe demokracia e zgjeruar në pjesëmarrje

Grafiku i mëposhtëm tregon një rritje të trendit të kërkesave për auditim për vitet 1996- 2013


Numrin më të madh të kërkesave për auditim e përbëjnë kërkesat e qytetarëve me një total prej 59,5 %. Megjithatë , ndër katër grupet e kërkesave, kërkesat e qytetarëve që janë pranuar nga BAI përbëjnë nivelin më të ulët me 28 %.

Kërkesat e organizmave të shoqërisë civile përbëjnë 32,2 % dhe renditen të dytat pas kërkesave të qytetarëve. Shkalla e pranimit të kërkesave të këtyre organizatave është 40%. Organizmat e shoqërisë civile kanë një ndikim të rëndësishëm në opinionin e qytetarëve dhe veprojnë si mbikëqyrës të qeverisjes.

Këshillat lokale që kanë më pak pushtet dhe mandate të kushtëzuar shpesh kanë kërkuar kryerjen e auditimeve nga BAI për të kontrolluar dhe mbikëqyrur performancën e kryetarëve të autoriteteve lokale.


Përmbushja e nevojave të qytetarëve dhe zgjidhja e ankesave të tyre.

Siç tregohet në grafikun e mëposhtëm me titull " Pamje e përgjithshme e marrjes së kërkesave për auditim", fushat me të cilat jetesa e qytetarëve është e lidhur ngushtë, të tilla si: lejet dhe licencat, ndërtimi, transporti, mjedisi etj., përbëjnë 43% të numrit të përgjithshëm të kërkesave për auditim. Kjo konfirmon edhe njëherë se fushat që paraqesin interes për qytetarët janë fushat në të cilat kërkohet pjesëmarrje në auditim. Procesi i pjesëmarrjes në auditim e ndihmon BAI të japë rekomandime për zgjidhjen e ankesave dhe problemeve të qytetarëve.



Numri i kërkesave sipas fushave që paraqesin interes për auditim (1996-2013)

- Lejet dhe licencat 289
- Transporti dhe mjedisi 283
- Menaxhimi 53
- Ndërtimi 283
- Buxheti për trajtimin e mbetjeve 217
- Të tjera 653



Rastet e zgjidhjes së ankesave të qytetarëve.

Autoriteti i qarkut të Haman-it miratoi një projekt të ri për strehimin, i cili shtrohej përtej sipërfaqes së parashikuar për ndërtim. Të shqetësuar se gjendja e mjediseve që ishte planifikuar për strehim do të përkeqësohej, banorët e qarkut i kërkuan BAI të kryente një auditim. Pas përfundimit të auditimit, BAI arriti në përfundimin se autoritetet e qarkut që kishin dhënë lejen për projektin kishin shkelur ligjin dhe BAI rekomandoi dhënien e masave disiplinore.

Kur përdoruesit e shërbimit të telefonisë konstatuan se pa miratimin e tyre ishin regjistruar në një plan tarifor më të shtrenjtë, ata kërkuan auditimin e kompanisë telefonike. BAI konstatoi

se ishin me shumë se dy milion raste të regjistrimit të paautorizuar dhe se organi mbikëqyrës i Komisionit Korean të Komunikacionit kish dështuar në ndërmarrjen e veprimeve kundër praktikave ilegale të kompanisë telefonike. BAI e paralajmëroi Komisionin Korean të Komunikacionit për mbikëqyrjen neglizhente dhe kompania telefonik u gjobit. Si rezultat, kërkuarit u dëmshpërblyen.

Përmirësimi i administrimit të sektorit publik.

Duke u bazuar në përfundimet e nxjerra nga auditimi rezulton se rreth 64% e kërkesave të paraqitura ishin të justifikuara. Kjo tregon se sistemi i auditimit me pjesëmarrje i ndërtuar mbi bazën e pjesëmarrjes së qytetarëve në funksionin e mbikëqyrësit, kontribuon ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe paanshmërinë e institucioneve publike. Duke qenë se qytetarët kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në auditim, zyrtarët e qeverisë tashmë pranojnë se mundësia për t'u audituar nga BAI është më e madhe, kjo edhe në rastet kur ata nuk kanë gabuar në kryerjen e detyrave të ngarkuara. Efektet parandaluese të mbikëqyrjes së sektorit publik në bashkëpunim me

qytetarët mund të mbizotërojnë mbi kostot përkatëse.

Rastet e përmirësimit të administrimit të sektorit publik

Autoritetet e qarkut të Eumseong-ut vendosën të lejojnë dhënien e një garancie për borxhin e një sipërmarrësi të një kompleksi të madh industrial. Të shqetësuar se autoritetet e qarkut mund të falimentonin nëse sipërmarrësi do të dështonte, banorët e qarkut i kërkuan BAI të kryente një auditim. Pas auditimit, BAI rekomandoi dhënien e masave disiplinore për përgjegjësit që ofruan dhënien e garancisë për borxhin.

Një grup qytetarësh kërkoi auditimin e autoriteteve të qytetit Masan për dhënien e përfitimeve të pandershme kontraktorit të projektit të ujësjellës-kanalizimeve. BAI konstatoi se qeverisja lokale kishte rimbursuar më tepër kontraktin dhe i rekomandoi asaj kompensimin e humbjeve dhe marrjen e masave disiplinore për nëpunësit përgjegjës për keqmenaxhimin.

Mekanizmat e riskut dhe kontrollit

Disa prej risqeve që shfaqen në auditimin me pjesëmarrjen e palëve të interesuara janë të njohura mirë nga SAI-et. A mund të kontrollohen këto risqe brenda kostove të arsyeshme? Më poshtë gjendet një shpjegim për dy prej risqeve më të mëdha.

Qëllim i deformuar i kërkesës për auditim

Edhe pse përfshirja në auditim e palëve të interesuara po shtohet, pasi qytetarët shprehin interesin e tyre për

mbarëvajtjen e qeverisjes, disa kërkesa për auditim anojnë drejt interesave personale. Kjo mund të deformojë interesin publik për pjesëmarrje në auditim.

Në mënyrë që të parandalohen dhe frenohen kërkesat për auditim, të cilat kanë më shumë natyrë personale sesa publike, BAI ka parashikuar masa të ndryshme kontrolli të tilla si:

forcimin e masave kualifikuese për kërkesat

përcaktimin rigoroz të interesave publike

ngritjen e një komisioni për shqyrtimin e kërkesave për auditim, i cili do të trajtojë këto kërkesa.

Për të kërkuar fillimin e një auditimi, qytetarët duhet të krijojnë një grup prej 300 individësh. Për të verifikuar këtë numër secili pjesëmarrës duhet të nënshkruaj kërkesën si dhe duhet të jap informacione shtesë të tilla si adresa, datëlindja, etj., lidhur me mënyrën se si mund të kontaktohet nga BAI, etj. Gjithashtu BAI ka riformuluar konceptin e interesit publik duke përcaktuar se "mirëqenia e publikut të gjerë dhe të gjithë shoqërisë nuk kufizohet nga interesat e një grupi apo individi të caktuar". Ky është kriteri kryesor për përzgjedhjen e kërkesave.

Kërkesat për auditim të motivuara politikisht

Këshillat lokale dhe drejtuesit e qeverisjes lokale kanë tendencë të përdorin kërkesat për auditim për të përmbushur qëllimet e tyre politike. Auditimi shihet si një mjet efikas për të sulmuar ose poshtëruar kundërshtarin politik. Kjo evidentohet nga fakti se kërkesat për auditim të bëra nga këshillat lokale kanë tendencë të rriten

një vit para mbajtjes së zgjedhjeve lokale.

Për të ruajtur neutralitetin politik dhe për të përmbushur nevojat e këshillave lokale, drejtuesve të qeverisjes lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve, të cilët kanë interesa të ndryshme politike, BAI mund ti pranojë kërkesat e paraqitura prej tyre pas një shqyrtimi të plotë nga komisioni i shqyrtimit të kërkesave për auditim. Ky komision kryesohet nga një ekspert i jashtëm dhe është mekanizmi kyç i cili u jep garanci kërkuuesve se vendimi për pranimin ose mos pranimin e kërkesës së tyre për auditim nga BAI është i pavarur nga politika.

Përvojat e përfituara dhe sfidat e përballuara.

Eksperiencat e BAI tregojnë se risqet e lidhura me auditimin me pjesëmarrjen e palëve të interesuara mund të menaxhohen me një kosto të arsyeshme. BAI pati përfitime të konsiderueshme nga auditimi me pjesëmarrje, por kjo nuk do të thotë se ky model i implementuar prej tij funksionon në çdo rast. Përparësitë në shpërndarjen e burimeve të auditimit, mund të ndryshojnë nga një SAI. Shkaqet për këtë mund të jenë misionet respektive, strategjitë dhe qasjet e tyre të auditimit si dhe mjedisi i auditimit. Më poshtë paraqiten përvojat e përfituara rreth çështjes se çfarë e bën të suksesshëm një auditim me pjesëmarrje.

Hartimi i kornizave të përshtatshme ligjore, të cilat sigurojnë vazhdimësinë e veprimeve, fluksin e burimeve dhe një vëmendje më të madhe të qytetarëve.

Vëmendja e vazhdueshme dhe mbështetja e drejtuesve të lartë është e domosdoshme për të mbajtur të motivuar audituesit.

Rritja e aksesit të qytetarëve në sistemin e dëshmipërblimeve mund të inkurajojë pjesëmarrjen më aktive të qytetarëve. Metodat për rritjen e aksesit përfshijnë raportimin e rasteve të mashtrimit nëpërmjet sistemeve kompjuterike(internetit), linçimin e linjës së gjelbër, ngritjen e qendrës për trajtimin e peticioneve dhe ankesave.

Trajtimin proaktiv të risqeve potenciale që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në auditim.

Standarde më të larta të etikës në auditim mund të ndihmojnë për të shmangur mundësinë që kërkuessit të përdorin auditimin për çështje me interes privat.

Mbajtja e marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit me autoritetet lokale dhe organizma të tjerë përmes njësive të tyre të auditimit të brendshëm, mund të ndihmojë në ecurinë e të gjithë procesit.

Stafet e përgatitura të organizatave të shoqërisë civile të synojnë mbrojtjen e interesave publike, janë parakusht për bashkëpunimin dhe funksionimin e auditimit me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

Me gjithë zhvillimet pozitive, BAI duhet t'u përgjigjet sfidave të mëposhtme:

Nxitjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në auditimin publik, pasi kjo zvogëlon në mënyrë efektive mundësitë që kërkuessit ta përdorin auditimin për interesa private.

Harmonizimit të bazës ligjore për iniciativat e ndryshme të auditimit me pjesëmarrje të palëve të interesuara.

Njësimit të vlerave dhe përfitimeve të auditimit me pjesëmarrje, në mënyrë të besueshme e rigoroze dhe promovimi i tyre.

Shënim- Ky artikull është përshtatur nga materiali i prezantuar nga Dr. Seongjun Kim, Drejtor i Përgjithshëm i Bordit të Auditimit dhe Inspektimit të Koresë. Prezantimi është mbajtur në datë 15 Prill 2014 gjatë një video konference të sponsorizuar nga Banka Botërore. Pjesëmarrësit në këtë konferencë ishin përfaqësues të Afganistanit, Bangladeshit, Butanit, Indisë,

Maldivëve, Nepalit, Pakistanit dhe Sri Lankës.

Përktheu: Alma SHEHU, Audituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm

Nga Dr. Seongjun Kim,
Drejtor i Përgjithshëm i Bordit të
Auditimit dhe Inspektimit të Koresë.

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

VEPRIMTARI TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT PËR PERIUDHËN MAJ-GUSHT 2014

1. Vizita zyrtare e z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së pranë Institutit të Auditimit të Polonisë

Në datat 12-14 maj 2014, me ftesë të Presidentit të Institutit të Auditimit të Polonisë

ishite prezenca në Këshillin e NIK-ut polak. Në respekt dhe vlerësim të bashkëpunimit me KLSH-në, presidenti Kwiatkowski i shprehu z.Leskaj ftesën për të mbajtur fjalën e hapjes në



Auditimit të Polonisë, NIK, z. Krzysztof Kwiatkowski, z.Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zhvilloi një vizitë zyrtare pranë këtij institucioni. Një prej zhvillimeve më të rëndësishme gjatë qëndrimit të z.Leskaj në Poloni,

sesionin e radhës së Këshillit të NIK. Kryetari i KLSH-së është i ftuari i parë në të gjithë historinë e NIK-ut polak, i cili merr pjesë dhe mban fjalën e hapjes në një nga sesionet e këtij Këshilli. Këshilli i NIK është një strukturë e pavarur, e cila

në përbërje të saj ka përveç anëtarëve të NIK-ut edhe figura të shquara të botës akademike polake në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë.

Kryetari i KLSH-së, në fjalën e tij përshëndetëse, shprehu falenderimet për ftesën e bërë dhe theksoi privilegjin e kësaj mundësie, si dhe vlerësimin e lartë dhe respektin për NIK-un polak si një nga partnerët kryesorë të KLSH-së drejt rrugës së zhvillimit, në përputhje të plotë me standartet e INTOSAI-t.

Ai u shpreh se audituesit shqipëtarë dhe KLSH janë krenarë për sukseset e NIK-ut polak në arenën ndërkombëtare dhe njekohësisht mirënjohës si dhe të inkurajuar që një nga partnerët më të mirë të tyre është Institucionin Suprem i Auditimit të Polonisë, i cili ka dhënë ndihmën e tij të pakushtëzuar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e mëtejshëm të KLSH-së, gjatë vitit 2012 dhe në vijim.

Z.Leskaj theksoi se një nga faktorët e rëndësishëm në eksperiencën e NIK, ishte lufta ndaj mashtrimit në administratën publike dhe se KLSH ishte mjaft e interesuar për ta vazhduar dhe zgjeruar këtë ekperiencë të fituar nga NIK, në përsosjen e metodologjive të auditimit, zhvillimin e auditimeve të performancës, kombinuar me ato financiare, ashtu siç ishte mjaft e interesuar edhe në thellimin dhe vazhdimin e trajnimeve të audituesve shqiptarë në Poloni dhe realizimit të aktiviteteve të përbashkëta. Gjithashtu, z.Leskaj përshëndeti punën e bërë nga ish-Presidenti Jezierski në arritjen e këtij bashkëpunimi të suksesshëm dhe sa shumë KLSH dhe audituesit e saj, kishin

mësuar prej aktiviteteve të ndërsjella të zhvilluara deri tani.

Z.Leskaj u shpreh ky ishte një vit i rëndësishëm për Poloninë, ku janë festuar 10 vjetori i anëtarësimit në BE dhe kanonizimi i një figure të shquar dhe vlerësuar në të gjithë botën si Ati i Shenjtë, Papa Gjon Pali II, Papa i parë që vizitoi Shqipërinë. Së shpejti do të përkujtohet 25 vjetori i Solidarnos, si edhe 15 vjetori i anëtarësimit në NATO. Viti 2014 shënon edhe 54 vjetorin e anëtarësimit të NIK-ut në INTOSAI. Zoti Leskaj theksoi se NIK është dhe mbetet një nga SAI-t më aktivë duke zgjeruar njohuritë mbi standartet e auditimit dhe praktikat më të mira, ashtu si edhe duke shkëmbyer eksperiencat dhe arritjet e tij me shumë SAI të tjerë.

NIK bashkëpunon me partnerët e tij brenda kuadrit të EUROSAT-t si dhe mbështet audituesit e Gjykatës Europiane të Llogarive në misionet e tyre në Poloni. Në vitin 2012, NIK u emërua si auditues i jashtëm i Organizatës Europiane për Kërkimin Nuklear për vitet 2013-2015 si dhe auditues i jashtëm i Këshillit të Europës, ku KLSH dha mbështetjen maksimale për kandidaturën e NIK.

Me vlerësim të veçantë, z.Leskaj u shpreh edhe për kontributin që jep Ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, z.Marek Jeziorski jo vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, por edhe duke qenë prezent në median e shkruar shqiptare, ku artikulli më i fundit me titull, "Cilat ishin tiparet kryesore të aderimit të Polonisë në BE", është një mësim dhe shembull për të gjithë shqipëtarët.

Më tej, z.Leskaj vijoi me një ekspozë përmbledhëse lidhur me organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, duke e mbyllur fjalimin e tij me falenderimet e përzemërta për të gjithë mbështetjen e dhënë nga ish-presidenti Jezierski dhe presidenti aktual, z.Kwiatkowski dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet dy institucioneve. Gjatë qëndrimit në Poloni, z.Leskaj i shoqëruar edhe nga z.Jezierski, zhvilloi një vizitë edhe pranë degës rajonale të NIK-t në qytetin e Gdanskut, ku u prit në një takim të veçantë nga drejtuesja e kësaj dege, zj.Alicja Szczepaniak dhe auditues të kësaj dege. Zj.Szczepaniak bëri një përshkrim të organizimit dhe zhvillimit të punës në këtë degë rajonale dhe foli për arritjet e deritanishme.

Pas një prezantimi të z.Jezierski për Kryetarin e KLSH-së, Z.Leskaj e filloi fjalën e tij përshëndetëse në shenjë respekti për miqtë polakë me një përmbledhje të simboleve polake, të cilat janë përkthyer në shqip, të disa prej figurave më të shquara të këtij kombi, si Papa Gjon Pali i II, Shopeni, Koperniku, Lech Walesa, etj si dhe të disa aspekteve të përbashkëta të dy kulturave tona. Gjithashtu ai u shpreh se qyteti i Gdanskut ishte një simbol i demokracisë jo vetëm për Poloninë, por për të gjithë botën, vendi ku Lech Walesa dhe Solidarnos, drejtuan një protestë mbarëkombëtare drejt transformimit paqësor në demokraci të të gjithë Europës lindore. Përmbledhja e Simboleve Polake si dhe botimet e KLSH-së, "Auditimi Publik" nr.6 dhe "Konferenca Shkencore e KLSH-së, II", u vlerësuan dhe u mirëpritën mjaft nga pjesëmarrësit në takim.

Në përfundim, u zhvillua një sesion pyetje-përgjigje, ku audituesit polakë



shfaqën interesin e tyre lidhur me organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, nëpërmjet pyetjet drejtuar z.Leskaj. Në ditën e parë të vizitës, takimi ndërmjet z.Kwiatkowski dhe z.Leskaj, në praninë edhe të ish-Presidentit të NIK-t polak, z.Jacek Jezierski si edhe të zv.Presidentit, z.Wojciech Kutyla, u zhvillua në një atmosferë mjaft miqësore dhe të ngrohtë. Z.Kwiatkowski i uroi mirëseardhjen z.Leskaj dhe delegacionit dhe shprehu kënaqësinë e tij të veçantë për marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet dy institucioneve si dhe ecurinë mjaft të suksesshme të saj.

Presidenti i NIK-t shprehu gatishmërinë e tij të plotë dhe theksoi se ky bashkëpunim i konsoliduar tashmë, do të vazhdonte edhe në të ardhmen me të njëjtin intensitet. Gjithashtu, ai u shpreh se NIK-u polak, ishte i gatshëm të jepte të gjithë kontributin e tij në zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të KLSH-së, nëpërmjet vazhdimësisë së trajnimeve, aktiviteteve të përbashkëta, etj.

Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj e falenderoi homologun polak për të gjithë mbështetjen e dhënë, si dhe për ritheksimin e vazhdimësisë së këtij bashkëpunimit shumë domethënës dhe të rëndësishëm për KLSH-në, duke marrë në konsideratë traditën e gjatë të punës dhe përparimet e NIK-ut, si një ndër institucionet më moderne dhe të zhvilluara brenda komunitetit EUROSAT dhe INTOSAT. Në një takim pune të veçantë, z.Leskaj dhe zv.presidenti i NIK, z.Kutyla, diskutuan dhe përcaktuan më në detaje aktivitetet në vijim dhe koordinimin e punës për realizimin e tyre.



Z.Leskaj në ditën e fundit të qëndrimit në Poloni, zhvilloi dhe një takim pune me z.Roman Maguta, Kryetar i Dhomës së Llogarive të Ukrainës, i cili ndodhej në Poloni me rastin e zhvillimit të punimeve të Task Forcës së EUROSAT-t për auditimet në rastet e katastrofave. Gjatë takimit, z.Maguta shprehu kënaqësinë e tij për takimin, si dhe e ftoi KLSH-në t'i bashkohej kësaj Task Force. Task Forca e EUROSAT-t për auditimin në rastet e katastrofave e kryesuar nga SAI i Ukrainës, përbëhet nga 16 SAI europiane dhe është krijuar me një rezolutë të miratur në Kongresin e VII të EUROSAT-t, në Krakovë në 2008. Misioni i saj është të koordinojë dhe konsolidojë përpjekjet e SAI-ve europiane drejt rritjes së ndërgjegjësimit mbi fatkeqësitë dhe katastrofat, si dhe të ndihmojë qeveritë të zhvillojnë instrumente efektive dhe



eficiente në parandalimin dhe eliminimin e pasojave të tyre. Gjatë Kongresit të ardhshëm të EUROSAT-t në Hagë, kjo Task Forcë do të miratohet si një Grup Pune.

Në këtë vizitë, z.Leskaj, Kryetar i KLSH-së, shoqërohej nga zj.Dëshira Huqi, përgjegjëse sektori për marrëdhëniet me jashtë dhe zj.Valentina Golemi, audituese.

2. Kontrollit i Lartë i Shtetit dhe Instituti Shqiptar i Shkencave nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

Në datën 19 maj 2014, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH dhe Institutit Shqiptar të Shkencave (ISHSH), i cili realizon në Shqipëri projektin Open Data Albania.



Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH do të angazhohet për shkëmbimin e të dhënave me interes reciprok, duke hapur edhe një dritare tjetër komunikimi me publikun, me qëllim rritjen e transparencës dhe modernizimin e institucionit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi do të krijohet mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga Open Data Albania që është një projekt serioz dhe i vlerësuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit për cilësinë e të dhënave dhe analizave që publikon e përgatit.

Nëpërmjet realizimit të kësaj marrëveshje, KLSH është në përmbushje të detyrave për ngritjen e

kapaciteteve dhe rritjen e standarteve profesionale në auditim, nëpërmjet trajnimeve, workshopeve dhe



aktiviteteve të tjera të përbashkëta me qëllim modernizimin e institucionit dhe forcimin e luftës kundër korrupsionit. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga zj.Aranita Brahaj, Kryetare e Institutit Shqiptar të Shkencave.

Zonja Brahaj, nga ana e saj, vlerësoi bashkëpunimin dhe qasjen e re që ka KLSH ndaj Shoqërisë Civile, duke theksuar se ky bashkëpunim nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave do të gjenerojë ide të reja dhe do të ndihmojë në gjetjen e defekteve, duke përmirësuar luftën ndaj korrupsionit.

Të dyja palët shprehen së fundmi vendosmërinë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje si dhe besimin se një bashkëpunim i sigurtë mes strukturave publike dhe shoqërisë civile do të japë rezultate konkrete në rritjen e transparencës, përmirësimin e analizave ekonomike, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave mbi indikatorët ekonomik-shoqëror në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e qeverisjes.

3. Vizita zyrtare e delegacionit të KLSH-së, me rastin e 150-vjetorit të

krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive

Në datat 5-7 qershor 2014, në Bukuresht u zhvilluan aktivitetet e organizuara me rastin e 150-vjetorit të krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive.

Ceremonia kryesore e 150-vjetorit të krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive, u zhvillua në datë 6 qershor 2014, në hollin plenar të Dhomës së Deputetëve në Pallatin e Parlamentit. Në këtë ceremoni merrnin pjesë Presidenti i Rumanisë, z.Traian Basescu,



Kryeministri i Rumanisë, z. Viktor Ponta, Kryetari i Dhomës së Deputetëve, z. Valeriu Zgonea, Presidenti i Gjykatës së Audituesve, z.Nikolae Vacariu, Guvernatori i Bankës së Rumanisë, z.Mugur Isarescu, Patriarku i Kishës Ortodokse Rumune, Daniel, Kryetari i Bashkisë së Bukureshtit, z.Sorin Oprescu, si edhe ministra, senatorë dhe deputetë.



Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj me Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, z.Nicolae Vacariu

Gjithashtu, merrnin pjesë në ceremoni, delegacione të SAI-ve anëtare të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t, Presidenti i Gjykatës Europiane të Llogarive, z.Vitor Caldeira, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAT-t, z.Josef Moser, Presidenti i OLACEF dhe njëkohësisht i SAI-t Brazilian, z. Augusto Nardes, Kryetarë të SAI-ve Europiane, etj.

Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë, përfaqësohej nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe z.Xhafer Xhoxhaj, Drejtor Departamenti në KLSH.Aktivitetin e përshëndetën Presidenti i Rumanisë, z.Traian Basescu, Kryeministri i Rumanisë, z. Viktor Ponta, Kryetari i Dhomës së Deputetëve, z. Valeriu Zgonea dhe Presidenti i Senatit z.Calin Popescu-Tariceanu, ku u vlerësua Gjykata Rumune e Llogarive dhe veçanërisht roli i luajtur nga kjo Gjykatë, në përdorimin me efektivitet dhe transparencë të plotë të fondeve publike.

Në ceremoni, përshëndetën edhe z.Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAT-t dhe President i Gjykatës austriake të Llogarive, Presidenti i Gjykatës Europiane të Llogarive, z.Vitor Caldeira, z. Guilherme d'Oliveira Martins, President i Gjykatës portugeze

të Llogarive dhe President i EUROSAT-t, si dhe z.Tomas Vesel, President i Gjykatës sllovene të Llogarive. U zhvilluan gjithashtu edhe takime të ndryshme bilaterale si edhe video-mesazhe përshëndetëse nga z.Gene Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i SH.B.A dhe z. Josef Beckers, Anëtar i Gjykatës belge të Auditimit.

Stafi i Gjykatës së Llogarive kishte përgatitur edhe botimet “Gjykata e Llogarive të Rumanisë, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, 1864-2014” si dhe “150 vjet që prej krijimit 1864-2014”, të cilat iu shpërndanë edhe pjesëmarrësve, si dhe u hap ekspozita me botimet e Gjykatës së Llogarive, një ekspozitë filatelike, etj.



Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj me Drejtues të SAI-ve homologe

Gjatë këtyre ditëve, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, zhvilloi takime pune me Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, z.Vacaroiu, zv.Presidentin, z.Gheorghe Oana, si dhe Presidentë të SAI-ve të tjerë, të pranishëm si Presidentin e TCA-së, z.Akyel, Presidentin e SAI-t kroat, z.Klesic, zv.Presidentin e NIK-ut të Polonisë, z.Kutyla, etj.

Historik

Në 24 janar 1864, Parlamenti i Rumanisë (Asambleja zgjedhëse), miratoi në Bukuresht krijimin e Gjykatës së Lartë të Llogarive të Rumanisë sipas

modelit francez dhe atij belg, një institucion i përfshirë në reformën dhe procesin e modernizimit të shtetit rumun, i kryesuar në atë kohë nga Alexandru Ioan Cuza.

Institucioni i Gjykatës Rumune të Llogarive ka pasur një impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ka kontribuar në modernizimin e shtetit, si dhe të qëndrueshmërisë së Rumanisë në kuadrin europian dhe botëror.

E riorganizuar disa herë, madje dhe e shfuqizuar në 1 dhjetor 1948, Gjykata e Llogarive u rikrijua me ligj në vitin 1992. Kushtetuta e Rumanisë e vitit 1991 citonte se: “Gjykata e Llogarive ushtron kontrollin e krijimit, menaxhimit dhe përdorimit të burimeve financiare shtetërore dhe të sektorit publik”.

Bazuar në Kushtetutën e vitit 1991, më 9 shtator 1992, u publikua Ligji nr. 94/1992 mbi organizimin dhe veprimtarinë e Gjykatës së Llogarive dhe institucioni e filloi aktivitetin e tij në 1 mars 1993. Kushtetuta e vitit 1993 thotë se anëtarët e Gjykatës së Llogarive janë të pavarur në kryerjen e mandatit të tyre dhe janë të pandryshueshëm përgjatë gjithë këtij mandati.

Presidenti aktual i Gjykatës së Llogarive, z.Nicolae Vacaroiu, u lind më 5 dhjetor 1943. Ai është një politikan dhe ekonomist rumun, anëtar i partisë social-demokrate.

Ka qenë më parë Kryeministër i Rumanisë (në vitet 1992-1996), President i Senatit të Rumanisë prej vitit 2000, i rizgjedhur në vitin 2004 deri në tetor 2008. Ka kryer funksionin e Presidentit të Republikës, interim, prill-maj 2007 dhe në 14 tetor 2008, është zgjedhur President i Gjykatës së

Llogarive të Rumanisë, me një mandat 9-vjeçar.

Marrëdhëniet ndërkombëtare të Gjykatës së Audituesve të Rumanisë, shtrihen në tre linja kryesore aktiviteti, sipas të cilave zbatohen edhe marrëdhëniet me jashtë të institucionit me organizatat profesionale ndërkombëtare dhe ato të asociuara, respektivisht: a. Me Bashkimin Europian; b. Marrëdhëniet bilaterale dhe c. Marrëdhëniet multilaterale.

Gjykata e Llogarive të Rumanisë, është anëtare aktive e EUROSAT-t, INTOSAT-t, AISCUF dhe Komitetit të Kontaktit, si edhe e disa grupeve të punës, komiteteve e nën-komiteteve, në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët. Gjithashtu, përfaqësuesi i kësaj Gjykate, është bashkë-drejtues i Grupit të Përbashkët të Punës për Aktivitetet në Auditim (JWGAA).



Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj me ish-Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, z.Dan Drosu Saguna

Gjykata e Llogarive të Rumanisë ka përmbyllur marrëveshje bashkëpunimi në kuadrin bilateral me shumë institucione homologe, ku theksojmë Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar në Tiranë, ndërmjet dy institucioneve, 26 qershor 2003, ndërmjet Kryetarit të KLSH-së të asaj kohe, z.Mustafa Kërçuku dhe

Presidentit të Gjykatës rumune të Llogarive, z.Dan Drosu Saguna.

Në ditët e qëndrimit në Bukuresht, z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, u takua dhe me ish-Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, z.Dan Drosu Saguna, i cili ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit në vitin 2003.

4 KLSH në Kongresin e IX-të EUROSAT



Në datat 16 deri më 19

Qershor 2014, në Hagë zhvilloi punimet Kongresi i IX-të i Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAT, me pjesëmarrjen e delegacioneve nga 50 Institucionet Supreme të Auditimit të Europës si dhe të ftuar të tjerë, ndër të cilët Gjykata Europiane e Llogarive, Organizata IDI dhe SIGMA.



Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH, Sekretarja e Përgjithshme znj.Luljeta Nano, Drejtore Departamenti znj. Albana Agolli dhe Kryeaudituese znj. Evis Çela.

Inovacioni ishte tema qendrore e këtij Kongresi, nën moton "Kur ka qenë hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?", me synimin final për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të auditimit publik. Në përmbyllje të objektivave të tij, në

këtë kongres diskutimet zyrtare u alternuan me paraqitje artistike dhe jo formale të njerëzve të suksesshëm nga bota e artit dhe biznesit. Kongresi ishte i konceptuar i ndarë në dy seanca plenare diskutimesh dhe prezantimesh, të cilat u zhvilluan në ditën e parë dhe të fundit si dhe në workshop-e të veçanta në dy ditët e tjera.

KLSH dha kontributin e tij në njërin nga këto workshop-e “Open mic” ku u prezantua bashkëpunimi i KLSH me Organizatat e Shoqërisë Civile, duke u fokusuar në rëndësinë dhe domosdoshmërinë e këtij bashkëpunimi si dhe në përfitimet që ai mbart. Ky prezantim ngjalli interes tek të pranishmit dhe u konsiderua një mënyrë inovative për të rritur llogaridhënien, transparencën dhe impaktin e SAI-t në publik. Gjithashtu, duke qenë se KLSH është pjesë e Task Forcës së ngritur mbi integritetin dhe etikën, në bashkëpunim me SAI-n e Kroacisë, u krye moderimi i workshop-it mbi “Vlerën më të mirë të parasë nëpërmjet respektimit të etikës në procesin e prokurimit publik”. Ky workshop u fokusua në punën që SAI duhet të kryejë në këtë drejtim, duke identifikuar sjelljen jo etike në institucione.

Konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në Deklaratën përfundimtare të këtij Kongresi synojnë të japin orientime se si Institucionet Supreme të Auditimit në Europë do të punojnë në tre vitet e ardhshme, kryesisht në lidhje me inovacionin. Veprimet duhen ndërmarrë në tre fusha të ndryshme: kulturë dhe lidhshëm, transmetimi i mesazhit dhe “open data”.

Në lidhje me kulturën dhe lidhshëmin u arrit në konkluzionin se:

- SAI duhet të jetë i hapur për risitë dhe të konsiderojë mundësitë për t’i bërë gjërat ndryshe;

- Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shpërndajnë eksperiencat brenda komunitetit EUROSAI;

- Çdo SAI ka përgjegjësinë për të udhëhequr nëpërmjet shembullit.

Në këtë drejtim, EUROSAI do të kërkojë mënyra të reja nëpërmejt të cilave do të nxitet inovacioni në Institucionet Supreme të Auditimit, do të inkurajojë auditimet e përbashkëta mbi çështje të caktuara dhe do të përforcojë qasje, teknika dhe produkte të reja auditimi.

Për sa i takon transmetimit të mesazhit u konkludua se:

- Institucionet Supreme të Auditimit duhet të janë vazhdimisht në një proces ndërveprimi me njëri-tjetrin, me qytetarët dhe qeverinë;

- Një sipërmarrje e përbashkët do të ndihmonte SAI-t të ecnin përpara në drejtim të gjetjes së mënyrave inovative për të transmetuar mesazhin e tyre;

Në këtë drejtim, EUROSAI do të marrë përsipër aktivitete që do të lehtësojnë ngritjen e kapaciteteve të SAI-eve, për të përcjellë mesazhet në mënyrë sa më efektive.

Në lidhje me “open data”, u ra dakort se:

- Ky proces ofron mundësi të reja për të vlerësuar performancën e qeverisë dhe rritur transparencën e përgjegjshmërinë;

- SAI-t duhet të rishqyrtojnë pozicionin, rëndësinë dhe rolin e tyre tradicional;

- “Open data” ndihmojnë lehtësimin e punës së Institucioneve Supreme të Auditimit dhe për këtë arsye ata duhet të nxisin implementimin e një sistemi të tillë transparent e të hapur për publikun.

Në këtë drejtim, EUROSAL do të nxisë diskutime të mëtijshme në komunitetin e Institucioneve Supreme të Auditimit, mbi mundësitë dhe përfitimet që vijnë nga aplikimi i “open data”.

Në ditën e parë të Kongresit, objekti i kristalit që përfaqëson EUROSAL-n iu dha në mënyrë simbolike presidentes të SAI-t të Hollandës, znj. Saskia J.Stuiveling nga z.Guilherme d’Oliveira Martins, President i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë. Ky veprim shënoi edhe kalimin e presidencës së EUROSAL-t nga Portugalia në Hollandë për periudhën 2014-2017. Gjithashtu, në Kongres u caktua edhe presidenca e rradhës e kësaj organizate, e cila do ti kalojë Turqisë së bashku me organizimin e Kongresit EUROSAL në vitin 2017.

Fjala e hapjes në ditën e parë të Kongresit u mbajt ngapresidentja e SAI-t të Hollandës, znj. Saskia J.Stuiveling, e cila uroi mirëseardhjen për 220 delegatët pjesëmarrës dhe ftoi z. Guilherme d’Oliveira Martins të paraqiste eksperiencën e tij në lidhje me presidencën e EUROSAL-t për vitet 2011-2014. Më pas Sekretari i Përgjithshëm i EUROSAL-t, z. Ramon Alvarez de Miranda paraqiti në seancën e parë plenare një përmbledhje të aktiviteteve të tre viteve të fundit, duke përmendur publikimet e shumta dhe aktivitetin e të gjithë grupeve të punës dhe task-forcave të ngritura gjatë kësaj periudhe.

Më pas, Kongresi vijoi me prezantimin e z.Ben Verwaayen, një nga njerëzit më të suksesshëm të biznesit në Europë, CEO i mëparshëm i British Telecom. Ai theksoi se audienca e këtij Kongresi përbëhej nga njerëz me pushtet në një fushë të caktuar dhe kjo i shtyn ata të ruajnë status-quon e tyre. Përkufizimi i tij për

një lidërsip të suksesshëm është “nxitja e ndryshimit, edhe pse ky ndryshim mund të mos jetë në interesin tuaj personal”.

Më tej, ai theksoi se në ditët e sotme të gjithë kanë akses në informacion, në çdo kohë dhe kudo. Ky fenomen ndikon gjithashtu në sistemin e auditimit, pasi me zhvillimin e “open data”, interneti ofron tashmë edhe informacione financiare që më parë nuk ishin publike. Dita e dytë e Kongresit filloi ndryshe nga të tjerat, me shfaqjen e dy aktorëve që kanë themeluar një lëvizje mjaft të njohur “Yes-but” të cilët nëprmet një qasje mjaft optimiste, pretendojnë se nuk ekzistojnë probleme por vetëm fakte. Ata theksojnë diferencën ndërmjet qasjes destruktive “Yes-but” dhe asaj konstruktive “Yes-and” si dy mënyra të dryshme të menduari. Qasja e parë fokusohet në atë se çfarë mungon dhe krijon vazhdimisht probleme, ndërsa qasja e dytë fokusohet në atë se çfarë është aty realisht dhe si mund të arrijmë në një zgjidhje. Kjo aftësi quhet “flip thinking”: si të transformojmë problemin në një shans/mundësi.

Seanca plenare në ditën e tretë u hap nga organizatorët e Konferencës Young EUROSAL, të cilët theksuan se SAI duhet të punojë me zgjuarsin në disa drejtime, në mënyrë që të jetë efektiv në një botë që ndryshon me ritme të shpejta. Konkretisht, SAI duhet të vendosë prioritetet në punën e tij, duhet të gjejë mënyra të reja komunikimi si dhe duhet të shpërndajë, të njohë e të aplikojë praktikën më të mira.

Kongresi vijoi më tej me prezantimin e Frederik Ruys, ekspert i çështjeve grafike, i cili theksoi tendencën e ditëve të sotme për të vizualizuar dhe dizenuar informacionin, në mënyrë që

mesazhi i transmetuar të jetë më interesant dhe i thjeshtë për ata të cilëve u drejtohet

Në ditën e katërt të Kongresit u mbajt seanca e fundit plenare, ku pas prezantimeve e diskutimeve të shumta, u paraqitën dhe u miratuan konkluzionet dhe rekomandimet e këtij Kongresi.

Gjatë pjesëmarrjes në këtë Kongres, Kryetari i KLSH z.Bujar Leskaj zhvilloi biseda pune me z. Recai Akyel, President i Gjykatës Turke të Llogarive, me z. Jacek Jezierski, ish-President i NIK, ku u shkëmbyen idetë lidhur me ecurinë e marrëdhënieve dypalëshe dhe me procesin "Peer Review" që KLSH do të kërkojë në të ardhmen e afërt.

Z. Leskaj u takua dhe me homologë të tjerë të KLSH, si z. Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë, z. Lars Lage Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës, z. Radoslav Sretenović, President i Institucionit Shtetëror të Auditimit të Serbisë, z. Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, përfaqësues të Gjykatës Greke të Llogarive dhe z. Naser Ademi, zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë.

Në këto biseda u diskutua rëndësia e ndërveprimit ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe u theksua bashkëpunimi aktual i suksesshëm që KLSH ka me disa prej tyre në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit.

5. KLSH, anëtar i Grupit të Punës së INTOSAI-t për Rishikimin e ISSAI 30, Kodi i Etikës

KLSH është pranuar në qershor të vitit 2013, anëtar i grupit Task Force të

EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E), në nën-grupin e 3-të të kësaj Task Force për Auditimin e Etikes në Institucionet e tjera Publike.

Në këtë kuadër është shtruar nga SAI-et pjesëmarrëse çështja e ngritjes së një Grupi Pune për Rishikimin e ISSAI 30, Kodit të Etikës, për të vlerësuar së pari nëse ky rishikim është i nevojshëm. Grupi i Punës fillimisht kishte në përbërje SAI-et e pesë vendeve: Polonisë, Indonezisë, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Grupi drejtohet nga SAI polak dhe Lider i Grupit është z.Jacek Jezierski, ish-President i SAI-t polak.

Grupi për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm një rishikim i ISSAI 30,



realizoi një pyetësor me të gjithë anëtarët e INTOSAI-it. Rezultatet e pyetësorit evidentuan nevojën e Rishikimit të ISSAI 30 dhe Komiteti i Standarteve Profesionale (INTOSAI) mori vendimin për Rishikimin e ISSAI 30. KLSH, duke vlerësuar rëndësinë e sjelljes etike në Institucionet Supreme të Auditimit dhe në Institucionet e tjera publike, paraqiti kërkesën për të qenë pjese e Grupi të Punës për Rishikimin e ISSAI 30 dhe Kryetari i këtij Grupi, z.Jezierski ka njoftuar zyrtarisht se KLSH është pranuar si anëtar i këtij grupi. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të japë kontributin e tij në këtë drejtim, duke bashkëpunuar ngushtësisht me pesë SAI-et e tjera, me qellim përmirësimin dhe përshtatjen në ndryshimet e kohës të Kodit të Etikës.

Versioni i përfunduar i ISSAI-t 30 do të paraqitet për miratim në Kongresin e ardhshëm të INTOSAIT, në vitin 2016.

6. KLSH në Konferencën e gjashtë vjetore të ZAP Kosovë

Nga data 9-11 korrik 2014, u zhvillua në Tiranë, Konferenca e VI-të Vjetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Në këtë aktivitet me ftesë të Auditorit të Përgjithshëm z. Lars Lage Olofsson, mori pjesë edhe një grup i gjerë audituesish dhe drejtuesish të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë.

Konferenca e VI-të, e vuri theksin në identifikimin e sukseseve dhe pikave të dobta përgjatë periudhës së kaluar, si dhe në përcaktimin e përmirësimeve të nevojshme. Katër objektivat kryesore të përcaktuara ishin:

- rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet në përmbajtje të planit vjetor dhe atij strategjik;
- inputet e marra nga plani vjetor;
- Plan i Strategjik i Zhvillimit dhe;
- eksperiencia e stafit

Rreth këtyre arritjeve u diskutua



gjërisht me fokus të veçantë në “Mësimet e mësuara gjatë vitit të kaluar” si dhe “Ballafaqimi me to në periudhat afat-shkurtër dhe afat-gjatë”. Në seancën plenare të ditës së parë, Konferenca u përshëndet edhe nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj. Z.Leskaj në fjalën e tij e vuri theksin në marrëdhënien ndërmjet dy institucioneve, e cila pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ka ecur me ritme të larta dhe me aktivitete të përbashkëta të realizuara, por bazuar

në moton e INTOSAI-t “Experientia Mutua Omnibus Prodest” dhe në dobinë e përbashkët institucionale, duhet të intensifikohet edhe më shumë nëpërmjet auditimeve të përbashkëta. Bashkëpunimi midis dy institucioneve tona duhet të shtrihet në nivel departamentesh, duke ecur në progresion gjeometrik dhe jo aritmetik. Nga KLSH, u kërkua që ZAP i Kosovës të vendosë si pikë të veçantë në Strategjinë e Zhvillimit 2014-2020, marrëveshjen me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Z.Leskaj gjithashtu, solli në vëmendje mësimet e nxjerra nga Kongresi i XXI i INCOSAI-t, ku u theksua veçanërisht tematika e trajtuar gjatë kongresit mbi “Auditimin publik në shërbim të qeverisjes së mirë”, që do të jetë edhe tema kryesore e Konferencës së tretë Shkencore që do të organizohet nga KLSH në muajin tetor 2014; roli i institucioneve supreme të auditimit në mirë-qeverisje dhe objektivat për ta kryer sa më mirë këtë detyrë, si dhe përgjegjësitë që i dalin të gjithë audituesve publikë në shërbim të kësaj qeverisjeje për të punuar me integritet dhe transparencë. Z.Leskaj në përfundim, vijoi me një ekspozitë të aktivitetit të KLSH-së për vitin 2013 dhe arritjet përgjatë vitit 2014, duke përmendur risitë e sjella në institucion. Në Konferencë ishin ftuar për të kontribuar edhe partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si përfaqësuesi i SIGMA-s, z.Joop Vrolijk, i cili foli për rolin e SAI-ve në auditimin e fondeve të BE-së si instrument i Para-Anëtarësimit, përfaqësues të SAI-ve të vendeve anëtare në BE, etj.



Gjatë punimeve, u organizuan tavolina të rrumbullakta ndërmjet anëtarëve të stafit, ku të gjithë sollën eksperiencën e tyre dhe sugjerimet për përmirësime në planin vjetor e strategjik të ZAP. Në këto tryeza, u përfshinë me eksperiencën e tyre edhe 18 auditues të KLSH-së.

7. Trajnimet e stafit të KLSH-së

Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimit të Stafit të KLSH për vitin 2014, aktivitetet e trajnimit kanë vijuar të organizohen në këto forma kryesore:

Trajnime brenda vendit: Trajnime që janë organizuar duke u mbështetur nga ekspertë të brendshëm e të jashtëm, nga organizata apo institucione kombëtare apo ndërkombëtare si më poshtë:

Në KLSH: Janë kryer trajnime të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të cilat janë ofruar nga burime të brendshme të institucionit trajnues/auditues të lartë, Kryeauditues dhe Drejtues të lartë të KLSH (30 dite, me një pjesëmarrje mesatare ditore prej 25 punonjësish). Kryesisht këto trajnime janë të fokusuara në përditësimin e njohurive teknike dhe aftësive profesionale të audituesve duke sjellë në vëmendje dhe ndryshimet dhe risitë në kuadrin ndërkombëtar dhe

kombëtar të fushës së auditimit, po ashtu dhe të menaxhimit të financave publike dhe administrimit të subjekteve publike, të cilat mbulohen nga puna e auditimit të KLSH.

Brenda Departamenteve të KLSH, nga stafi i departamenteve përkatës, me tematikë nga Auditimet e Njësive të Qeverisjes Vendore, ku kanë marrë pjesë rreth 35 auditues per secilën nga 10 tematikat specifike të Departamenteve që kanë organizuar trajnimet. Tematika e trajtuar ishte e karakterit tepër teknik dhe profesional auditues dhe lidhej në mënyrë specifike me problemet, me të cilët audituesit përballen në punën e tyre të përditshme dhe mbi zgjidhjet e mundshme të tyre.

Trajnime Brenda vendit nga organizma ndërkombëtarë:

SIGMA, vijon të jetë aktivisht prezente në veprimtaritë trajnuese të Stafit të KLSH. Periudha e katër-mujorit të dytë ka shënuar veprimtari intensive trajnimi (çdo muaj) duke kaluar në nivele më të larta të njohurive dhe aftësive për të cilat audituesit kanë nevojë të thellojnë dijet e tyre aktuale.

Më 12-13-14 Maj, u organizua trajnimi “Bazat e Auditimit në Sektorin Publik” për auditues të rinj, ku morën pjesë 25 auditues dhe për 3 ditë u njohën me elementët bazë të punës audituese si një kërkesë thelbësore për të punuar si auditues publik.

Më tej më 22-23-24 Qershor, trajnimi mbi “Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i Auditimit” trajtoi çështje të një niveli më të lartë profesional ku në grup fokus ishin Drejtuesit e lartë të KLSH, 20

Drejtorë dhe Kryeauditues. Si aktorët kryesorë që përfshihen në procesin e planifikimit të punës audituese, pjesëmarrësit morën njohuri mbi metodat dhe rrugët për një planifikim më eficient dhe të ndërtuar mbi baza reale, duke gjetur një ekuilibër të arsyeshëm midis nevojës për të audituar dhe burimeve të auditimit. Gjatë tre ditëve menaxherët e nivelit të mesëm dhe të lartë të KLSH u njohën gjithashtu dhe me eksperiencat e shume prej vendeve anëtare të BE-së duke krijuar një pamje më të gjerë mbi mënyrën se si kolegë e institucioneve homologe të vendeve të tjera planifikojnë dhe janë të suksesshëm në punën e tyre.

Në datat 10-12 shtator, SIGMA organizoi një trajnim tjetër, në të cilin morën pjesë 26 auditues, me një subjekt specifik si "Qasja e Auditimit mbi Bazë Sistemi". Duke prezantuar metoda dhe teknika të cilat mund të jenë të përshtatshme të adoptohen dhe aplikohen nga audituesit e KLSH trajnimi synoi të nxisë audituesit për të siguruar cilësi më të mirë të punës dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara krahas përdorimit efektiv të burimeve dhe njohurive të tyre. Ky trajnim u realizua nga stafi i SIGMA-s si dhe ekspertët e brendshëm të KLSH.

NAO i Suedisë, vijon mbështetjen e tij për Departamentin e Auditimit të Performancës në kuadrin e auditimit paralel që ky Departament po zhvillon së bashku me ZAP-in e Kosovës nën udhëheqjen e SNAO-s.

12-13-14 Maj, u organizua trajnimi me temë "Modelet e analizës së problemit në Auditimin e Performancës" me

pjesëmarrjen e 13 audituesve të performancës për 3 ditë;

22-26 Qershor, trajnimi me temë "Procedurat e auditimeve paralele në kontekstin e SAI-ve Rajonale", të cilin e ndoqën 4 auditues të KLSH-së.

9. Shkolla e Administratës Publike – ASPA

Trajnimet nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA) vijojnë të trajtojnë tematika të përgjithshme nga kuadri ligjor e procedural i administratës publike, menaxhimi financiar dhe kontrolli, menaxhimi i riskut, prokurimi publik, etika në administratë etj. Gjatë kësaj periudhe në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth 66 auditues me kohëzgjatje mesatare 2-3 ditë për çdo trajnim.

10. Trajnime jashtë vendit

Trajnimet jashtë vendit kanë konsistuar në pjesëmarrje të audituesve në veprimtari afatshkurtra 2-3 ditore, seminare, workshop-e dhe konferenca ndërkombëtare. Në varësi të tematikës së trajtuar audituesit për pjesëmarrje u përzgjedhën në përshtatje me specialitetin e fushës dhe aftësitë e tyre profesionale. Si aktivitete kryesore mund të përmendim të mëposhtmet:

Norvegji, 12-16 Maj-IDI, SAI Norvegjisë "Kuadri i matshmerisë së performancës së SAI-ve PFM";

Bruksel, 12-13 Maj- Bordi Ndërkombëtar i Audituesve të NATO; Holandë, 18 -20 Maj -Rekenkaimer, Unioni Bankar;

CEF, Slloveni 28-30 Maj ; Prezantimi SND të AB;

Rumani, 5-8 Qershor-Gjykata Rumune e Llogarive, Vizitë Studimore

Qendra e Ekselencës në Financë, Silloveni ka qenë një ofrues i qëndrueshëm i trajnimeve jashtë vendit dhe deri tani në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth 15 auditues në grupe 2-3 persona me kohëzgjatje 2-3 ditore.

11. E-learning

Trajnimet on line kanë filluar të futen gjerësisht në praktikën e trajnimeve për audituesit e KLSH. Kryesisht ato janë ofruara nga IDI për moderatorët e Implementimit të Standardeve ISSAI (Iniciativa e 3i-ve) por njëkohësisht dhe

për auditimin e Teknologjisë së Informacionit.

Krahas burimeve të jashtme, trajnime për TI janë ofruar dhe nga ekspertë të brendshëm të KLSH për stafin e ri dhe që premtan të përfshihet në një të ardhme jo të largtë në auditimet e TI. Këto trajnime përfshijnë gjithashtu dhe përdorimin e mjeteve të IT-së në auditim, sikurse është Programi IDEA.

Ne përgjithësi ecuria e trajnimeve ka rezultuar në pajtueshmëri me Planin e Trajnimeve, dhe treguesit kryesore të kësaj veprimtari janë realizuar plotësisht. Deri në Shtator 2014 janë realizuar rreth 16 ditë trajnimi/auditues dhe janë trajtuar mbi 50 tema trajnimi.

GYKATA E AUDITIMIT E BELGIKËS



Gjykata e Auditimit është e ndarë në dy dhoma, një ku flitet gjuha frënge dhe një ku flitet ajo holandeze, secila e përbërë nga një president

Gjykata e Auditimit është e përbërë nga 12 magistratë, të ndihmuar nga nëpunës civilë.

Kolegji

Gjykata e Auditimit është e ndarë në dy dhoma, një ku flitet gjuha frënge dhe një ku flitet ajo holandeze, secila e përbërë nga një president, katër këshilltarë (“conseillers” ose “raadsheren”) dhe një Sekretar i Përgjithshëm (“greffier” ose “griffier”). Më i vjetri nga dy presidentët caktohet si Presidenti Kryesor (“Premier President” ose “Eerste Voorzitter”) dhe sekretari i përgjithshëm më i vjetër në moshë nga të dy caktohet Kryenëpunësi (“Greffier en chef” ose “Hoofdgriffier”). Të gjithë anëtarët e Gjykatës së Auditimit zgjidhen nga Dhoma e

Përfaqësuesve për një periudhë gjashtë vjeçare dhe mund të riemërohen. Për t’u siguruar që anëtarët e Gjykatës së Auditimit veprojnë më mënyrë të pavarur dhe të paanshme, trupi legjislativ ka hartuar një listë me veprimtaritë e ndaluara ose të papajtueshme me funksionin e tyre. Gjykata e Auditimit e ushtron funksionin e saj gjatë gjithë vitit. Gjykata e Auditimit ka të punësuar 608 persona, të ndarë në mënyrë të barabartë mes folësve të gjuhës frënge dhe asaj holandeze. Stafi i pranishëm ka katër nivele. Rreth gjysma e stafit i përket nivelit 1 (audituesit), të cilët merren me rastet e auditimit, duke ndihmuar anëtarët e stafit në nivelin 2 +. Nivelet 2 dhe 3 mundësojnë shërbimet logjistike.

Detyrat dhe kompetencat

Gjykata e Auditimit kryen auditimin financiar, atë të ligjshmërisë dhe monitorimin e përdorimit të duhur të fondeve publike. Grupi i saj kontrollon faturat dhe shpenzimet e komunitetit federal, të qeverive rajonale dhe të atyre provinciale

Rezultatet e këtyre tre llojeve të auditimit të çojnë në kryerjen e rregullt të deklarave informative.

Gjykata është e ngarkuar edhe me një detyrë juridiksionale

Auditimi Financiar

Shteti Federal, komunitetet, rajonet, institucionet e shërbimeve publike në varësi të këtyre subjekteve dhe krahinave raportojnë çdo vit mbi përdorimin e fondeve publike që atyre u janë besuar.

Llogaritë transmetohen në Gjykatë, e cila verifikon saktësinë, besueshmërinë dhe plotësinë e shënimeve në pasqyrat financiare dhe kontrollon përputhshmërinë e transaksioneve të regjistruara me legjislacionin e kontabilitetit.

Përveç kësaj, Gjykata kontrollon dhe mbyll llogaritë e punonjësve të kontabilitetit publik, përkatësisht përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv, që janë të ngarkuar me mbledhjen dhe / ose pagesën e fondeve publike. Gjykata shqyrton nëse llogaritë e nëpunësve të kontabilitetit janë në ekuilibër, nëse bilanci është në favor të tyre ose në favor të shtetit. Në dy rastet e para, ajo harton një vendim shkarkimi. Rasti i tretë lejon gjykimin për defiqitin administrativ që mund të rezultojë në kryerjen e detyrës juridiksionale.

Auditimi i ligjshmërisë

Gjykata kryen auditim të ligjshmërisë në shpenzimet publike dhe faturat. Ajo kontrollon përputhshmërinë e tyre me ligjet buxhetore (nëse ka kredi të mjaftueshme në buxhet, nëse operacionet janë kryer saktë në përputhje me buxhetin, etj) dhe ajo siguron se rregullat e tjera ligjore, të zbatueshme për operacionet e kontrolluara, veçanërisht vendimet publike të ligjit që janë marrë pikërisht për të mbrojtur interesat e Thesarit (p.sh. standardet që aplikohen në kontratat e prokurimit publik, në dhënien dhe përdorimin e subvencioneve, rekrutimi i stafit, etj), janë zbatuar me korrektësi.

Auditimi për përdorimin e dobishëm të fondeve publike

Gjykata e Auditimit është e ngarkuar edhe me monitorimin e përdorimit të dobishëm të fondeve publike, në mënyrë që të informojë Parlamentin në lidhje me mënyrën se si janë menaxhuar shërbimet publike. Natyra e këtij auditimi është përcaktuar në bazë të tre parimeve: ekonomikitetit, efektivitetit dhe efikasitetit.

- Auditimi i ekonomikitetit vlerëson nëse burimet financiare, njerëzore dhe materiale të zbatuara janë cilësore dhe sasiore, janë blerë dhe përdorur në koston më të ulët dhe në momentin e duhur.

- Auditimi i efektivitetit vlerëson shkallën e arritjes së qëllimeve dhe objektivave të deklaruara.

- Auditimi i efikasitetit vlerëson prodhimin për një sasi të caktuar të burimeve ose, me fjalë të tjera, ai siguron se burimet financiare, njerëzore dhe materiale janë përdorur për të arritur rezultate optimale. Ky auditim

është kryer “ex post facto”, që do të thotë, pas ekzekutimit të operacioneve. Ashtu si detyrat e tjera, Gjykata e kryen këtë si një nismë të saj. Parimi i pavarësisë së përgjithshme është një garanci e objektivitetit dhe paanshmëria. Megjithatë, që të përmirësohet informacioni i asambleve legislative, Parlamenti ka ngarkuar Gjykatën me mision të veçantë për kryerjen e analizës së menaxhimit.

Detyra e informimit

Gjykata e Auditimit njofton asamblenë legislative dhe këshillat krahinore për rezultatet e auditimeve të kryera. Në të vërtetë kjo bëhet në mënyrë që të realizojë, duke pasur njohuri të plotë mbi faktet, ndarjet buxhetore të kërkuara nga pushteti ekzekutiv me profesionalizëm dhe të jenë në gjendje për të vlerësuar përdorimin e tyre. Asamblëtë dhe këshillat duhet të pajisen me informata të përshtatshme dhe të paanshme buxhetore.

Ky informacion merr disa forma. Gjykata e Auditimit dorëzon raportet e saj të auditimit të asamblesë dhe këshillave, qoftë në formën e sintezës së integruar në Librin vjetor të komenteve ose në formën e botimeve të veçanta. Përzgjedhja e njëres zgjidhje ose tjetrës varet nga nevoja e ngutshme e informacionit për t’u komunikuar.

Përveç kësaj, Gjykata i informon asamblëtë legislative të përfshira për çdo angazhim, për autorizimin apo pagesën e shpenzimeve që tejkalohen nga ndarjet buxhetore.

Së fundi, Gjykata përmbush një funksion të rëndësishëm si një këshilltar i buxhetit. Para miratimit të të gjithë buxhetit, ajo transmeton komentet e saj për projektligjet e dorëzuara në asamblëtë legislative. Dokumentet e

Gjykatës që janë paraqitur në asamblëtë e ndryshme janë diskutuar në komisionet për financat, në prani të një përfaqësuesi të Gjykatës.

Detyra Juridiksionale

Kushtetuta gjithashtu i ka dhënë Gjykatës së Auditimit të drejtën e auditimit dhe vlerësimit të llogarive të administrimit të përgjithshëm dhe të të gjithë zyrtarëve të kontabilitetit që i përgjigjen Thesarit publik. Llogaritë e kontabilistëve dërgohen në Gjykatë çdo vit, si dhe në rast të një deficiti ose kur ata largohen nga posti.

Në këtë kontekst, një këshilltar nga çdo dhomë emërohet me urdhër të Presidentit për të vendosur nëse llogaritë e kontabilistëve janë të ekuilibruara, nëse bilanci është në favor të tyre ose në favor të shtetit. Nëse vendimi tregon një deficit në menaxhimin e njërit prej kontabilistëve, ministri përkatës duhet ta nxjerrë atë para Gjykatës së Auditimit. Ai vetëm mund t’i përmbahet thirrjes së tij / saj nëse ai është i mendimit se nëpunësi i kontabilitetit mund të ketë tejkaluar kompetencat e tij / saj (‘forcë madhore’) ose në qoftë se deficiti nuk kalon një shumë (1.250 EURO) të caktuar nga dekreti mbretëror.

Pas një procedurë publike, në prani të palëve të përfshira, Gjykata liron nga akuzat kontabilistin, në qoftë se konstaton se ai / ajo është jashtë borxhit ose ekzistojnë rrethana të tjera përtej kontrollit të tij / saj. Nëse nuk ndodh kështu, Gjykata e dënon kontabilistin.

Vendimet mund t’i drejtohen Gjykatës së Kasacionit. Nëse vendimi i Gjykatës së Auditimit kundër një kontabilisti hidhet poshtë nga Gjykata e Kasacionit, në këtë rast duhet t’i referohen një

komiteti të veçantë, të përbërë nga anëtarë të Dhomës së Përfaqësuesve, gjykimi i të cilëve nuk mund të apelohej.

Gjykata është e ngarkuar gjithashtu me një detyrë juridiksionale kundrejt zyrtarëve të autorizuar, të deleguar nga ministri. Ajo kërkon që ata të paguajnë shumat në qoftë se kanë kryer ndarjet në kundërshtim me dispozitat ligjore ose humbjet e shkaktuara për t'u paguar nga Thesari. Në fazën e juridiksionit, ata i nënshtrohen procedurave të njëjta si ato që aplikohen për kontabilistët.

Deklaratat e zyrave dhe të pasurive

Sipas akteve të veçanta dhe të zakonshme të datës 2 Maj 1995, akteve të veçanta dhe të zakonshme të ndryshuara dhe të zbatuara nga 26 qershori i 2004, kategori të caktuara të përfaqësuesve politikë dhe zyrtarëve të lartë, janë të detyruar të paraqesin një deklaratë të zyrave, funksioneve dhe profesioneve në Gjykatën e Auditimit. Ata janë gjithashtu të detyruar të paraqesin një deklaratë të pasurive në përputhje me një programi të caktuar. Legjislacioni i përmendur më sipër hyri në fuqi më 1 janar, 2005. Deklaratat e zyrave dhe ato të pasurive bëhen për shkak të paraqitjes në departamentin e "Regjistrimit të deklaratave të zyrave dhe ato të pasurive "të Gjykatës së Auditimit. Gjykata duhet të kontrollojë, depozitojë dhe publikojë këto dokumente.

Funksionimi

Rregullat e procedurës përcaktojnë funksionimin e Gjykatës së Auditimit; këto rregulla mund të ndryshohen vetëm me miratimin e Dhomës së Përfaqësuesve.

Kontrollet dhe analizat planifikohen çdo vit si "programet e auditimit" të vendosura nga Gjykata e Auditimit. Këto programe të auditimit përshkruajnë objektivat e veçanta për çdo drejtori për vitin e ardhshëm, si dhe mjetet e ndryshme në dispozicion për t'i zbatuar ato. Audituesit dhe kontrollorët kryejnë kontrole dhe analiza, ose nga kuponat e paraqitur në Gjykatë, ose në vend, në departamentet dhe institucionet e audituara. Audituesit dhe kontrolluesit raportojë në Gjykatën e Auditimeve dhe paraqesin komentet, propozimet dhe rekomandimet për projektin. Raportet e tyre shqyrtohen brenda një grupi pune. Një grup pune është i përbërë nga dy këshilltarë të caktuar nga kryetari i dhomës përkatëse. Përbërja e dy grupeve të punës së çdo dhome ndryshon çdo gjashtë muaj. Në rastet kur dosja është veçanërisht e rëndësishme ose e vështirë, grupi i punës raporton në dhomën përkatëse.

Dhoma e Përfaqësuesve administron dosjen ose ajo ia dërgon Asamblesë së Përgjithshme sa herë që është veçanërisht e rëndësishme, sidomos për përputhshmërinë me ligjin, ose sa herë që është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme. Megjithatë, çështjet që i përkasin komunitetit francez, Komisioni i Komunitetit Francez i Këshillit Rajonal të Brukselit, rajoni Walloon, provincat që janë pjesë e këtij rajoni dhe institucionet e shërbimit publik në varësi të këtyre subjekteve janë ekskluzivisht nën kompetencën e Dhomës Franceze, ndërsa çështjet që i përkasin komunitetit holandez, Komisioni i Komunitetit Holandez i Këshillit Rajonal të Brukselit, rajoni holandez, provincat që janë pjesë e këtij rajoni dhe institucionet e shërbimit publik në varësi të këtyre subjekteve

janë ekskluzivisht nën kompetencën e Dhomës Hollandeze.

